



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

#### Përmbajtja

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>2</b>
<b>II. HYRJA .....</b>	<b>11</b>
a. Titulli: Raport Përfundimtar Auditimi mbi auditimin e “Përputhshmërisë” në Shoqërinë “Ujësjellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër.....	13
b.Marrësi: Shoqëria “Ujësjellës- Kanalizime Shkodër” Sh.a, me Administrator M. M. ....	13
c. Objektivat dhe qëllimi:.....	13
d. Identifikimi i çështjes:.....	13
e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:.....	13
f. Përgjegjësitë e audituesve: .....	14
g. Kriteret e vlerësimit: .....	14
h. Standardet e auditimit:.....	15
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....</b>	<b>15</b>
<b>IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>16</b>
1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm. ....	16
2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre. ....	17
3. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik. ....	20
4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. ....	29
5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, Bank dhe blerjeve me vlera te vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj). ....	30
6. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. ....	34
7.Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave. ....	39
8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit. ....	91
9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale. ....	99



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

10. Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr. 8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.....	99
11. “Riorganizimi në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.....	101
<b>V. KONKLUSIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT .....</b>	<b>104</b>
<b>A. MASA ORGANIZATIVE .....</b>	<b>104</b>
<b>B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI .....</b>	<b>116</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### II.a. Përshkrimi i shkurtër i projektit.

Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik.

### II.b. Gjetjet kryesore të konstatuara.

-Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër ka bërë rivlerësimin e të gjitha aktiveve të shoqërisë dhe nga procesi i rivlerësimit, kapitali i shoqërisë ka rezultuar në vlerën 2,698,774 mijë lekë. Deri më datën 04.11.2019, datë në të cilën përfundoj auditimi nuk është miratuar ndryshimi i kapitalit në Asamblenë së Përgjithshme, nuk është bërë ndryshimi në statut dhe në QKB. Konkretisht me vendim të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 28, datë 01.06.2016, është miratuar statuti i Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 471.000.000 lekë, aksione me vlerë nominale 1000 lekë secili, i përbërë nga aksioneri i vetëm Bashkia Shkodër. Organet e Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Administrimit.

Procesi i marrjes në dorëzim ka përfunduar në vitin 2017 dhe kapitali i bashkimit është pasqyruar në QKB, sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH nr. 6, datë 21.07.2017 dhe nr. 8, date 12.12.2017.

Është hartuar raporti “Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë”, nga ekspertët kontabël Nurie Krymi dhe Mimoza Fishta me nr. 802 prot, datë 14.07.2017.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 6, datë 21.07.2017 të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër V.A., është miratuar shtesa në kapital, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 840.475.000 lekë nga 471.000.000 lekë që ishte.

Është hartuar raporti “Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë”, nga ekspertët kontabël Nurie Krymi dhe Mimoza Fishta me nr. 1457, datë 12.12.2017.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 8, datë 18.12.2017 të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër V.A., është miratuar shtesat në kapital, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 863.468.000 lekë, nga 840.475.000 lekë që ishte.

Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër ka bërë rivlerësimin e të gjitha aktiveve të shoqërisë nëpërmjet palës së tretë, shoqërisë “U.S.”, të përzgjedhur nëpërmjet procedurës së prokurimit me kontratën me nr. 3082, datë 14.12.2019, dhe shërbimet janë marrë në dorëzim me proces-verbalin e datës 01.03.2019, nga procesi i rivlerësimit, kapitali i shoqërisë është në vlerën 2,698,774 mijë lekë. Deri më datën 04.11.2019, datë në të cilën përfundoj auditimi nuk është miratuar ndryshimi i kapitalit në Asamblesë së Përgjithshme dhe nuk është bërë ndryshimi në QKB.

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.A, Shkodër ka aplikuar për ndryshimin e tarifave ujit pranë Entit Rregullator me aplikim me nr. 739 prot, datë 30.06.2017, por deri më datë 04.11.2019, datë në cilën përfundoj auditimi Enti Rregullator i Ujit nuk e ka miratuar këtë ndryshim.

Enti Rregullator i Ujit me vendimin nr. 25, date 30.03.2018, ka vendosur të mos miratoj kërkesën e bërë nga UKSH, pasi nuk është paraqitur opinioni i Këshillit Bashkiak Shkodër (Asambleja e Përgjithshme), për tarifën e reja të propozuara. Veprim në kundërshtim me satutin e shoqërisë çka ngarkon me përgjegjësi Këshillin e Administrimit.

-Përfitim padrejtësisht pagese nga Shoqëria “A.A.” sh.p.k në vlerën 480,000 lekë.

Me urdhër transfertë datë 29.05.2019 është likuiduar Shoqëria “A.A.” sh.p.k në vlerën 480,000lekë. Dokumenti justifikues fatura nr.25, datë 26.04.2019 në vlerën 480,00 lekë.

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël Shoqërisë “A.A.” sh.p.k me përfaqësuese ligjore N.K., është lidhur aktmarrëveshja e shërbimit me nr. 52/2 prot, datë 16.01.2019, me objekt: Auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri në përfundimin e shërbimit të ofruar me vlerë 800,000 lekë pa tvsh. Në këtë aktmarrëveshje është përcaktuar “.....Në përfundim të kontrollit, verifikimit dhe vlerësimit të të gjithë elementëve të përgjithshme të përmendur në këtë marrëveshje, por edhe të elementëve specifik të përmendur të cilët mundësojnë kryerjen e një auditimi sa më rigoroz, AL do të përpiloj raportin e auditimit të pavarur në të cilin do të shprehet opinion në se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar”.

Ky shërbim nuk provohet të jetë kryer, nga deklarimi verbal i stafit të UK, kjo kontratë është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga Shoqëria “A.A.” sh.p.k me përfaqësuese ligjore N. K.

Për kryerjen e këtij shërbimi me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 4 , datë 03.05.2019 protokolluar në Shoqërinë “UK” Shkodër Sh.A me nr.7426, datë 03.05.2019, është bërë emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar që të auditojnë pasqyrat financiare për vitin 2018, B.B.dhe T.N.

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël B.B. dhe T.N., është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 749 prot., datë 19.06.2019, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat 266,7 orë që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me vlerë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

800,000 lekë pa tvsh. Likuiduar me urdhër transfertën datë 04.07.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 384,000 lekë, dokument justifikues fatuar nr. 30, datë 15.06.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 96,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 58, datë 26.07.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 480,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 26.07.2019.

Me vendim të kryetarit të Asamblesë së përgjithshme nr. 9, datë 30.07.2019, është bërë miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2018.

Vlera 480,000 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “UK Shkodër” Sh.a Shkodër dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “A.A.” sh.p.k.

-Në 10 procedura prokurimi për vlerën 48,371 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

-Për 9 procedura prokurimi për vlerën 45,031 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 10 procedura prokurimi për vlerën 95,277 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

-Në 15 raste për vlerën 6,425 mijë lekë, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

-Në 5 raste për vlerën 28,665,444 lekë është krijuar dëm ekonomik, nga zbatimi i kontratave të pajisjeve) mallrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”, Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10.

- Parregullsi në pasqyrat financiare dhe analizave të tyre, në lidhje me grandet dhe rimarrjen e tyre në të ardhurat e periudhës.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Në pasqyrat financiare të shoqërisë, në pasiv në pozicionin e të ardhurave të shtyra, konkretisht në lidhje me grandet në bilancin e vitit 2018 në vlerën 4,323.216.953, në vitin 2017 në vlerën 4,542,971,684 lekë (ndryshimi i pakësuar në vlerën 219,754,731 lekë, nga të cilat granti nga projekti gjerman (-) 233,664,009 lekë dhe grande nga shteti (+) 13,909,275, ndërsa në bilancin e vitit 2017 në vlerën 4,542,971,684 lekë krahasim me vitin 2016 në vlerën 3,281,703,880 lekë ndryshimi shtuar (+) 1,261,267,804, ndryshim i gjithë nga granti projekt Gjerman.

Ndërkohë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në zërin të ardhura nga rimarrja e grantit, për vitin 2018 është pasqyruar në vlerën 233,264,009 lekë, dhe për vitin 2017 në vlerën 289,215,517 lekë.

Siç shihet granti nga projekti Gjerman për vitin 2017, duke marre parasysh pakësimin nga rimarrja si e ardhur është rritur me tepër  $(1,261,267,804 + 289,215,517) = 1,550,483,323$  lekë.

Theksojmë se ky projekt është zbatuar në vitet 2009-2015 dhe ka përfshirë 5 kontrata: Konkretisht: Blerje makineri dhe pajisje, ndarja e sistemit të KUZ me KUB “Stacioni UZ Pazar, “Kolektor kryesor nga E.D. deri stacionin e KUZ Pazar”, kontrata investime në ujësjellës “linjë ere stacion Dobrac deri tek puseta Dobrac”, “Linjë e transmetimit Rus-Xhabie”, “Linja terciare”, Kontrata impianti i ri i Shirokës dhe kontrata e vendosjes rreth 15 mijë matësve.

Veprim në kundërshtim me standartet e raportimit, SKK nr. 10, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10,926, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar”, të përkthyer në gjuhën shqipe.

-Parregullsi në paraqitjen e vlerave të aktiveve afatgjata materiale dhe amortizimet e tyre.

Në pasqyrat financiare të vitit 2017 përse i përket AAGJ, nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar këto aktive në lidhje shtesat dhe pakësimet në vlerat e tyre, situata nga burime të ndryshme raportimesh si me poshtë:

Nga aktivi i bilancit, AAM në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016 kanë rritje në vlerën 1,334,262,876 lekë, ndërsa AAJM një pakësim në vlerën 3,077,715 lekë, në total me efekt të aktiveve afatgjata rritje në vlerën 1,331,185,161 lekë.

Në shënimet shpjeguese që shoqërojnë bilancin e vitit 2017, në pikën 8 të kësaj pasqyre vlera e AAGJ para amortizimit të vitit është në vlerën 6,695,516,889 lekë, pra nuk nuk rakordon me vlerën mbetur e mbartur nga viti 2016, në shumën 3,170,699,719 lekë, plus ndryshimet sipas kësaj pasqyre shtesa aktive të blera gjatë vitit në vlerën 1,941,109,866 lekë.

Totali  $(3,170,699,719 + 1,941,109,866) = 5,111,809,585$  lekë.

Pra ka një mos rakordim në vlerën 1,583,707,304 lekë.

Pasqyra e aktiveve afatgjata materiale me vlerat e çelura nga viti 2016, si dhe shtesat pakësimet, si dhe amortizimet përkatëse mungon.

Në pasqyrat financiare vitit 2018, përse i përket AAGJ, nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar këto aktive, në lidhje me shtesat dhe pakësimet në vlerat e tyre, situata nga burime të ndryshme raportimesh si më poshtë:

Nga aktivi i bilancit, AAM në vitin 2018 krahasuar me 2017, janë pakësuar në vlerën 154,718,693 lekë, ndërsa AAJM janë pakësuar në vlerën 80,283,710 lekë, total ndryshimi i aktiveve afatgjata pakësuar në vlerën 235,000,403 lekë.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Nga pasqyra e shënimeve shpjeguese që shoqërojnë bilancin e vitit 2018, në pikën 8 të kësaj pasqyre vlera e AAGJ 4,955,676,845 lekë, nuk rakordon me vlerën mbetur e mbartur nga viti 2017 në shumën 4,946,015,237 lekë, plus ndryshimet sipas kësaj pasqyre shtesa aktive blera gjatë vitit në vlerën 9,311,390 lekë. Totali  $(4,946,015.237+9,311,390)=4,955,326,627$  lekë.

Pra ka një mos rakordim në vlerën 350,218lekë.

Pasqyra e aktiveve afatgjata me vlerat e AAGJ shtesa e AAGJ në rritje është prej 9,661,606 lekë nga shtesat 34.825.69 lekë dhe pakësimet 25.164.088 lekë  $(34.825.69 -25,164,088=9.661.606)$ .

Referuar sa më sipër, ka një mos rakordim në shtesa të AAGJ midis dy burimeve te fundit persa i përket blerjes se AAGJ

Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SH.A Shkodër.

-Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SH.A Shkodër. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Konkretisht gjendja debitore për vitin 2017 është në vlerën 1,066,367,794 lekë, ndërsa për vitin 2018 është në vlerën 1,143,319,951 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 92% për vitin 2017 dhe 95% për vitin 2018, e zënë klientët për shitje uji.

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2017, kjo gjendje paraqitet në vlerën 1,019,057,660 lekë dhe për vitin 2018, në vlerën 1,095,989,046 lekë.

Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 708,591,468 lekë për vitin 2017 dhe 789,255,534 lekë për vitin 2018.

Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve gjendja debitore zë 59 % të të ardhurave për vitin 2017 dhe 53% për vitin 2018, ndërsa gjendja kreditore zë 89% të shpenzimeve për vitin 2017 dhe 77% për vitin 2018.

Nuk është kryer inventari fizik i aseteve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik.

-Nuk është kryer inventari fizik i aseteve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja e kanalizime të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre.

-Nuk janë krijuar provigjionet sipas SKK, si dhe nuk janë të pasqyruar të ardhura dhe shpenzime nga provigjionet.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hartuesit e pasqyrave financiare dhe në veçanti ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2017 Mimoza Fishta dhe Nurie Krymi dhe ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018, Bujar Bendo dhe Tom Ndoci.

Veprim në kundërshtim me standartet e raportimit, SKK nr. 10, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10.926, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar”, të përkthyer në gjuhën shqipe.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Nga auditimi u konstatua se Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, çfuqizuar me Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Përfitim padrejtësisht pagese nga Avni Dervishi, me detyrë kryetari Këshillit Administrativ.

Me urdhër transfertën datë 27.12.2017, nëpërmjet bankës Credins, është likuiduar A.D., me detyrë kryetari Këshillit Administrativ për vlerën 4250 lekë, me objekt kalim bonusi për vitin 2017. Ky bonos është dhënë me vendim të Këshillit të Administrimit nr.30, datë 22.12.2017, si dhe në zbatim të këtij vendimi, urdhri i brendshëm i administratorit nr. 316, datë 27.12.2017, ku është përcaktuar të akordohet për çdo punonjës 5000 lekë bonusi për vitin 2017. Shpërblimi (bonusi) është përfituar padrejtësisht, pasi kryetari i Këshillit Administrativ nuk është punonjës i UK Shkodër, dhe në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 5 “Interesat private”, pika 1/a, ku citohet: *“Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre”* dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar.

Shoqëria “Ujësjetllës- Kanalizime” Sh.a Shkodër, nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të dhëna nga auditimet e mëparshme. Konkretisht janë rekomanduar 36 masa organizative nga KLSH, te cilat janë pranuar dhe zbatuar, nga masat e zbatuara 3 masa janë në proces dhe 30 janë pranuar, por zbatimi është dhe në vijimësi.

Janë rekomanduar 5 masa për shpërblim dëmi me vlerë totale 6,934,888 lekë, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, nga masat e zbatuara 2 masa në vlerën 5,727,052 lekë janë zbatuar plotësisht, ndërsa 3 masa në vlerën 1,207,836 janë zbatuar, por realizimi është në proces.

Për eliminimin e efekteve negative financiare janë rekomanduar 6 masa në vlerën 38,846,003 lekë, te cilat janë pranuar dhe zbatuar, nga masat e zbatuara 2 masa në vlerën 33,705,545 lekë janë zbatuar plotësisht, ndërsa 4 masa në vlerën 5,140,458 janë pranuar, por kërkohet vijueshmëria e zbatimit edhe në të ardhmen.

Janë rekomanduar 19 masa disiplinore të cilat janë zbatuar 18 dhe 1 masë nuk është zbatuar. Mos zbatimi i një mase disiplinore kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c.

-Anëtarët e Këshillit të Administrimit të UK Shkodër nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë.

Nga auditimi u konstatua që bazuar në pikën 3 të nenit 12 të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe pikën 3 të nenit 12 të Statutit të UK Shkodër SHA, anëtarët e Këshillit të Administrimit duhej që në momentin e emërimit të lidhnin me shoqërinë një kontratë ku jetë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritej t’i arrinin në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë duhet të miratoheshin edhe nga ministria e linjës dhe duhet të ishin të matshme në përputhje me biznes planet e shoqërisë. Grupi i auditimit evidenton se mes UK Shkodër SHA dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit nuk janë lidhur kontrata pune, por të vetmet akte të hartuara në momentin e emërimit të tyre janë vendimet e riemërimit të tyre nga Asambleja e Përgjithshme e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

UK Shkodër SHA, më konkretisht: Vendimi nr. 5, datë 30.05.2019 për riemërimin si administrator të UK Shkodër të M. M., Vendimi nr. 6, datë 30.05.2019 për riemërimin si anëtar të Këshillit të Administrimit të A. D., Vendimi nr. 7, datë 30.05.2019 për riemërimin si anëtare e Këshillit të Administrimit të Vildana Gushta.

Rinovimi vjetor i kontratës së Administratorit nuk është bërë bazuar në vlerësimet vjetore pozitive të performancës së punës së tij. Konkretisht bazuar në parashikimet e VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, si dhe të Statutit të UK Shkodër SHA, pavarësisht se Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vitesh, qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë kontratash të rinovueshme vjetore mes tij dhe Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performancës së punës së tij. Grupi i auditimit nuk evidenton rinovimin e kontratës së Administratorit për periudhën objekt auditimit. I vetmi akt i vendosur në dispozicion është Vendimi nr. 5, datë 30.05.2019 i Asamblesë së Përgjithshme të UK Shkodër SHA, për riemërimin si administrator të UK Shkodër të M.M. Mbas këtij akti duhet të ishte lidhur kontrata.

Dhënie masa disiplinore jashtë kompetencës nga Këshilli i Administrimit. Konkretisht në parashikimet e rregullores së brendshme të UK Shkodër të nxjerrë nga Këshilli i Administrimit, evidentohen parashikime juridike të cilat janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe shkaktojnë problematika lidhur me përcaktimin e organit kompetent për përcaktimin e masave administrative. Më konkretisht, evidentohet se neni 7 i rregullores i njuh kompetencën për marrjen e masave disiplinore eprorit direkt të punonjësit, ndërsa neni 14 ia njuh këtë kompetencë “Administratorit/Drejtorit”. Këto parashikime nuk evidentojnë qartësisht organin kompetent për marrjen e masave administrative ndaj punonjësve duke ia ka njohur këtë kompetencë: administratorit/ drejtorit dhe eprorit direkt. Pra potencialisht, për të njëjtin punonjës, mund të pretendojnë kompetencën për marrjen e masës disiplinore të dy nëpunësit e sipërcituar, duke çuar potencialisht edhe në dy vendime të ndryshme.

Këshilli i Administrimit me Vendimet nr. 15, 16, 17 datë 20.03.2019, ka vendosur dhënien e masës disiplinore jashtë kompetencës në tre raste. Theksojmë se në parashikimet e rregullores së brendshme të UK Shkodër të nxjerrë nga Këshilli i Administrimit, evidentohen parashikime juridike të cilat janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe shkaktojnë problematika lidhur me përcaktimin e organit kompetent për përcaktimin e masave administrative. Më konkretisht, evidentohet se neni 7 i rregullores i njuh kompetencën për marrjen e masave disiplinore eprorit direkt të punonjësit, ndërsa neni 14 ia njuh këtë kompetencë “Administratorit/Drejtorit”. Këto parashikime nuk evidentojnë qartësisht organin kompetent për marrjen e masave administrative ndaj punonjësve duke ia ka njohur këtë kompetencë: administratorit/ drejtorit dhe eprorit direkt. Pra potencialisht, për të njëjtin punonjës, mund të pretendojnë kompetencën për marrjen e masës disiplinore të dy nëpunësit e sipërcituar, duke çuar potencialisht edhe në dy vendime të ndryshme. Nuk janë publikuar në faqen e internetit të shoqërisë të dhënat e detyrueshme për publikim. Evidentohet mosrespektim i parashikimeve të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe parashikimeve të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, lidhur me publikimin në faqen e internetit të UK Shkodër të dokumentacionit të detyrueshëm për t’u publikuar sipas parashikimeve të këtyre akteve, ndër të tjera lidhur me procesverbalet e





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të cilat duhet të ishin të publikuara në faqen zyrtare të internetit të UK Shkodër jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes për të cilën janë mbajtur.

Në këtë shoqëri mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit.

Evidentohet mospërputhje e parashikimeve të gjithë kontratave të personelit të lidhura gjatë periudhës objekt auditimi me parashikimet e rregullores së brendshme lidhur me llojet e masave disiplinore. Më konkretisht, rregullorja e brendshme në nenin 14 të saj parashikon këto masa disiplinore: zbritje në pozicion pune, vërejtje, vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, pushim nga puna. Ndërkohë që kontratat e lidhura gjatë periudhës së auditimit parashikojnë këto masa disiplinore: qortim, vërejtje me shkrim, paralajmërim për pushim nga puna, ulje e përkohshme e nivelit të pagës ose ndërprerje e përkohshme, ndërprerje e paralajmëruar ose e menjëhershme e marrëdhënieve të punës.

Mangësi në vlerësimin dhe marrjen e masave të nevojshme të menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj risqeve që kërcënojnë shoqërinë. Konkretisht regjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi menaxhimi. Gjithashtu, Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është krijuar, dhe për pasojë nuk funksionon. Gjatë vitit 2018 kanë rezultuar rreth 370 avari rrjeti, çarje tubacionesh, të cilat kanë ndodhur kryesisht për shkak të rrjetit të amortizuar. Dëmtimet e shpeshta të rrjetit pamvarësisht nga rikuperimi i shpejtë, mungesa e përcaktimit dhe regjistrimit të servituteve të kalimit të rrjetit në prona private, lidhje të paligjësme të shumta, mungesa e stafit përkatës në sektorin teknik, mungesa e materialeve apo investimeve, cilësia e ulët e kontrollit të brendshëm, tregojnë se rikuperimi i proceseve apo sistemeve është i ngadaltë. Kjo do të thotë se ndikimi i kategorisë së riskut operacional është i lartë. Nga auditimi konstatohet se menaxhmenti jo vetëm nuk identifikon riskun përkatës, por edhe nuk e regjistron atë në regjistrin e riskut me qëllim ndjekjen dhe monitorimin si edhe marrjen e masave për reduktimin e tij. Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë, nuk ka ndërmarrë aktivitete të mjaftueshme për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënien dhe menaxhimin e riskut. Struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Ka sektorë që nuk janë organizuar në përputhje me natyrën e punës dhe efektivitetin e saj. Mjafton të përmendim Sektorin Teknik, i cili duhet të përfshijë funksionin e azhurnimit të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve, gjithashtu regjistrimin e servituteve të kalimit të rrjetit në prona private. Në rregulloren e brendshme të shoqërisë rregullat apo proceset të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësisive, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës dhe procedurat. Proceset kryesore si p.sh prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe furnizimi i ujit të pijshëm, faturimi, mbledhja e të ardhurave etj., nuk përfshijnë veprimtari të mjaftueshme të kontrollit, për të parashikuar masa të nevojshme për përcaktimin e prioriteteve dhe arritjen e objektivave. Kështu p.sh normat e arkëtimit vazhdojnë të jenë të ulta në zonën rurale. Vetëm gjatë muajit gusht 2019 norma e arkëtimit në fshat rezulton 48 %, nga ku arkëtimi aktual është 2,468, mijë lekë dhe faturimi 5, 136 mijë lekë. Gjithashtu, norma e arkëtimit në



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

qytet rezulton 75 % ku arkëtimi aktual rezulton 19, 295 mijë lekë dhe faturimi 25, 880, mijë lekë. Sa sipër, për gjashtëmujorin e vitit 2019, sipas zonës së juridiksionit, popullsia në zonën rurale shkon rreth 93 403 banorë dhe ajo në zonën urbane 115 215 banorë. Gjithashtu, deri në Gusht të vitit 2019 numri aktual i lidhjeve të regjistruara nga UK Shkodër ndahet në 85% ose 26 628 klientë në zonën urbane, dhe 15% ose 4579 klientë në zonën rurale.

Shoqëria UK Shkodër SH.A zotëron 3 sisteme kanalizimesh me ngritje mekanike, 21 sisteme ujësjellësi me ngritje mekanike dhe 2 sisteme ujësjellësi me rrjedheje të lirë. Qyteti i Shkodrës furnizohet nga 11 puse të vendosura në fushën e Dobraçit e cila shtrihet në veri të qytetit. Këto puse nëpërmjet pompave e dërgojnë ujin në dy rezervuarë të ndërmjetëm 1000 m<sup>3</sup> dhe 150 m<sup>3</sup>, nga ku uji merret nëpërmjet dy stacioneve të pompimit.

Në kuadër të zbatimit të politikave komerciale shoqëria ka instaluar platformën elektronike Al-billing, e cila kryen administrimin si për të dhënat e klientit ashtu edhe për proceset komerciale. Nga auditimi konstatohet se procesi i faturimit përbëhet nga nën-menutë si Regjistrimi i Konsumit, Regjistrim Konsumi Liste, Regjistrim Konsumi Liste Indeks, Regjistrim Tarifah të Tjera, Anullo Konsum, Anullo Aforfe, Lista e Konsumit, Hap Muaj Faturimi, regjistro Tarifë Zbritje dhe Anullo Taksa. Gjithashtu, procesi i leximit përbëhet nga Ngarkimi i Leximeve, Proceso Faturim Mujor, Kalimi i Leximeve për Lexuesit. Kështu p.sh. Praktika e leximit fillon me hapjen e faturimit nga Përgjegjësi i ITsë , pastaj kryhet ngarkimi i aparateve ( portativ të tipit data logic ose smart phone) në listën e matësve për lexim në datat 10 dhe 11 të çdo muaji, më tej dorëzimi i aparateve tek specialisti i IT ne datën 25 të muajit për shkarkimin e të dhënave në sistem. Nëse në procesin e leximit është integruar një aktivitet kontrolli, kontrolli i konsumit nën 0 m<sup>3</sup> dhe mbi 50 m<sup>3</sup>, nuk ndodh kështu me proceset e tjera. Nga auditimi konstatohet se ato janë ndërtuar për të ndihmuar kryesisht punën e stafit. Proceset nuk përmbajnë një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave, në mënyrë që të parashikojnë mënyrën e realizimit si edhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Në kushtet kur pothuaj gjysma e klientëve nuk janë të pajisur me matje, proceset e arkëtimit, të faturimit, të ankesave nuk përbëjnë procese të plota për të ndërtuar gjurmët e auditimit nga fillimi deri në fund të procesit. Dokumentacioni që shoqëron këto procese nuk rezulton i miratuar, gjithashtu lista e proceseve dhe gjurmët e auditimit nuk rezultojnë të arkivuara.

Shoqëria nuk ka një laborator kimik për monitorimin e brendshëm të cilësisë të ujit të pijshëm, Drejtoria e Shëndetit Publik Rajonal Shkodër kryen kontrollet rutinë të ujit të papërpunuar dhe të ujit të pijshëm të rrjetit. Ajo ka përcaktuar 26 pika kontrolli të ujit të pijshëm të shpërndara në të gjithë rrjetin. Kampionet e ujit merren çdo ditë dhe bëhen me dije nëpërmjet Qndrës Dispeçer të UK Shkodër SH.A. Por, shoqëria ka përgjegjësinë e proceseve të dezinfektimit dhe klorinimit, dhe konstatohet se nuk ka një rregulore specifike për të përfshirë aktivitete kontrolli.

Një nga problemet e trashëguara në UK Shkodër janë humbjet e ujit në rrjet. Sipas bilancit të ujit për vitin 2018 volumi i ujit të prodhuar i vlerësuar nga shoqëria rezulton 12 264 599 m<sup>3</sup>, nga ku 4 161 212 m<sup>3</sup> përbën konsumin e ujit të faturuar ose 33 % dhe pjesa tjetër janë humbjet teknike dhe jo teknike. Sa sipër, sipas bilancit 7 536 741 m<sup>3</sup> ujë ose 61 % janë humbje nga lidhje të paligjëshme, të cilat vlerësohen nga shoqëria se vijnë nga zonat periferike të qytetit dhe lidhjet në rrjetin shpërndarës, që kalojnë nëpër territore private.

Në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” Sh.a. shërbimi arkivor funksionon në një shkallë të ulët. Në kundërshtim me pikën 1, neni 7 të Ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

shoqëria nuk ka krijuar Komisionin e Ekspertizës, dhe për rrjedhojë ky komision nuk funksionon. Në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, të VKM Nr.4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njehësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, shoqëria nuk ka krijuar pasqyrën emërtuese të çeljes së dosjeve. Nuk është përpiluar lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave me rëndësi historike dhe kombëtare. Nuk bëhet përpunimi tekniko shkencor i dokumenteve të prapambetura. Nuk rezulton të jetë bërë ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve me qëllim përcaktimin e vlerës dhe kohës së ruajtjes së dokumenteve. Sa sipër, nuk krijon mundësi për të përcaktuar procedura të qarta dhe të njësuara në të gjithë rrjetin arkivor kombëtar për të mundësuar realizimin e përpunimit tekniko-shkencor, ruajtjen e dokumentacionit në arkiva dhe brenda afateve të përcaktuara.

#### **III.c. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit**

Nga auditimi mbi përputhshmërinë sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti - Shoqëria “Ujësjetellës- Kanalizime Shkodër” Sh.a të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat janë materiale, por jo të përhapura, në: Dëm ekonomik me vlerë 28,665,444 lekë, në procedurat e prokurimit, zbatimin e kontratave të mallrave (pajisjeve) në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10.

#### **Opinion i Auditimit**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të Shoqërisë “Ujësjetellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000<sup>1</sup> dhe 4100<sup>2</sup>.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se aktiviteti i shoqërisë, për shkak të rëndësisë të anomalive të trajtuara në këtë raport, ka devijime materiale, por jo të përhapura, në drejtim të zbatimit të kuadrit nënligjor dhe rregullator dhe në veçanti të legjislacionit specifik, në lidhje me mos rritjen (zmadhimin) e kapitalit pas rivlerësimit të aseteve, zbatimin e kontratave për punë publike (pajisjet), organizimin dhe funksionim e organeve drejtuese, kryerjen e transaksioneve financiare për shpenzimet, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, miratimin e pikave të lidhjes të ujit, menaxhimin financiar dhe kontrollin, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, etj,

<sup>1</sup> ISSAI 4000 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë.

<sup>2</sup> ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar<sup>3</sup>.

#### Baza për Opinionin

Për gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet, jemi dakortësuar me menaxhmentin e shoqërisë, si dhe jemi siguruar prej Tij, që vendimmarrjet në ardhmen të jenë më të spikatura, që të japin shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, menaxhmenti i kësaj Shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria “Ujësjellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër, theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Menaxhmenti i shoqërisë është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet e dispozitave ligjor në fuqi. Gjithashtu menaxhmenti e shoqërisë është përgjegjës kryesor për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi të kësaj shoqërie, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë.

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse aktiviteti i shoqërisë, nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo

<sup>3</sup> Devijimi i përputhshmërisë nuk është aq material sa të shkaktojë një konkluzion negativ. Pjesët hyrëse mbi përgjegjësitë e menaxhimit dhe audituesve, si dhe pjesët mbyllëse të raportit janë të njëjta me ato të paraqitura.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të aktivitetit. Gjithashtu, në u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 601/1 prot., datë 09.09.2019, nga data 11.09.2019 deri më datë 04.11.2019, në Shoqërinë “Ujësjiellës- Kanalizime Shkodër” Sh.a për periudhën nga data 01.07.2017 deri më datë 31.08.2019, u krye auditimi “Përputhshmërisë” me përbërje:

1. F.I., Përgjegjës grupi,
2. E.S., Auditues,
3. A.R., Auditues,
4. A.H., Auditues,
5. E.S., Auditues,

**a. Titulli:** Raport Përfundimtar Auditimi mbi auditimin e “Përputhshmërisë” në Shoqërinë “Ujësjiellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër.

**b. Marrësi:** Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër” Sh.a, me Administrator M.M..

**c. Objektivat dhe qëllimi:** Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH, është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, termave dhe kushteve, në përputhje me ligjin e buxhetit të shtetit, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Shoqërisë. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Gjithashtu, raporti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë*, ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik, duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

**d. Identifikimi i çështjes:** Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

**e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e Shoqërive të reja, si edhe pjesëmarrjen në kapitalin e Shoqërive të tjera jashtë vendit.

Në zbatim të dispozitave ligjore, U.K. Shkodër sh.a. merr masa për:

- Krijimin e kushteve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së punonjësve të Shoqërisë.
- Zbatimin e rregullave Higjieno – Shëndetësore në punë.
- Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbarëvajtjen në punë.
- Zbatimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri.
- Zbatimin e dispozitave të vendosura në Kontratën Kolektive të Punës.

**f. Përgjegjësitë e audituesve:** Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

**g. Kriteret e vlerësimit:** Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar; Ligji nr. 8901, datë 23.05.20012 “Për falimentin”, i ndryshuar; Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar”, Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” ; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë”, i ndryshuar”; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK”; VKM nr. 236, datë 10.5.1993 “Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar”, i ndryshuar; VKM nr. 63, 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr. 781, datë 14.11.2007, ndryshuar; VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”; etj; Metodika mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009; Kontrata e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 04.02.2011 “Për miratimin e modelit të kontratës tip”; Udhëzimi i Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr. 3, datë 28.07.2004 “Për administrimin e ujit të pijshëm”; Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”; Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar; akti i themelimit; statuti dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë.

#### **h. Standardet e auditimit:**

- ISSAI 100 – *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik).*
- ISSAI 4000 – *(Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).*
- ISSAI 4100 - *(Rregulloren e Procedurave të Auditimit).*
- Kodi etik i KLSH.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, VKM nr. 63, 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

- Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:
- Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
- Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre;
- Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

-Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, liçensat sipas legjislacionit në fuqi;

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria (pajtueshmërisë) e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga 01.07.2017 deri më datë 31.08.2019.

Qëllimi i auditimit është hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të Shoqërisë “Ujësijellës- Kanalizime Shkodër” Sh.a.

Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar riorganizimi i shoqërisë, shpenzime për investime, shpenzimet operative, shpërblimet dhe pagat, programimi ekonomik dhe realizimi i tij, etj. Është audituar vendimmarrja e organeve drejtuese, si dhe menaxhimi financiar dhe kontrolli.

#### **Dokumentimi i rezultateve të auditimit:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

## **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.**

**1. Titulli i gjetjes:** Shoqëria “Ujësijellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër, nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të dhëna nga auditimet e mëparshme. Konkretisht janë rekomanduar 36 masa organizative nga KLSH, të cilat janë pranuar dhe zbatuar. Nga masat e zbatuara 3 masa janë në proces dhe 30 janë pranuar, por zbatimi është dhe në vijimësi.

Janë rekomanduar 5 masa për shpërblim dëmi me vlerë totale 6,934,888 lekë, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, nga masat e zbatuara 2 masa në vlerën 5,727,052 lekë janë zbatuar plotësisht, ndërsa 3 masa në vlerën 1,207,836 lekë, janë zbatuar, por realizimi është në proces.

Për eliminimin e efekteve negative financiare janë rekomanduar 6 masa në vlerën 38,846,003 lekë, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, nga masat e zbatuara 2 masa në vlerën 33,705,545 lekë janë zbatuar plotësisht, ndërsa 4 masa në vlerën 5,140,458 lekë, janë pranuar, por kërkohet vijueshmëria e zbatimit edhe në të ardhmen.

Janë rekomanduar 19 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 18 dhe 1 masë nuk është zbatuar. Mos zbatimi i një mase disiplinore është kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c.

**Kriteri:** Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c, ku përcaktohet:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

*Kontrolli I Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:*

*c) t'u rekomandojë drejtuesve të njëjësive të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative.*

**Ndikimi/efekti:** Mos eficientë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë “Ujësjellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër.

**Shkaku:** Keq interpretim të dispozitave ligjore në fuqi.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Nga Shoqëria “Ujësjellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

*Në mënyrë të detajuar zbatimi i rekomandimeve është paraqitur në aktkonstatimi nr.4, datë 01.11.2019 mbajtur me personat përgjegjës.*

## **2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.**

**1.Titulli i Gjetjes:** Anëtarët e Këshillit të Administrimit të UK Shkodër nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua që bazuar në pikën 3 të nenit 12 të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe pikën 3 të nenit 12 të Statutit të UK Shkodër SHA, anëtarët e Këshillit të Administrimit duhej që në momentin e emërimit të lidhnin me shoqërinë një kontratë ku jetë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritej t’i arrinin në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë duhet të miratoheshin edhe nga ministria e linjës dhe duhet të ishin të matshme në përputhje me biznes planet e shoqërisë. Grupi i auditimit evidenton se mes UK Shkodër SHA dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit nuk janë lidhur kontrata, por të vetmet akte të hartuara në momentin e emërimit të tyre janë vendimet e riemërimit të tyre nga Asambleja e Përgjithshme e UK Shkodër SHA, më konkretisht: Vendimi nr. 5, datë 30.05.2019 për riemërimin si administrator të UK Shkodër të M.M., Vendimi nr. 6, datë 30.05.2019 për riemërimin si anëtar të Këshillit të Administrimit të A.D., Vendimi nr. 7, datë 30.05.2019 për riemërimin si anëtare e Këshillit të Administrimit të V.G..

**Kriteri:** Pika 3 e nenit 12 të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, si dhe pika 3 e nenit 12 të Statutit të UK Shkodër SHA.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesa e kritereve dhe objektivave për matjen e performancës vjetore të Anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

**Rëndësia:** E lartë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

#### **Rekomandime:**

1. Nga kryetar i Bashkisë Shkodër në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të lidhen kontrata me anëtarëve e Këshillit të Administrimit, në të cilat të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë.
2. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë, duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet jenë të matshme në përputhje me biznes planet e UK Shkodër SHA.

**2. Titulli i Gjetjes:** Rinovimi vjetor i kontratës së Administratorit nuk është bërë bazuar në vlerësimet vjetore pozitive të performancës të punës së tij.

**Situata:** Bazuar në parashikimet e VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, si dhe të Statutit të UK Shkodër SHA, pavarësisht se Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vitesh, qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë kontratash të rinovueshme vjetore mes tij dhe Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performancës së tij. Grupi i auditimit nuk evidenton rinovimin e kontratës së Administratorit për periudhën objekt auditimit. I vetmi akt i vendosur në dispozicion është Vendimi nr. 5, datë 30.05.2019 i Asamblesë së Përgjithshme të UK Shkodër SHA, për riemërimin si administrator të UK Shkodër të Mark Molla. Mbas këtij akti duhet të ishte lidhur kontrata.

**Kriteri:** Pika 5 e nenit 18 të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, si dhe pika 5 e nenit 18 të Statutit të UK Shkodër SHA.

**Ndikimi/Efekti:** Mungesë e vlerësimeve vjetore të performancës së Administratorit, të bazuara në kritere/objektiva të qarta kontraktore.

**Rëndësia:** E lartë.

#### **Rekomandime:**

1. Në zbatim të vendimit nr. 5, datë 30.05.2019 të Asamblesë së Përgjithshme, të lidhet kontratë me Administratorin e Shoqërisë, në të cilën të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës së Administratorit, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë.

**3. Titulli i Gjetjes:** Dhënie e masave disiplinore jashtë kompetencës nga Këshilli i Administrimit.

**Situata:** Në parashikimet e Rregullores së brendshme të UK Shkodër të nxjerrë nga Këshilli i Administrimit evidentohen parashikime juridike të cilat janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe shkaktojnë problematika lidhur me përcaktimin e organit kompetent për përcaktimin e masave administrative. Më konkretisht, evidentohet se neni 7 i Rregullores i njej kompetencën për marrjen e masave disiplinore eprorit direkt të punonjësit, ndërsa neni 14 ia njej këtë kompetencë “Administratorit/Drejtorit”. Këto parashikime nuk evidentojnë qartësisht organin kompetent për marrjen e masave administrative ndaj punonjësve duke ia njohur këtë kompetencë: administratorit/ drejtorit dhe eprorit direkt. Pra potencialisht, për të njëjtin punonjës, mund të pretendojnë kompetencën për marrjen e masës disiplinore të dy nëpunësit e sipërcituar, duke çuar potencialisht edhe në dy vendime të ndryshme.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Në praktikë, evidentohet që pavarësisht parashikimeve të mësipërme të rregullores së brendshme, masa disiplinore janë dhënë edhe nga Këshilli i Administrimit, organ ky i cili në asnjë akt juridik të vendosur në dispozicion nuk e ka një kompetencë të tillë. Më konkretisht, me Vendimet nr. 15, 16, 17 datë 20.03.2019 Këshilli i Administrimit ka vendosur dhënien e masës disiplinore:

- “ulje në pozicion pune” për punonjësen B.O. nga kryearkëtare në arkëtare;
- “vërejtje me paralajmërim largim nga puna” ish-drejtoreshës tregtare A.S.;
- “vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” ish-përgjegjëses së degës së shitjes A.S..

**Kriteri:** Statuti dhe Rregullorja e brendshme e UK Shkodër SHA.

**Ndikimi/Efekti:** Tre punonjës të UK Shkodër SHA kanë marrë masë disiplinore nga një organ jo kompetent.

**Rëndësia:** e lartë.

#### **Rekomandime:**

1. Nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë të bëhet amendim i rregullores së brendshme lidhur me dhënien e masave disiplinore për punonjësit.
2. Administratori i Shoqërisë në kompetencat ligjore, statusore dhe rregullatore të rivlerësoj dhënien e masës disiplinore për: B.O. me detyrë kryearkëtare, A.S. me detyrë ish-drejtor tregtar, A.S. me detyrë ish-përgjegjës i degës së shitjes.

**4.Titulli i Gjetjes:** Nuk janë publikuar në faqen e internetit të shoqërisë të dhënat e detyrueshme për publikim

**Situata:** Evidentohet mosrespektim i parashikimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” lidhur me publikimin në faqen e internetit të UK Shkodër të dokumentacioneve të detyrueshme për t’u publikuar sipas parashikimeve të këtyre akteve, ndër të tjera lidhur me procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të cilat duhet të ishin të publikuara në faqen zyrtare të internetit të UK Shkodër jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes për të cilën janë mbajtur.

**Kriteri:** Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe në ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”:

**Ndikimi/Efekti:** Cënim i së drejtës për informim.

**Shkaku:** Mosrespektim i parashikimeve ligjore lidhur me transparencën në vendimmarrje dhe të drejtën për informim.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për publikimin në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë të dhënat/dokumentet e detyrueshme për tu publikuar.

#### *Koment i grupit të auditimit*

Me observacionin nr. 1655/1 prot., datë 13.12.2019, për gjetjen lidhur me mungesën e kontratave të anëtarëve të Këshillit të Administrimit me shoqërinë, pretendohet se Administratori, si anëtar i



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

KA nuk ka me kë të lidhë kontratë, si dhe se kriteret e performancës janë për shoqërinë dhe jo për anëtarët e KA, i cili është organ kolegjal.

Këtë observacion nuk e gjejmë të bazuar, për shkak se pika 3 e nenit 12 të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe pika 3 e nenit 12 të Statutit të UK Shkodër SHA parashikojnë qartësisht se anëtarët e Këshillit të Administrimit duhet që në momentin e emërimit të lidhnin me shoqërinë një kontratë në të cilën të jenë parashikuar, ndër të tjera, kriteret e qarta performance që pritet t’i arrijnë në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshme në përputhje me biznesplanet e shoqërisë. Më konkretisht, në të dy aktet e përmendur më sipër, me të njëjtën përmbajtje parashikohet në mënyrë eksplicite se: “Anëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit lidhin me shoqërinë një kontratë, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kriteret e qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznesplanet e shoqërisë.”

Pretendimi se Këshilli është një organ kolegjal dhe jo individual. Në këtë kuadër shprehja “kriteret e qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit” ose ka nevojë për interpretim ose duhet të jetë objekt rishikimi nga organet kompetente, pasi anëtarët e këshillit nuk kanë kompetenca të ndarë dhe në aspektin e vendimmarrjes secili nga ato ka të drejtën e një vote, pra kanë vendimmarrje të barabartë. VKM i referohet kompetencave të Këshillit, jo të anëtarit në këtë kuadër “performance” e anëtarit duhet të shihet mbi bazën e disa kriterëve, por që në fakt ligji as VKM nuk i ka të parashikuara për anëtarët nuk qëndron. Grupi i auditimit nuk mund të diskutojë teknikën legislative të hartimit të VKM nr. 63, datë 27.1.2016, ku në pikën 3 është shprehur në mënyrë eksplicite është shprehur se “Anëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kriteret e qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznesplanet e shoqërisë”.

Pretendimi lidhur me dhënien e masave disiplinore për tre punonjës të UK Shkodër SHA nga Këshilli i Administrimit në mungesë të një kompetence të tillë, pretendohet se fakti se është Administratori ai që ja ka propozuar KA-së dhënien e këtyre masave, si dhe se gjendeshin para një dëmi ekonomik për shoqërinë, dhe se KA ka si kompetenca administrimi edhe kompetenca mbikëqyrje, e ligjërojnë KA të japë masa disiplinore.

Këtë observacion nuk e gjejmë të bazuar për shkak se as në ligj, VKM që miraton statutin tip të SHA-ve, Statut dhe as në Rregulloren e shoqërisë nuk i njihet KA kompetenca për dhënien e masave disiplinore. Përkundrazi, në Statutin e shoqërisë parashikohet në mënyrë eksplicite se: “Administratori drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.”

### **3. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

- 1) Programi ekonomik-financiar për vitin 2017, miratimet e programit realizimi dhe raportimi i tij;
- 2) Programi ekonomik-financiar për vitin 2018, miratimet e programit realizimi dhe raportimi i tij;
- 3) Programi ekonomik-financiar për vitin 2019, miratimet e programit realizimi dhe raportimi i tij;

**Titulli i Gjetjes:** Raportimi nga “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër në lidhje me realizimin e programeve dhe treguesit e performancës, për vitet 2017, 2018 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 ka mospërputhje të të dhënave të raportuara në Administrim dhe në AKUK lidhur me të numrin e lidhjeve me rrjetin e ujësjetllës kanalizimeve si dhe mospërputhje të të dhënave të sasisë së prodhuar të ujit.

Shoqëria nuk ka zbatuar detyrimin e raportimit pranë prefektit të qarkut dhe Administratori i Shoqërisë nuk ka zbatuar detyrimin ligjor të raportimit një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë pranë Këshillit të Administrimit dhe paraqitjen ç’do vit përpara Asamblesë së Përgjithshme të raportit të veprimtarisë së shoqërisë.

**Situata:** Sa i përket raportimit në lidhje me realizimin e programeve dhe treguesit e performancës Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a. ka dërguar ç’do tre mujor në Agjencinë Kombëtare të Ujësjetllës kanalizimeve pyetësorët përkatës. Raportimi i të dhënave të numrit të lidhjeve hartuar nga përgjegjësi për planifikim dhe raportim për tre mujorin e tretë të vitit 2017 dhe për tre mujorin e dytë të vitit 2019 nuk përputhet me raportimin e këtyre të dhënave në AKUK, pasi për 3 mujorin e dytë të 2017 i janë raportuar administrimit të shoqërisë 84,700 lidhje ndërsa në AKUK janë raportuar 27,089 të tilla. Gjithëashtu për tre mujorin e dytë të vitit 2019 janë raportuar në administrim 31,687 lidhje dhe në AKUK 31,075 të tilla.

Diferenca në raportim evidentohen edhe te sasia e prodhuar e ujit në (m<sup>3</sup>) për tre mujorin e dytë të 2019, pasi në raportim për administrimin janë 3,368,800 m<sup>3</sup> ujë të prodhuar, ndërsa në raportimin në AKUK rezultojnë 3,326,413 m<sup>3</sup> ujë të prodhuar, për vitin 2018 në administrim është raportuar një prodhim prej 12,490,293 m<sup>3</sup> ujë, ndërsa në AKUK është raportuar 10,177,495 m<sup>3</sup> ujë, pra 2,312,798 m<sup>3</sup> ujë më pak se ç’janë prodhuar realisht.

Ujësjetllës Kanalizime Shkodër ka bërë raportime ç’do tre mujore në AKUK konform pyetësorit sipas formatit të përcaktuar prej saj. Shoqëria nuk ka zbatuar detyrimin e raportimit pranë prefektit të qarkut.

Administratori i shoqërisë nuk ka zbatuar detyrimin ligjor të raportimit një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë pranë Këshillit të Administrimit dhe paraqitjen ç’do vit përpara Asamblesë së Përgjithshme të raportit të veprimtarisë së shoqërisë.

**Kriteri:** Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 12 pika 3 ë), nenin 18 pika 7 ç) dhe dh) dhe nenin 20 pika 2 të, VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

**Ndikimi/Efekti:** Kjo ka sjellë informim të pasaktë të Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme të “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër si dhe të AKUK në lidhje me performancën e institucionit.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e moszbatimit të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Drejtoria Tregtare e “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër të marrë masa që raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar, të jenë të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko ekonomik të shoqërisë.

Administratori i shoqërisë të marrë masa për të raportuar ç’do muaj për ecurinë e shoqërisë pranë Këshillit të Administrimit dhe ç’do vit përpara Asamblesë së Përgjithshme, si dhe të raportojë pranë Prefektit të Qarkut Shkodër.

*Koment i grupit të auditimit*

**Titulli i Gjetjes:** “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër nuk ka bërë bilancin e ujit (analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike menaxheriale), nuk ka bërë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, nuk ka bërë plotësisht evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve dhe nga auditimi rezulton se shoqëria merr më pak para nga konsumatorët sesa uji, që këta të fundit kanë konsumuar, pasi mesatarisht për tre vitet (2017, 2018 dhe gjashtë mujori i parë i 2019), 41.23 % e konsumatorëve nuk janë të pajisur me matës dhe faturohen afrofe, duke bërë që shitja e furnizimit me ujë të mos llogaritet në bazë të konsumit real vlerësuar nëpërmjet aparateve matëse.

**Situata:** Nga “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, nuk është bërë bilanci i ujit (analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike menaxheriale). Në programet ekonomike, humbjet nuk janë parashikuar të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale).

Shoqëria nuk ka bërë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, duke përcaktuar afatin konkret të pajisjes së tyre 100 % me matës.

Shoqëria nuk ka bërë plotësisht evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve duke koordinuar punën me sektorët përkatës, për debitorët që nuk likuidojnë detyrimet përkatëse.

Referuar të dhënave nga Drejtoria Teknike rezulton se për vitin 2017, nga 27,326.67 lidhje të ujit në mesatare vjetore, vetëm 14,889.25 janë të pajisur me ujëmatës, pra 45.5% e klientëve nuk janë të pajisur me ujëmatës dhe faturohen afrofe. Për vitin 2018, nga 30,041.67 lidhje të ujit gjithësej në mesatare vjetore, vetëm 17881.17 janë të pajisur me ujëmatës, pra 40.47 %, ndërsa për gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, nga 30,975.7 lidhje të ujit gjithësej mesatare për gjashtë muaj, vetëm 19,286.2 janë të pajisur me ujëmatës, pra 37.73% e klientëve nuk janë të pajisur me ujëmatës dhe faturohen afrofe. Për rrjedhojë të dhënat lidhur me faturimin e ujit ndryshojnë në sasi dhe në vlerë duke rezultuar në një përqindje më të lartë të faturuar të sasisë së ujit krahasuar me vlerën e faturuar në lekë. Sa më sipër rezulton se se UK sha Shkodër merr më pak para nga konsumatorët sesa uji, që këta të fundit kanë konsumuar, duke ndikuar kështu në humbjen e shoqërisë.

**Kriteri:** Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8975 datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar si dhe nenin 40 pika 1 dhe Ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**Ndikimi/Efekti:** Kjo ka bërë që UK sha Shkodër të mos ketë një analizë mbi humbjet teknike dhe ekonomike menaxheriale, të mos ketë evidentim, klasifikimin dhe ndjekje të debitorëve që nuk janë të pajisur me matës dhe të veprojë në mungesë të një plani të detajuar për paisjen 100 % me matës e konsumatorëve, gjë e cila ka sjellë si pasojë që shoqëria të marrë më pak para nga konsumatorët sesa uji, që këta të fundit kanë konsumuar.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e moszbatimit të Ligjin nr. 8975 datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar nenin 40 pika 1 dhe Ligjit nr.9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandime:** Nga Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër për vitin 2019, të bëhet bilanci i ujit, analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxheriale). Në programin ekonomik të vitit pasardhës, humbjet të parashikohen të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale).

Për veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi M. M. me detyrë Administrator i “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër

**Titulli i Gjetjes:** Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, që në fazën e planifikimit ka parashikuar humbjen e shoqërisë, pasi parashikon në programet e saj ekonomike shpenzime të pajustificuara nga planifikimi për të ardhurat. Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese, megjithatë nga organet drejtuese të shoqërisë nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

**Situata:** Nga analiza e treguesve për të dy vitet 2017, 2018 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 konstatojmë se treguesit e të ardhurave e shpenzimeve janë në mosrealizim të programit. Mosrealizimi i treguesve ekonomik në raport me programin tregon se shoqëria nuk ka arritur të plotësojë objektivat e saj, pasi aktiviteti i shoqërisë paraqitet me humbje duke qenë se të ardhurat që sigurohen nga aktiviteti nuk mund të mbulojnë shpenzimet.

Për të tre vitet 2017, 2018 dhe 2019, “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër nuk ka shqyrtuar në mënyrë analitike humbjet, duke i ndarë ato në humbje menaxheriale dhe humbje teknike, c’ka pamundëson njohjen e shkaqeve të këtyre humbjeve dhe marrjen e masave për reduktimin e tyre.

**Kriteri:** Sa më sipër është në kundërshtim me parimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” të shprehura në nenin 5.

*Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike.*

**Ndikimi/Efekti:** Nga kjo rezulton se UK Shkodër sha.a ka hartuar dhe zbatuar programet ekonomiko-financiare në kundërshtim me parimet e economicitetit, efikasitetit dhe efencës, duke mos bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimit publik të furnizimit me ujë dhe grumbullimit, trajtimit e largimit të ujrave të ndotura.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e moszbatimit të parimeve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” si dhe mungesës së analizimit, shqyrtimit dhe marrjes së masave nga organet drejtuese të shoqërisë për reduktimin e humbjeve.

**Rëndësia:** E lartë.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**Rekomandime:** Drejtoria Tregtare e shoqërisë, në cilësinë e hartueses dhe zbatueses së programeve ekonomiko-financiare të marrë masa që hartojë dhe zbatojë programe nëpërmjet të cilave të planifikojë, drejtojë dhe kontrollojë burimet financiare, në mënyrë që të ofrojë me efikasitet dhe efektshmëri shërbimet publike.

Organet Drejtuese të “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, (Administratori, Këshilli i Administrimit, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

Për veprimet e mësipërme, bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, mbajnë përgjegjësi M.M., Administratori i shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare e “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër

Sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3 datë 01/11/2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr. 1471/1 Prot. datë 05/11/2019 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht sqarohet se planifikimi i shpenzimeve bëhet vetëm për zhvillimin e një aktiviteti normal bazuar në kërkesat e sjella nga gjithë sektorët e punës pranë zyrës së planifikimit. Sa më sipër asnjë nga shpenzimet nuk është i pajustificueshëm. Shoqëria ka marrë nën administrim dhe operon të gjitha sistemet e furnizimit të zonës rurale dhe shpenzimet kanë qenë të detyrueshme.

**Titulli i Gjetjes:** Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, nuk ka hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomiko-financiare, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët për vitet 2017 dhe 2018, kanë çuar në tejkalim të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar. Kjo ka bërë që tejkalimet në zërat e shpenzimeve për këto dy vite të jenë të pa miratuar.

**Situata:** Programi ekonomik dhe financiar 2018 i “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër është miratuar me Vendim të Këshillit Administrimit me nr. 1, datë 25.01.2018 dhe me vendim të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë nr. 1, datë 01.02.2018. Për këtë program janë miratuar tre rishpërndarje fondesh nga Këshilli i Administrimit të “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, përkatësisht me vendim nr. 12, datë 12.06.2018, vendim nr. 17, datë 07.09.2018 dhe me vendim nr. 19, datë 26.10.2018.

Programi ekonomik dhe financiar 2019 i Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, është miratuar me Vendim të Këshillit Administrimit me nr. 1, datë 05.02.2019 dhe me vendim të Asamblesë së Aksionerëve të shoqërisë nr. 2, datë 08.02.2018. Për këtë program janë miratuar deri në muajin gusht 2019 pesë rishpërndarje fondesh nga Këshilli i Administrimit të “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, përkatësisht me vendim nr. 18, datë 11.04.2019, vendim nr. 19, datë 22.05.2019, vendim nr. 20, datë 18.06.2019, vendim nr. 21, datë 04.07.2019 dhe me vendim nr. 24, datë 19.08.2019.

Nga ana e shoqërisë nuk janë bërë analiza dhe vlerësime të hollësishme tekniko-ekonomiko-financiare dhe përcaktimi i treguesve të shpenzimeve të programit të zhvillimit nuk është bërë i studiuar, duke i bërë ato të mos jenë të sakta, reale e të besueshme, pasi për vitet 2018 dhe 2019 programi ekonomik e financiar është ndryshuar tetë herë.

Nga analizimi i shpenzimeve të programuara e realizuara për vitin 2017, konstatojmë se ka patur tejkalim të shpenzimeve vjetore në raport me ato të programuara për zërin shërbim i rojeve, me 42% më shumë se ato të programuara duke përfshirë edhe shtesën e programit. UK sh.a. Shkodër nuk ka hartuar apo miratuar ndryshim të programit ekonomik-financiar, shoqëruar me relacion



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët kanë çuar në rritjen me 42% të këtij shpenzimi në raport me parashikimin dhe miratimin.

Ndërsa nga analizimi i shpenzimeve të programuara e realizuara për vitin 2018, konstatojmë se tejkalimi i shpenzimeve vjetore në raport me ato të programuara ka ndodhur për zërat energji elektrike, blerje diesel dhe vaji si dhe për shërbimin e rojeve. UK sh.a. Shkodër as në këtë rast nuk ka hartuar apo miratuar ndryshim të programit ekonomik-financiar, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët kanë çuar në rritjen e këtyre zërave të shpenzimeve në raport me parashikimin dhe miratimin.

**Kriteri:** Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 13, pika 4, nenin 18, pika 7 dhe nenin 20, pika 2 c) të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

**Ndikimi/Efekti:** Kjo ka bërë që tejkalimet në zërat e sipërcituar të shpenzimeve, të jenë të pamiratuara.

Rishpërndarja e fondeve përmes ndryshimeve në programin ekonomik dhe financiar disa herë brenda vitit tregojnë se nga ana e shoqërisë nuk janë bërë analiza dhe vlerësime të hollësishme tekniko-ekonomiko-financiare dhe përcaktimi i treguesve të shpenzimeve të programit të zhvillimit nuk është bërë i studiuar, duke i bërë ato të mos jenë të sakta, reale e të besueshme.

**Shkaku:** Situata e sipërcituar ka ndodhur si pasojë e moszbatimit të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandime:** Këshilli Administrimit të miratoj në kohë programin ekonomik-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi Administrimi dhe Drejtoria Tregëtare e “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër

#### **Në zbatim të pikës 11 të programit të auditimit “Mbi pikat e lidhjes së furnizimit me ujë të pronave të përdoruesve”, u shqyrtua:**

Dokumentacioni i procedurave të aplikimit dhe realizimit për pikat e lidhjes dhe kontratat e reja familjare dhe të bizneseve në objektet e reja.

**Titulli i Gjetjes:** Cënimin e së drejtës së subjekteve për të pasur pika lidhje, duke i kushtëzuar ata me pagimin e detyrimeve të prapambetura të debitorëve/pronarëve të objekteve që shkelen nga gjurma e ndërtimit të objektit të ri.

**Situata:** Për të gjitha praktikat e shqyrtimit të kërkesave për pika lidhje u konstatua se në kundërshtim me Urdhërin nr. 221, datw 11.10.2018 të Administratorit të “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, Drejtoria Teknike e ka kushtëzuar miratimin e pikës së lidhjes me arkëtimin nga ana e subjektit kërkues të detyrimeve tw prapambetura të debitorëve/pronarëve të objekteve që shkelen nga gjurma e ndërtimit të objektit të ri. Kushtëzimet e vetme në VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

*ujësjellës kanalizime sh.a*” për të përfituar të drejtën e pikës së lidhjes, janë kërkesa me dokumentacionin teknik bashkëngjitur nga ana e aplikuesit, pagesa e tarifës së pikës së lidhjes si dhe fakti që realizimi i pikës së lidhjes të jetë teknikisht dhe financiarisht i mundshëm.

**Kriteri:** Sa më sipër, është në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a.”, ku parashikohet si edhe në kundërshtim me nenet nr. 4 dhe 41 të Ligjit Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, të ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** Cënimin e së drejtës së subjekteve për të pasur pika lidhje, duke i kushtëzuar ata me pagimin e detyrimeve të prapambetura të debitorëve/pronarëve të objekteve që shkelen nga gjurma e ndërtimit të objektit të ri.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e dështimit nga ana e administrimit të “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër në kontrollin e të gjithë klienteve të larguar në terren, mbylljen e kontratave, si dhe ndjekjen e debitorëve deri në penalizimin e tyre konform VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a.”

**Rëndësia:** E lartë.

#### **Rekomandim:**

5.1. Administratori i Shoqërisë në kompetencat ligjore, statusore dhe rregullatore të bëjë parashikime specifike (çfuqizojë dhe/ose ndreqje gabimi material) në lidhje me moscënimin e së drejtës së subjekteve për të pasur pika lidhje, duke i kushtëzuar ata me pagimin e detyrimeve të prapambetura të debitorëve/pronarëve të objekteve që shkelen nga gjurma e ndërtimit të objektit të ri. Për detyrimet e palikujduara ndaj UK nga debitorët që shkelen nga gjurma e ndërtimit të objektit të ri (pikëlidhjes) të ndiqen procedurat specifike juridike për vjeljen e debive.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi Drejtoria Teknike e “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër

**Titulli i Gjetjes:** Nga “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër pikat e lidhjes në objekte janë realizuar në kundërshtim me modelin e rregullores të miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, pasi kërkesat për pika lidhje nuk janë të shoqëruara me dokumentin e lejes së ndërtimit, aktin e pronësisë së objektit dhe projektin hidroteknik.

Nga ana e Drejtorisë Teknike nuk është përgatitur dokumentacioni teknik i pikës së lidhjes dhe realizimit të saj. Gjithëashtu nuk është e dokumentuar nëse për secilën pikë lidhje është vendosur ujëmatësi konform pikës 2.7 të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009.

Asnjë prej pikave të lidhjes të objekteve shumë katëshe të miratuara në vitin 2018 dhe 2019 nuk rezultojnë të jetë e pasqyruar në sistemin GIS, ndërkohë që në këtë sistem rezultojnë ende aktive pikat e lidhjes ujëmatësit dhe kontratat e objekteve që nuk ekzistojnë më pasi janë prishur dhe pikërisht në këto prona “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër ka miratuar pika lidhje për objekte të reja pa mbyllur paraprakisht pikat dhe kontratat me objektet që prishen nga zhvillimi i ri.

**Situata:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria Teknike dhe nga sektori i marrëdhënieve me klientin, rezultojnë se për periudhën objekt auditimi, janë bërë 137 aplikime për realizim të pikave të lidhjes në rrjetin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për objektet ekzistuese dhe objekte të reja si e janë hapur 4216 kontrata për furnizim me ujë dhe kanalizime për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

familjarë, biznese, institucione duke përfshirë këtu edhe riaktivizimin e kontratave për familjarë dhe biznese.

Nga auditimi rezulton se lidhjet në objekte, janë realizuar në kundërshtim me modelin e rregullores të miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a., pasi kërkesat për pika lidhje nuk është shoqëruar me dokumentin e lejes së ndërtimit apo aktin e pronësisë së objektit. Nga ana e Drejtorisë Teknike nuk është përgatitur dokumentacioni teknik i pikës së lidhjes dhe realizimit të saj. Gjithëashtu nuk është e dokumentuar nëse për secilën pikë lidhje është vendosur ujëmatësi konform pikës 2.7 të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009.

Nga auditimi me zgjedhje i kërkesave, miratimeve dhe realizimeve të pikave të lidhjes në objektet e reja shumë katëshe për periudhën objekt auditimi si edhe nga auditimi i të dhënave në sistemin GIS, rezulton se:

Pika e lidhjes për objektin 4, 5 dhe 6 kate me subjekt kërkues A. shpk, faturuar në datë 03.10.2017 është dhënë në kushtet e mungesës së dokumentit të lejes së ndërtimit dhe aktit të pronësisë. Projekti hidroteknik i paraqitur është për një objekt 4 kate dhe jo 6 kate siç paraqitet në kërkesë. Nga verifikimi i të dhënave në sistemin GIS rezulton se në sistem është hedhur pika e lidhjes për objektin, por nuk janë vendosur ujëmatësat dhe nuk ka asnjë kontratë të hapur ndonëse objekti ka 27 apartamente dhe pika e lidhjes i është miratuar 2 vjet më parë.

Për pikat e lidhjes të realizuara në vitin 2018 në objektet e reja shumëkatëshe me subjekte zhvilluese A.-A., E. 06, M.I., S.2010 m. shpk, P.P., A. shpk dhe A. shpk, rezulton se pikat e lidhjes janë miratuar dhe realizuar në mungesë të dokumentit të lejes së ndërtimit, aktit të pronësisë, planimetrisë së vendosjes së objektit si edhe projektit hidroteknik të sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë të realizuar nga persona ose subjekte të licencuara. Ndërsa pikat e lidhjes në objektet e reja shumëkatëshe me subjekte zhvilluese N. T., I. C. dhe C. C. shpk janë miratuar dhe realizuar në mungesë të projektit hidroteknik të sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë të realizuar nga persona ose subjekte të licencuara.

Pikat e lidhjes të realizuara në vitin 2019, për objekte të reja shumëkatëshe, përkatësisht objektet me zhvillues Residenza 5 E. R., Residenza 6 E. R. dhe G. C. rezulton se pikat e lidhjes janë miratuar dhe realizuar në mungesë të dokumentit të lejes së ndërtimit, aktit të pronësisë, planimetrisë së vendosjes së objektit si edhe projektit hidroteknik të sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë të realizuar nga persona ose subjekte të licencuara.

Nga auditimi i praktikave të pikave të lidhjes paraqitur nga Drejtoria Teknike dhe Sektori i Ujësjellësit si dhe rakordimit të tyre me të dhënat e faturimit dhe arkëtimit rezulton se për objektin e ri shumëkatësh me zhvillues A.Gj. është paguar e realizuar pika e lidhjes me objektin e ri, por mungojnë praktikat e këtyre lidhjeve me dokumentacionin përkatës, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj.).

Asnjë prej pikave të lidhjes të objekteve shumë katëshe të miratuara në vitin 2018 dhe 2019 nuk rezulton të jetë e pasqyruar në sistemin GIS, ndërkohë që ky system funksionon vetëm për qytetin e Shkodrës dhe nuk ka asnjë të dhënë të hedhur në të për njësitë administrative pjesë të Bashkisë Shkodër.

Në këtë sistem rezultojnë ende aktive pikat e lidhjes ujëmatësit dhe kontratat e objekteve që nuk ekzistojnë më pasi janë prishur dhe pikërisht në këto prona “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Shkodër ka miratuar pika lidhje për objekte të reja pa mbyllur paraprakisht pikat dhe kontratat me objektet që prishen nga zhvillimi i ri.

**Kriteri:** Sa më sipër është në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 *“Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a.*

**Ndikimi/Efekti:** Nga ana e Drejtorisë Teknike janë miratuar pika lidhje me sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për subjekte që nuk plotësojnë kushtet dhe dokumentacionin për ta konsideruar realizimin e pikës së lidhjes teknikisht dhe financiarisht të mundshme. Nuk është pregatitur dokumentacioni teknik i pikës së lidhjes dhe realizimit të saj, pra lidhja nuk është e dokumentuar si është bërë (lidhje e paligjshme, lidhje me miratim verbal etj.). Gjithëashtu nuk është e dokumentuar nëse për secilën pikë lidhje është vendosur ujëmatësi konform pikës 2.7 të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 si dhe nuk ka asnjë të dhënë që të lidhë hallkat e procesit nga miratimi dhe realizimi i pikave të lidhjes deri të vendosja e ujëmatësave dhe hapja e pagesa e kontratave për abonentët në objektet e reja shumëkatëshe.

**Shkaku:** Kjo është shkaktuar si pasojë e mos respektimit të përcaktimeve të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Drejtoria Teknike e “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër të marrë menjëherë dhe në vazhdimësi masa për miratimin e pikave të lidhjes me sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve vetëm për kërkesat që plotësojnë kushtet e lejes së ndërtimit, aktit të pronësisë, planimetrinë e vendosjes së objektit dhe projektin hidraulik të sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve realizuar nga persona e subjekte të licencuara. Të pregatisë dokumentacionin teknik të pikës së lidhjes dhe realizimit të saj, të dokumentojë vendosjen e ujëmatësit për secilën pikë lidhje si dhe të raportojë të dhënat në sektorin IT dhe GIS.

Sektorit IT dhe GIS i “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër të marrë masa në vazhdimësi për hedhjen në sistem GIS të pikave të lidhjes, ujëmatësave dhe kontratave në zonën e administrimit nga “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër duke përfshirë edhe njësitë administrative si edhe të marrë masa për të pasqyruar në system statusin e tyre aktiv ose jo aktiv.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara ngarkohet me përgjegjësi L.P., me detyrë Drejtor Teknik i “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër Sh.K., Përgjegjëse e Sektorit të Ujësjellësit në cilësinë e shqyrtuesit të kërkesave, hartuesit të dokumentacionit dhe realizuesit të pikave të lidhjes dhe A.T., Përgjegjës i IT dhe GIS për mos pasqyrim të të dhënave të pikave të lidhjes dhe kontratave në sistemin GIS.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 19 datë 01/11/2019 dhe për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr. 1487/1 Prot. datë 11/11/2019 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht nga Përgjegjësja e Sektorit Ujësjellës, Sh.K. sqarohet se nga pozicioni i punës si përgjegjëse e raportit të operim-mirëmbajtjes i gjithë rrjetit të furnizimit me ujë për gjithë zonën e shërbimit është ngarkesë e pamundur edhe mbajtja e komplet dokumentacioneve të pik-lidhjeve. Mendoj se pavarësisht se më është ngarkuar si detyrë nuk është aspak normale të kem edhe përgjegjësinë e mbajtjes së komplet dokumentacioneve të pikave të lidhjes. Bashkëngjitur po ju dërgoj dokumentat e pik-lidhjeve të I.C., P.P., S.2010 m. shpk, A. shpk, R. 5 E.R., R. 6 Europa R., A. Gj. dhe G.C.

**Titulli i gjetjes:** Këshilli i Administrimit të “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër ka përcaktuar tarifat për realizimin e pikave të lidhjes në rrjetin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve përmes





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

vendimit nr. 15, datë 30.09.2016. Në këtë vendim tarifat për pikat e lidhjes së banesave dhe pikat e lidhjes të godinave shumëkatëshe variojnë për secilën nga një kufi minimal në një maksimal.

**Situata:** Këshilli i Administrimit të “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër ka përcaktuar tarifën për realizimin e pikave të lidhjes në rrejtin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve përmes vendimit nr. 15, datë 30.09.2016. Në këtë vendim tarifat për pikat e lidhjes së banesave dhe pikat e lidhjes të godinave shumëkatëshe variojnë për secilën nga një kufi minimal në një maksimal

**Kriteri:** Pikat 3.5 dhe 2.5.1 të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjiellës kanalizime sh.a.

**Ndikimi/Efekti:** Risk për dekurajimin e kapaciteteve investuese të biznesit, por edhe rritjen e performancës së shoqërisë.

**Shkaku:** Mosvlerësim i duhur i akteve rregullatore.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi :** Këshilli i Administrimit të “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër të rivlerësojë Vendimin nr. 15, datë 30.09.2016, me synim jo vetëm inkurajimin e kapaciteteve investuese të biznesit, por edhe rritjen e performancës së shoqërisë.

*Koment i grupit të auditimit*

Në përgjigje të observacionit nr. 1655/1 prot, datë 13.12.2019 (protokoll Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime” sh.a Shkodër), protokolluar në KLSH me nr. 601/4 prot, date 16.12.2019, në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik dhe pikat e lidhjes sqarojmë se nuk kemi paraqitur prova dhe fakte të reja, të argumentuara ligjërisht dhe të shoqëruara me dokumentacion vërtetues, për pasojë nuk janë marrë në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Argumentet në mënyrë të detajuar, pse ky observacion nuk qëndron, janë pasqyruar në aktkonstatimin nr. 3 dhe 19 datë 01.11.2019 si dhe në proektraportin e auditimit.

#### **4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.**

**1.Titulli i Gjetjes:** Mungojnë parashikimet e detajuara në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

**Situata:** Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Shkodër, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Në disa raste mungon dokumentacioni që të provojë arsimin e kërkuar për pozicionin e punës nga kandidatët me të cilët janë shpallur fitues dhe është lidhur kontrata e punës. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehësuar kriteret e nevojshme



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

për punësim. Rregullorja e brendshme, në mënyrë joproporcionale dhe jo të lidhur me veprimet direkte/indirekte të punonjësve iu ngarkon atyre pasoja/përgjegjësi, në rastin e rekrutimeve/punësimeve të reja.

**Kriteri:** VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Statuti dhe Rregullorja e brendshme e UK Shkodër SHA.

**Ndikimi/Efekti:** Mos evidentim i procedurave të rekrutimeve, parregullsi në përzgjedhjen e punëmarrësve.

**Shkaku:** Mungesa e parashikimeve specifike lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Moszbatimi i parashikimeve të bëra në deklaratat për pozicionin e lirë të punës lidhur me kriteret për disa pozicione pune.

**Rëndësia:** e lartë.

#### **Rekomandime:**

1. Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.
2. Nga organet drejtuese të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundra ligjshme që mund të shkaktohen.
3. Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

**2. Titulli i Gjetjes:** Mospërputhje e parashikimeve të kontratave të personelit me parashikimet e Rregullores së brendshme lidhur me llojet e masave disiplinore.

**Situata:** Evidentohet mospërputhje e parashikimeve të gjithë kontratave të personelit të lidhura gjatë periudhës objekt auditimi me parashikimet e Rregullores së brendshme lidhur me llojet e masave disiplinore. Më konkretisht, Rregullorja e brendshme në nenin 14 të saj parashikon këto masa disiplinore: zbritje në pozicion pune, vërejtje, vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, pushim nga puna. Ndërkohë që kontratat e lidhura gjatë periudhës së auditimit parashikojnë këto masa disiplinore: qortim, vërejte me shkrim, paralajmërim për pushim nga puna, ulje e përkohshme e nivelit të pagës ose ndërprerje e përkohshme, ndërprerje e paralajmëruar ose e menjëhershme e marrëdhënieve të punës.

**Kriteri:** Nenin 14 i Rregullores së brendshme të UK Shkodër.

**Rëndësia:** e ulët.

#### **Rekomandim:**

Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet të merren masa që parashikimet e kontratave të personelit të bëhen në pajtim me parashikimet e rregullores së përgjithshme.

**5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, Bank dhe blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Auditimi u krye me zgjedhje. Konkretisht u audituan shpenzimet për muajin korrik 2017, dhjetor 2017, qershor 2018, dhjetor 2018, janar 2019, maj 2019, gushtë 2019.

**1. Titulli i gjetjes:** Përfitim padrejtësisht pagese nga Shoqëria “Annur Auditing” sh.p.k në vlerën 480,000 lekë.

**Situata:** Me urdhër transfertë datë 29.05.2019 është likuiduar Shoqëria “A. A.” sh.p.k në vlerën 480,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr.25, datë 26.04.2019 në vlerën 480,00 lekë.

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël Shoqërisë A.A.” sh.p.k me përfaqësuese ligjore N.K., është lidhur aktmarrëveshja e shërbimit me nr. 52/2 prot, datë 16.01.2019, me objekt: Auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri në përfundimin e shërbimit të ofruar me vlerë 800,000 lekë pa tvsh. Në këtë aktmarrëveshje është përcaktuar “.....Në përfundim të kontrollit, verifikimit dhe vlerësimit të të gjithë elementëve të përgjithshme të përmendur në këtë marrëveshje, por edhe të elementëve specifik të përmendur të cilët mundësojnë kryerjen e një auditimi sa më rigoroz, AL do të përpiloj raportin e auditimit të pavarur në të cilin do të shprehet opinion në se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar”.

Ky shërbim nuk provohet të jetë kryer, nga deklarimi verbal i stafit të UK, kjo kontratë është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga Shoqëria “A. A.” sh.p.k me përfaqësuese ligjore N. K. Për kryerjen e këtij shërbimi me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr.4 , datë 03.05.2019 protokolluar në Shoqërinë “UK” Shkodër Sh.A me nr.7426, datë 03.05.2019, është bërë emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar që të auditojnë pasqyrat financiare për vitin 2018, B.B. dhe T. N.

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël, B. B. dhe T. N. është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 749 prot., datë 19.06.2019, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat 266,7 orë që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me vlerë 800,000 lekë pa tvsh. Likuiduar me urdhër transfertën datë 04.07.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 384,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 15.06.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 96,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 58, datë 26.07.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet5 BKT në vlerën 480,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 26.07.2019.

Me vendim të kryetarit të Asamblesë së përgjithshme nr. 9, datë 30.07.2019, është bërë miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2018.

Vlera 480,000 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “UK Shkodër” Sh.a Shkodër dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “A. A.” sh.p.k.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar.

**Shkaku:** Keq interpretim i dispozitave ligjore.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 480,000 lekë nga Shoqëria “A.A.” sh.p.k. Kjo



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejtë nga mos zbatimi i aktmarrëveshjes së shërbimit me nr. 52/2 prot, datë 16.01.2019, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 .

**2. Titulli i gjetjes:** Përfitim padrejtësisht pagese nga A.D., me detyrë kryetar i Këshillit Administrativ.

**Situata:**Me urdhër transertën datë 27.12.2017, nëpërmjet bankës Credins, është likuiduar A. D., me detyrë kryetar i Këshillit Administrativ për vlerën 4250 lekë, me objekt kalim bonusi për vitin 2017. Ky bonos është dhënë me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 30, datë 22.12.2017, si dhe në zbatim të këtij vendimi, urdhri i brendshëm i administratorit nr. 316, datë 27.12.2017, ku është përcaktuar të akordohet për çdo punonjës 5000 lekë bonusi për vitin 2017. Shpërblimi(bonusi) është përfituar padrejtësisht, pasi kryetari i Këshillit Administrativ nuk është punonjës i UK Shkodër, dhe në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 5 “Interesat private”, pika 1/a, ku citohet: “*Interesat private të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre*” dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar.

**Kriteri:** Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 5 “Interesat private”, pika 1/a dhe Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar.

**Shkaku:** Keq interpretim i dispozitave ligjore.

**Rëndësia:** I mesëm.

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa që në të ardhëmen mos të ndodhin më përfitime të pa drejta financiare nga menaxhmenti i shoqërisë.

*Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:*

Dokumentacioni i bankës është i plotë dhe i sistemuar. Urdhër shpenzimet janë të shoqëruara me dokumentacionin vërtetues dhe justifikues (argumentues).

Dokumentacioni është i sistemuar në mënyrë kronologjike. Veprimet financiare janë kontabilizuar në ditarët e hyrjeve dhe daljeve të llogarisë bankare, sipas kërkesave të kontabilitetit. Çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të bankës dhe urdhërpagesat janë pasqyruar drejt nëpër llogaritë sintetike e analitike, sipas natyrës së shpenzimit, duke vepruar konformë me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, dhe me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, KREU III “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”/ “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, për veprimet e saj ka të hapura llogari bankare të ndryshme (në lekë dhe valuta të tjera), në 12 banka. Për veprimet në bankë operohet me dy firma, ajo e nëpunësit autorizues që është Administratori i Shoqërisë dhe ajo e nëpunësit zbatues. *Pavarësisht nga sa u citua më sipër, nga auditimi u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi në mbajtjen e kontabilitetit, që në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Me urdhër transfertë datë 29.05.2019 është likuiduar Shoqëria “A.A.” sh.p.k në vlerën 480,00 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 25, datë 26.04.2019 në vlerën 480,00 lekë.

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël Shoqërisë “A.A.” sh.p.k me përfaqësuese ligjore N.K., është lidhur aktmarrëveshja e shërbimit me nr. 52/2 prot, datë 16.01.2019, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri në përfundimin e shërbimit të ofruar me vlerë 800,000 lekë pa tvsh. Në këtë aktmarrëveshje është përcaktuar “.....Në përfundim të kontrollit, verifikimit dhe vlerësimit të të gjithë elementëve të përgjithshme të përmendur në këtë marrëveshje, por edhe të elementëve specifik të përmendur të cilët mundësojnë kryerjen e një auditimi sa më rigoroz, AL do të përpilojë raportin e auditimit të pavarur në të cilin do të shprehet opinion në se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar”.

Ky shërbim nuk provohet të jetë kryer, nga deklarimi verbal stafit të UK, kjo kontratë është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga Shoqëria “A.A.” sh.p.k me përfaqësuese ligjore N. K.

Për kryerjen e këtij shërbimi me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 4 , datë 03.05.2019 protokolluar në Shoqërinë “UK” Shkodër Sh.A me nr. 7426, datë 03.05.2019, është bërë emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar që të auditojnë pasqyrat financiare për vitin 2018, B.B. dhe T.N.

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël, B.B. dhe T. N. është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 749 prot., datë 19.06.2019, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat 266,7 orë që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me vlerë 800,000 lekë pa tvsh. Likuiduar me urdhër transfertën datë 04.07.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 384,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 15.06.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 96,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 58, datë 26.07.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 480,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 26.07.2019.

Me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 9, datë 30.07.2019, është bërë miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2018.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar.

Për sa trajtuar si mësipër vlera 480,00 lekë është përfituar padrejtësisht dhe përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “UK Shkodër” Sh.a dhe Buxhetin e Shtetit, dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “A. A.” sh.p.k.

Me urdhër transfertën datë 27.12.2017, nëpërmjet Bankës Credins, është likuiduar A. D., me detyrë kryetar i Këshillit Administrativ, për vlerën 4250 lekë, Me objekt kalim bonusi (shpërblimi) për vitin 2017. Ky bonus është dhënë me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 30, datë 22.12.2017, si dhe në zbatim të këtij vendimi, urdhri i brendshëm i administratorit nr. 316, datë 27.12.2017, ku është përcaktuar të akordohet për çdo punonjës 5000 lekë bonusi për vitin 2017. Shpërblimi (bonusi) është përfituar padrejtësisht, pasi kryetari i Këshillit Administrativ nuk është punonjës i UK Shkodër, dhe në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 5 “Interesat private”, pika 1/a, ku citohet: “Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre” dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar.

#### **Pagesat e kryera nëpërmjet arkës.**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nuk janë kryer veprime me arkën

#### **6. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.**

Me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 2, datë 08.02.2018, protokolluar në Shoqërinë “UK” Shkodër Sh.A me nr. 1972, datë 08.02.2018 është bërë emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar që të auditojnë pasqyrat financiare për vitin 2017, M. F. dhe N. K.

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël, M. F. dhe N. K. është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 1899 prot., datë 29.03.2018, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2017 me afat nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri në përfundimin e këtij shërbimi me vlerë 700,000 lekë pa tvsh. Likuiduar me urdhër transfertën datë 28.08.2018 nëpërmjet BKT në vlerën 420,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 12.06.2018 dhe urdhër transfertën datë 01.08.2018 nëpërmjet BKT në vlerën 420,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 40, datë 12.06.2018.

Me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 13, datë 12.06.2018, protokolluar në Shoqërinë “UK” Shkodër Sh.A me nr. 19, datë 12.06.2018 është bërë miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2017.

Me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 4, datë 27.06.2018, është bërë miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2017.

Me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 4, datë 03.05.2019 protokolluar në Shoqërinë “UK” Shkodër Sh.A me nr. 7426, datë 03.05.2019, është bërë emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar që të auditojnë pasqyrat financiare për vitin 2018, B. B. dhe T. N.

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël B. B. dhe T. N., është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 749 prot., datë 19.06.2019, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat 266,7 orë që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me vlerë 800,000 lekë pa tvsh. Likuiduar me urdhër transfertën datë 04.07.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 384,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 15.06.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 96,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 58, datë 26.07.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 480,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 26.07.2019.

Me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 9, datë 30.07.2019, është bërë miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2018.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 2, datë 09.03.2017, protokolluar në Shoqërinë “UK Shkodër” Sh.A me nr. 221, datë 09.03.2017, është bërë emërimi i ekspertës kontabël të autorizuar N. K. dhe M. F. për të ndjekur dhe për të hartuar raportin përkatës së shtimit të kapitalit të Shoqërisë “UK Shkodër” sh.a në zbatim të VKM nr. 63 date 27.01.2016



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Vendimet për shtesën e kapitalit:

1- Vendim nr. 6, datë 21.07.2017, protokolluar në Shoqërinë “UK Shkodër” Sh.A me nr. 833, datë 21.07.2017 për shtesën 369,475,480 lekë.

2- Vendim nr. 8, datë 18.12.2017, protokolluar në Shoqërinë “UK Shkodër” Sh.A me nr. 18849, datë 18.12.2017 për shtesën 22,993,000 lekë.

Auditimi ka pasur për qëllim vlerësimin teknik profesional mbi kredibilitetin e akteve financiare në mbyllje të vitit financiar të shoqërisë dhe nuk ka mundësuar dhënien e një vlerësimi profesional mbi zgjedhjet strategjike që ka ndërmarrë shoqëria.

Auditimi është fokusuar vetëm në aspektet që kanë të bëjnë me *auditimin financiar*. Duke kryer verifikimin e vërtetësisë dhe të koordinimit të të dhënave origjinale të shoqërisë nëpërmjet kontrollit të dokumenteve të mbajtura nga administratorët; krahasimin e besueshmërisë së të dhënave të kontabilitetit dhe analizimin kritik të tyre me aftësinë e tyre për të dhënë informacion, nëpërmjet rishikimit sistematik të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare; krahasimin e të dhënave të bilancit, shqyrtimin kritik të tij dhe krahasimin me parametra ligjor të caktuara.

Objekt i auditimit kanë qenë pasqyrat financiare të cilat përfshijnë bilancin kontabël, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, fluksit të parave dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare.

*Nga auditimi u konstatua se:*

Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare është bërë përgjithësisht në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe statutit të shoqërisë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se organizimi i kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, është bërë përgjithësisht sipas Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10.926, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr. 672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrisë të Financave Nr. 65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe”.

Ato janë përgatitur në përputhje me standardin kombëtar të kontabilitetit nr. 2, veprimet e kryera dokumentohen dhe regjistrohen në librat e kontabilitetit në përputhje me parimet e SKK-ve. Regjistrat janë të mbajtur në gjuhën shqipe dhe vlerat në njësinë monetare Shqiptare në lekë. Veprimet në valutë janë konvertuar në lekë sipas standardit kontabël përkatës.

Pasqyrat financiare (bilanci) janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, duke kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimi i të drejtave të konstatuara. Regjistrimet kontabël janë të pajisur me evidencë mbështetëse që sigurojnë besueshmërinë e tyre. U konstatua se regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e llogarisë kontabël, bëhet duke u bazuar në dokumentacionin përkatës kontabël.

*Pavarësisht nga sa u citua mësipër, nga auditimi u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi (parregullsi) në mbajtjen e kontabilitetit, që në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:*

-Nga ekspertët kontabël të kontraktuar:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

a. Nuk ka një zbatim të standartit 250 për auditim ligjshmërie dhe përputhshërie nga ekspertët kontabël, gjë që faktotet me problematikat e trajtuara në të gjitha procesverbalet e mbajtura.

b. Dokumentacioni përkatës që vërteton punën e kryer të ekspertëve, psh, krahasimi i programit me faktin e realizuar dhe kush e ka konfirmuar situacionin e punës së kryer prej tyre.

-Të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ç’fuqizuar me Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

**1. Titulli i gjetjes:** Parregullsi në pasqyrat financiare dhe analizave të tyre, në lidhje me grantet dhe rimarrjen e tyre në të ardhurat e periudhës.

**Situata:** Në pasqyrat financiare të shoqërisë, në pasiv në pozicionin e të ardhurave të shtyra, konkretisht në lidhje me grandet në bilancin e vitit 2018 në vlerën 4.323.216.953, në vitin 2017 në vlerën 4,542,971,684 lekë (ndryshimi i pakësuar në vlerën 219,754,731 lekë, nga të cilat granti nga projekti gjerman (-) 233,664,009 lekë dhe grande nga shteti (+) 13,909,275, ndërsa në bilancin e vitit 2017 në vlerën 4,542,971,684 lekë krahasim me vitin 2016 në vlerën 3,281,703,880 lekë ndryshimi *shtuar* (+) **1,261,267,804**, ndryshim i gjithë nga granti i projektit Gjerman.

Ndërkohë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në zërin të ardhura nga rimarrja e grantit, për vitin 2018 është pasqyruar në vlerën 233,264,009 lekë, dhe për vitin 2017 në vlerën 289,215,517 lekë.

Siç shihet granti nga projekti gjerman për vitin 2017, duke marrë parasysh pakësimin nga rimarrja si e ardhur është rritur me tepër  $(1,261,267,804 + 289,215,517) = 1,550,483,323$  lekë.

Theksojmë se ky projekt është zbatuar në vitet 2009-2015 dhe ka përfshirë 5 kontrata: Konkretisht: Blerje makineri dhe pajisje, Ndarja e sistemit të KUZ me KUB “Stacioni UZ Pazar, “Kolektor kryesor nga E.D. deri stacionin e KUZ Pazar”, Kontrata investime në ujësjellës “linjë ere stacion Dobrac deri tek puseta Dobrac”, “linjë e transmetimit Rus-Xhabie”, “Linja terciare”, Kontrata impianti i ri i Shirokës dhe Kontrata e vendosjes rreth 15 mijë matësve.

#### **Kriteri:**

Standartet e raportimit ,SKK nr 10, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10,926, datë 08,07,2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin., Urdhri i Ministrit të Financave nr. 65, datë 05,05,2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe”.

**Ndikimi/efekti** Mos qartësim i analizave të bilancit dhe pasqyrave që shoqërojnë bilancin, me pasojë ndikim në marrjen jo të drejtë të vendimeve për përmirësimin e situatës.

#### **Rëndësia: Mesëm**

#### **Rekomandimi:**

-Në pasqyrat financiare të viti 2019:

Të bëhet një analizë më e detajuar mbi grandet përsa i përket natyrës, shtesave që mund të kenë ndodhur gjatë periudhës dhe pakësimeve në formën e rimarrjes në të ardhurat.

-Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqitet informacioni më i detajuar në lidhje me grantet dhe ndihma të tjera: (a) natyrën dhe shumën e granteve të njohura në pasqyrat financiare; (b) kushtet e papërbushura dhe detyrimet e kushtëzuara të lidhura me



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

grantet që nuk kanë qenë të njohura në të ardhurat; (c) një përshkrim të formave të tjera të ndihmës qeveritare ose joqeveritare nga të cilat njësia ekonomike ka përfituar drejtpërdrejt duke lënë gjurmë edhe në shënimet shpjeguese.

-Në pasqyrën e fluksit të parasë në vitin 2017, të saktësohet shuma e rimarrjes të ardhurave nga grandet në efektin minus vlera 289,215,517, lekë, si dhe pasqyra e fluksit të parasë në pjesën në fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur) në aktivitetin e investimit-Grande, në efektin që japin ne cash flow dhe në vlerën përkatëse.

**2.Titulli i gjetjes:** Parregullsi në paraqitjen e vlerave të aktiveve afatgjata materiale dhe amortizimet e tyre.

**Situata:** Në pasqyrat financiare të vitit 2017 persa i përket AAGJ, nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar këto aktive persa i përket shtesave dhe pakësimeve, në vlerat e tyre, situata nga burime të ndryshme raportimesh si me poshtë:

Nga aktivi i bilancit, AAM në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 kanë rritje në vlerën 1,334,262,876 lekë, ndërsa AAJM një pakësim në vlerën 3,077,715 lekë, total me efekt të aktiveve afatgjata rritje në vlerën 1,331,185,161 lekë.

Në shënimet shpjeguese që shoqërojnë bilancin e vitit 2017, në pikën 8 të kësaj pasqyre vlera e AAGJ para amortizimit të vitit është në vlerën 6,695,516,889 lekë, pra nuk rakordon me vlerën mbetur e mbartur nga viti 2016, në shumën 3,170,699,719 lekë, plus ndryshimet sipas kësaj pasqyre shtesa aktive të blera gjatë vitit në vlerën 1,941,109,866 lekë.

Totali  $(3,170,699,719+1,941,109,866)=5,111,809,585$  lekë.

Pra ka një mos rakordim  $=1,583,707,304$  lekë.

Pasqyra e aktiveve afatgjata materiale me vlerat e çelura nga viti 2016, si dhe shtesat paketimet, si dhe amortizimet përkatëse mungon.

Në pasqyrat financiare vitit 2018, persa i përket AAGJ, nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar këto aktive, persa i përket shtesave dhe pakësimeve, në vlerat e tyre, situata nga burime të ndryshme raportimesh si më poshtë:

Nga aktivi i bilancit, AAM në vitin 2018 krahasuar me 2017, janë pakësuar në vlerën 154,718,693 lekë, ndërsa AAJM janë pakësuar në vlerën 80,283,710 lekë, total ndryshimi i aktiveve afatgjata pakësuar në vlerën 235,000,403 lekë.

Nga pasqyra e shënimeve shpjeguese që shoqërojnë bilancin e vitit 2018, në pikën 8 të kësaj pasqyre vlera e AAGJ 4,955,676,845 lekë, nuk rakordon me vlerën mbetur e mbartur nga viti 2017 në shumën 4,946,015,237 lekë, plus ndryshimet sipas kësaj pasqyre shtesa aktive blera gjatë vitit në vlerën 9,311,390 lekë. Totali  $(4,946,015.237+9,311,390)=4,955,326,627$  lekë.

Pra ka një mos rakordim në vlerën 350,218 lekë.

Pasqyra e aktiveve afatgjata me vlerat e AAGJ shtesa e AAGJ ne rritje është prej 9,661,606 lekë nga shtesat 34.825.69 lekë dhe pakësimet 25.164.088  $(34.825.69 -25,164,088=9.661.606$  lekë.

Referuar sa më sipër, ka një mos rakordim në shtesa të AAGJ midis dy burimeve te fundit persa i përket blerjes së AAGJ.

**Kriteri:** Standartet e raportimit, SKK nr 10, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10.926, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar”, të përkthyer në gjuhën shqipe.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**Ndikimi/efekti:** Mos pasqyrim saktë i vlerave të AAGJ në bilanc ndryshimeve të tyre dhe si rrjedhojë dhe amortizimet përkatës.

**Rëndësia: Mesëm**

**Rekomandimi:**

-Në pasqyrat financiare të viti 2019:

-Të plotësohet pasqyra e aktiveve afagjata materiale e rakorduar me çeljen nga viti i mbartur dhe pasqyrohen shtesa dhe pakësimet gjatë periudhës.

-Të saktësohet amortizimi përkatës i tyre, si në bilanc ashtu edhe në PASH.

- Në shënimet shpjeguese, të saktësohen burimet e tjera informative, pasqyra e fluksit parasë etj.

**3.Titulli i gjetjes:** Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SH.A Shkodër.

**Situata:** Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SH.A Shkodër. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Konkretisht gjendja debitore për vitin 2017 është në vlerën 1,066,367,794 lekë, ndërsa për vitin 2018 është në vlerën 1,143,319,951 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 92% për vitin 2017 dhe 95% për vitin 2018, e zënë klientët për shitje uji.

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2017, kjo gjendje paraqitet në vlerën 1,019,057,660 lekë dhe për vitin 2018, në vlerën 1,095,989,046 lekë.

Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 708,591,468 lekë për vitin 2017 dhe 789,255,534 lekë për vitin 2018.

Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve gjendja debitore zë 59 % të të ardhurave për vitin 2017 dhe 53% për vitin 2018, ndërsa gjendja kreditore zë 89% të shpenzimeve për vitin 2017 dhe 77% për vitin 2018.

**Kriteri:** Standartet e raportimit „SKK nr 10, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10.926, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Urdhri i Ministrit të Financave nr. 65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe.

**Ndikimi/efekti:** Ndikim në rezultatin e shoqërisë

**Rëndësia: I lartë**

**Rekomandimi:** Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrativ, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër më datë 31.12.2019, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre.

**4. Titulli i gjetjes:** Nuk është kryer inventari fizik i aseteve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik.

**Situata:** Nuk është kryer inventari fizik i aseteve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik.

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja e kanalizime të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar si shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur, si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre.

-Nuk janë krijuar provigjionet sipas SKK, si dhe nuk janë të pasqyruar të ardhura dhe shpenzime nga provigjionet.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hartuesit e pasqyrave financiare dhe në veçanti ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2017 Mimoza Fishta dhe Nurie Krymi dhe ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018, Bujar Bendo dhe Tom Ndoci.

**Kriteri:** Standartet e raportimit, SKK nr. 10, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me Ligjin nr. 10.926, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Urdhrit e Ministrisë të Financave nr. 65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të përkthyer në gjuhën shqipe.

**Ndikimi/efekti:** Keq menaxhim i aseteve.

**Rëndësia: I lartë**

**Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtorja Tregtare të merren masa për të kryer inventarin fizik të aseteve të shoqërisë, të evidentohen linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit, si dhe të kryhen procedurat përkatëse.

**5. Titulli i gjetjes:** Mos regjistrim i aseteve në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se në Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, çfuqizuar me Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

**Ndikimi/efekti:** Keq menaxhim të aseteve të Shoqërisë.

**Rëndësia: I mesëm**

**Shkaku:** Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

**Rekomandimi:**

Nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.A Shkodër të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, në zbatim të Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

**7.Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.**

Auditimi i procedurave të prokurimit është kryer me zgjedhje.

Për periudhën 01.07-31.12. 2017 janë zhvilluar 5 procedura prokurimi me vlerë 34,518 mijë lekë. Janë audituar 5 proceduar prokurimi me vlerë 30,238 mijë lekë ose 88 % e vlerës së tyre.

Për vitin 2018 janë zhvilluar 9 procedura prokurimi me vlerë 49,500 mijë lekë. Janë audituar 9 proceduar prokurimi me vlerë 49,500 mijë lekë ose 100 % e vlerës së tyre.

Për periudhën 01.01-31.08.2019 janë zhvilluar 8 procedura prokurimi në vlerën 92,056 mijë lekë, janë lidhur kontrata për 4 proceduar ne vlerën 76,279 mije lekë, ose 83 % e vlerës së tyre.

Nga auditimi u konstatuan shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore si më poshtë vijon:

**Titulli i gjetjes:** Procedura prokurimi të kryera me shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**Situata:** -Në 10 procedura prokurimi për vlerën 48,371 mijë lekë, përlogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argument përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

-Për 9 procedura prokurimi për vlerën 45,031 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 10 procedura prokurimi për vlerën 95,277 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 15 raste për vlerën 6,425 mijë lekë, anullimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

-Në 5 raste për vlerën 28,665,444 lekë është krijuar dëm ekonomik, nga zbatimi i kontratave të pajisjeve) mallrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”, Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10.

**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligji nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10.

**Ndikimi/efekti:** Dëm ekonomik i mundëshëm për shoqërinë në vlerën 28,665,444 lekë.

**Shkaku:** Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatore të procedurave të prokurimit publik, si dhe të zbatimit të kontratave të mallrave (pajisjeve).

**Rëndësia:** I lartë.

**Rekomandimi:** Për mbrojtur interesat publike, duke siguruar se fondet publike shpenzohen në mënyrën e duhur, të besueshme dhe me eficientë, me konkurrencë dhe transparencë në prokurimet



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

publike, si dhe për të siguruar, që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike të trajtohen në mënyrë të drejtë, nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë:

- Përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjeluar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik.

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të till që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kritereve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

-Nga Shoqëria t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

*Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:*

Auditimi i procedurave të prokurimit është kryer me zgjedhje.

Për periudhën 01.07-31.12. 2017 janë zhvilluar 5 procedura prokurimi me vlerë 34,518 mijë lekë. Janë audituar 5 proceduar prokurimi me vlerë 30,238 mijë lekë ose 88 % e vlerës së tyre.

Për vitin 2018 janë zhvilluar 9 procedura prokurimi me vlerë 49,500 mijë lekë. Janë audituar 9 proceduar prokurimi me vlerë 49,500 mijë lekë ose 100 % e vlerës së tyre.

Për periudhën 01.01-31.08.2019 janë zhvilluar 8 procedura prokurimi në vlerën 92,056 mijë lekë, janë lidhur kontrata për 4 proceduar ne vlerën 76,279 mije lekë, ose 83 % e vlerës së tyre.

Nga auditimi u konstatuan shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore si më poshtë vijon:

-Në 10 procedura prokurimi për vlerën 48,371 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj),



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

veprim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

-Për 9 procedura prokurimi për vlerën 45,031 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 10 procedura prokurimi për vlerën 95,277 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë,veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 15 raste për vlerën 6,425 mijë lekë, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

-Në 5 raste për vlerën 28,665,444 lekë është krijuar dëm ekonomik i mundshëm, nga zbatimi i kontratave të pajisjeve) mallrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”, Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.

Rezultat e auditimit për secilin procedurë të audituar paraqiten si më poshtë vijonë.

#### ***1.Blerje instalim elektropompa dhe panel elektrik ,viti 2017.***

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Blerje instalim elektropompa dhe panel elektrik”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.289 Datë 11.12.2017</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b>  “Kërkesë për Propozim”	Urdhër Nr.298 dt.11.12.2017  -F. T. me detyrë Shef i zyrës Juridike  -S. B. me detyrë Përgjegjëse Finance	Urdhër Nr. 299 dt. 11.12.2017  -ing. A. C. me detyrë Përgjegjës e Sektorit Mekanik  -Ing. E. P. me detyrë

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

	-D. S. me detyrë juriste	Përgjegjës i sektorit elektrik -ing. M. F. me detyrë Përgjegjës i sektorit teknik
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 3.697.000 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <u>3.420.000</u> lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 277.000 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> <b>22.12.2017</b>	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>5</u> OE b)S’kualifikuar <u>4</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
<b>11.Ankimime</b> AK-s’ka; - me shkresën nr. 3, date 03.01.2018 ka paraqitur ankese shoqëria ofertuese R.-M. K. , duke u ankuar për skualifikim të padrejte	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> -Me shkresën nr. 53/1, date 09.01.2018 UKSH ka kthyer përgjigje ankesës së shoqërisë ankimuese	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 853 prot. Datë 05.02.2018	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 4.104.000 lekë	

***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:***

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për Propozim”:

Me urdhër të administratorit Mark Molla në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr.298 prot., datë 11.12.2017, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 3,697,000 lekë, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me njësi të prokurimit të përbërë nga F. T., S. B., D. S.

Me urdhër të administratorit nr. 299 prot., datë 11.12.2017, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë A. C., M. F. dhe E. P.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Me procesverbal të datës 12.12.2017 grupi i përlllogaritjes së vlerës së kontratës, i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 92, datë 02.05.2017 i përbërë nga V. P., dhe B. B. ka përcaktuar vlerën 3,697,000 lekë.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 3,697,000 lekë, pas ofertës të ofruar nga operatorët ekonomik “S. F.”, “S.”, “I. E.”.

Vlera 3,697,000 lekë është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall, pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall (pajisje).

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.

Veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V. P. dhe B. B.

Si konkluzion,përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 11.12.2017 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F. T., S. B. dhe D. S.

Specifikimet teknike janë firmosur nga D. N., A. C., E. P. dhe M. F.

Në pikën 2.3 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë një ing. elektrik, i cili duhet të jetë pjesë e licencës profesionale të shoqërisë dhe në listë-pagesat përkatëse. Per ing. elektrik duhet te paraqitet edhe licenca e tij profesionale. Kriteri për ing. elektrik duhet të paraqitet edhe licenca e tij profesionale, është i pa nevojshëm pasi kjo kërkesë është e ezauruar (plotësuar), me kriterin e vendosur se ”Operatorët ekonomik ofertues duhet të jetë firme elektrike e pajisur me licencë profesionale me kategorinë NS-14, klasifikimi A”.

Por në fakt kategoria N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV “Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme”. Më e plotësuar për realizimin e këtij procesi duhet të ishte kategoria N.S.- 16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

“Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet”.

Nr	Përshkrimi	Specifikime teknike	Njësia	Sasia
1	F.V Elektro-Pompe uji centrifugale horizontale, shumëshkallëshe	Q=12-15 l/s, H=100 m, te montuara ne bazamentin e tyre grup	komplet	2
2	F.V Elektro- Pompe uji centrifugale horizontale, shumëshkallëshe	Q=12-15 l/s, H=120 m, te montuara ne bazamentin e tyre grup	komplet	1
3	F.V Panel	Për E/Pompe centrifugale horizontale me Q=12-15 l/s, H=100 m	komplet	2
4	F.V Panel	Per E/Pompe centrifugale horizontale me Q=12-15 l/s, H=120 m	komplet	1

#### **Panelet elektrike.**

*Panelet elektrike duhet te jene me specifikat si më poshtë:*

Kasete metalike IP 55, Tensioni 400 V, 50-60 Hz, Soft Starter dhe progamacioni, Ampermeter, Voltmeter, Lëshues linje, Lëshues By-pass, Celes man-0-aut, Pulsant Start/Stop, Ventilator për ventilim të detyruar, Rele Niveli, Mbrojtje nga punimi në të thatë, Kohëmatës për rikthim rryme, Rele kontroll faze, Numërues për orët e punës.

Specifikimet teknike janë hartuar nga Dila Ndoka me profesion inxh. mekanik, A. C. me profesion inxhinier mekanik, E. P. me profesion ing. elektrik, M. F. ing. hidroteknik. Nga hartuesit e specifikime teknike nuk është bërë argumentimi i vendosjes së specifikimeve teknike. Në specifikimet teknike të elektropompave nuk është përcaktuar:  $KW \geq$ ,  $KF \geq$ ,  $M \geq$ ,  $OTS \geq$ ,  $\cos \phi$ ,  $T \max \geq$ ,  $I_p \geq$ ,  $V \geq$ , Me helika inoksi, gize apo plastike, Aksi - inoksi, celik ,te dhena teknike te prurjes dhe lartësisë te jene ne qendër te kurbës përkatëse, Rendimenti te jete  $\geq$  \_\_\_ %, toleranca e lejimit te kalimit te mbetjeve te ngurta si rëre, etj ne milimetra.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Elektropompat të jenë të shoqëruara me fllanxha në linjën e dërgimit, të shoqërohen me katalloget përkatës, udhëzuesit e përdorimit dhe shërbimit, operatori ekonomik të japi asistencë teknike për montimin dhe vënien në punë të tyre, përpara se të bëhet kontrata do të rakordohet me degën teknike për diametrin e jashtëm të elektropompës që të jete > se diametri i puscpimit.

Për mos përcaktimin e saktë të specifikimeve teknike mbajnë përgjegjësi grupi që ka hartuar specifikimet teknike të përbërë nga D. N., A. C., E. P. dhe M. F.

Me procesverbal të datës 11.12.2017 njësia e prokurimit ka dokumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomik “S.”, “I. E.”, “S.-f.”, “A.” dhe “T. E.”.

Dorëzimi i ofertave në sistemin elektronik është bere me date 22.12.2017. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 28.12.2017, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

-Shoqëria “R.-M. K.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,890,000 lekë.

-Shoqëria “A.& N.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,950,000 lekë.

-Shoqëria “N.” sh.a me ofertë në vlerën 3,111,000 lekë.

-Shoqëria “V.” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,115,000 lekë.

-Shoqëria “I. E.” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,420,000 lekë.

Me shkresën nr. 3, datë 03.01.2018 ka paraqitur ankesë shoqëria ofertuese R.-M. K. , për s’kualifikim të padrejtë nga kjo procedure tenderi. Me urdhrin nr. 1, datë 03.01.2018 Administratori i UKSH M. M. ka pezulluar procedurën e prokurimit deri në shqyrtim të ankesës. Me urdhrin nr. 2, datë 03.01.2018 është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës, ku është ngarkuar me këtë detyrë D. N., A. T. dhe G. M. Komisioni me shkresën nr. 53, date 09.01.2018 ka rekomanduar Administratorit të UKSH refuzimin e ankesës së shoqërisë R.-M. K.. Me shkresën nr. 83/1, datë 09.01.2018 Administratori i UKSH M. M. ka kthyer përgjigje shoqërisë ankimese R.-M. K., duke refuzuar ankesën.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 525 prot., datë 29.01.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga A. C., E. P. dhe M. F.

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M. M., protokolluar me nr. 526 prot., datë 29.01.2019. Referuar këtij raporti, është kualifikuar operatori ekonomik “I. E.” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,420,000 lekë.

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomik:

-Shoqëria “R.-M. K.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,890,000 lekë.

-Shoqëria “A.& N.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,950,000 lekë.

-Shoqëria “N.” sh.a me ofertë në vlerën 3,111,000 lekë.

-Shoqëria “V.” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,115,000 lekë.

Me shkresën nr. 527 prot., datë 29.01.2017 të titullarit të autoritetit kontraktor M.M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 5 , datë 05.02.2018

Kontrata është nënshkruar me date 05.02.2018 nr. prot. 853 me objekt “Blerje instalim elektropompa dhe panel elektrik” me vlerën 4.104.000 leke me tvsh me afat 30 ditor, me date fillimi datën e nënshkrimit, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 6 , datë 12.02.2018.

Opinionin e grupit të auditimit është dhënë referuar vendimmarrjes së kvo, referuar kërkesave për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por theksojmë se *kriteri “Operatorët*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

*ekonomik ofertues duhet te kenë një ing. elektrik, i cili duhet te jete pjese e licencës profesionale te shoqërisë dhe ne listë-pagesat përkatëse. Për ing. elektrik duhet te paraqitet edhe licenca e tij profesionale. Kriteri për ing. elektrik duhet te paraqitet edhe licenca e tij profesionale*” është i ekzagjeruar dhe i pa argumentuar, në kundërshtim me VKM nr, 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi referuar VKM nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pajisja e shoqërisë “V.” shpk me licencën e dhënë nga Ministria e transportit dhe Infrastrukturës, për sa kërkohet në kërkesat për kualifikim, kjo është e ezauruar.

*-Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

Operatori ekonomik “I. E.” sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht Në pikën 2.3 “kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatoret ekonomik ofertues duhet te kenë një ing. elektrik, i cili duhet te jete pjese e licencës profesionale te shoqërisë dhe ne listë-pagesat përkatëse. Për ing. elektrik duhet te paraqitet edhe licenca e tij profesionale.

Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument (kontratë, licencë për ing. elektrik), për pasojë nuk duhet të ishte kualifikuar.

Për sa trajtuar mësipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “I. E.” sh.p.k nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga A.C., M.F. dhe E. P.

Skualifikimi i operatorëve ekonomik “R.-M. K.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,890,000 lekë, “A.& N.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,950,000 lekë, “N.” sh.a me ofertë në vlerën 3,111,000 lekë, “V.” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,115,000 lekë, nga KVO është kryer me të drejt.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmujmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij për noterinë, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë.

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 47, datë 06.02.2018, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës i përbërë nga A. C., E. P. dhe D. N.

Me amendim kontrate nr. 1489 prot, datë 19.02.2018 është bërë zgjatja e afatit të kontratës deri më 07.04.2018

Me urdhër transfertë datë 31.05.2018 nëpërmjet BKT është likuiduar shoqëria “I. E.” sh.p.k në vlerën 4,104,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 19, datë 05.04.2018 në vlerën 4,104,000



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

lekë, procesverbal i zbatimit të kontratës nr. 944/1 prot., datë 05.04.2018 i firmosur nga A. C., E.P. dhe D. N. Në këtë procesverbal citohet “Komisioni pasi pa mallin e sjellur dhe vendosur në stacionet e pompimit respektive, konstatoj: Elektropompat dhe panelet janë në përputhje dhe specifikimet e kërkuara nga ana e jonë. Pas vënies në punë rezulton se elektropompat punojnë qetë pa problem duke siguruar parametrat e kërkuar. Sa më sipër vlerësojmë se kontrata date 05.02.2018 nr. prot. 853 me objekt “Blerje instalim elektropompa dhe panel elektrik”, si dhe shtesa e kontratës me nr. 1489 prot, datë 19.02.2018 është zbatuar korrekt në përputhje me kërkesat tona teknike”.

***Elektropompat dhe panelet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “I. E.” sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar,*** veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.

Për pasojë grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinionin e tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “I. E.” sh.p.k , ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

***Deri në paraqitjen nga Shoqëria “I. E.” sh.p.k të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “I. E.” sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar, vlera 4.104.000 lekë për Shoqërinë “UK” Shkodër dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “I.E.” sh.p.k .***

#### **2.Blerje instalim elektropompa dhe panel elektrik ,viti 2019**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Blerje instalim elektropompa dhe panel elektrik”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.125 Datë 15.05.2019</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kërkesë për Propozim”	Urdhër Nr.125.15.05.2019 -F. T. me detyrë Shef i zyrës Juridike -S. B. me detyrë Përgjegjëse Finance -ing. E. P., përgjegjës i sektorit elektrik	Urdhër Nr. 126, date 15.05.2019 - ing. L. P. me detyrë Drejtor Teknik -ing. A. C. me detyrë Përgjegjës e Sektorit Mekanik -Ing. B. A. me detyrë Përgjegjës i sektorit të Mjedisit
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b>	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b>	<b>7.Diferenca me fondin limit</b>



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

3,257,933 lekë	<u>2,322,100</u> lekë	(pa tvsh) 935,833 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> <b>30.05.2019</b>	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>6</u> OE b)S’kualifikuar <u>4</u> OE, c) Kualifikuar <u>2</u> OE
<b>11.Ankimime</b> <b>AK-;</b> - me shkresen nr.742, date 18.06.2019 ka paraqitur ankese shoqeria ofertuese NOVAMAT , duke u ankuar për skualifikim të padrejte	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> -Me shkresen nr. 742/2, date 25.06.2019 UKSH ka kthyer përgjigje ankeses së shoqërisë ankimuese	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 931 prot. Datë 23.07.2019	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 2,786,520 lekë	

***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:***

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për Propozim”:

Me urdhër të administratorit M. M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr.125 prot., datë 15.05.2019, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 3,257,933 lekë, me procedurë “Kërkesë për Propozim”.

Me urdhër të administratorit nr. 126 prot., datë 15.05.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë A.C., L. P. dhe B.A.

Me procesverbal të datës 15.05.2019 grupi i përlllogaritjes së vlerës së kontratës, i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 38, datë 15.02.2019 i përbërë nga V. P., B.B. dhe S. U. është përcaktuar vlera 3,257,933 lekë.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 3,257,933 lekë, pas ofertës të ofruar nga operatori privat “S. F”, “E.”, “I.E.”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Vlera 3,257,933 lekë, është llogaritur si çmim mesatar për çdo pajisje pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall (pajisje).

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, *nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.*

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V. P., B.B. dhe S. U.

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 16.05.2019 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F.T., S.B. dhe E. P.

Specifikimet teknike janë firmosur nga A.C. dhe E. P.

1	<b>F.V Elektro-pompe zhytëse për ujra te zeza</b>	EMU FA10.44w Motor: HC20.1-4/30GEx (Q=54 m <sup>3</sup> /h H=29 m, P=20kë, n=1425 rrot/min) U=400V 3~ 50hz	komplet	1
2	<b>F.V Elektro-pompe zhytëse per ujra te zeza</b>	EMU FA 10.43w Motor T17-4/24KE (Q=43.9 m <sup>3</sup> /h H=18.6 m ,P=10 Kë, n= 1417 rrot/min) U=400V 3~ 50hz	komplet	1
3	<b>F.V Elektro-pompe zhytëse për ujra te zeza</b>	N D-100-220/0,44 ULG-220 (Q=129,6 m <sup>3</sup> /h H=6,39 m ,P=3,7 Kë, n= 1360 rrot/min) U=400V 3~ 50hz	komplet	1
4	<b>F.V Elektro-pompe zhytëse për ujë te pishem</b>	Pompe -SSP360-1L. Motor MATSF-200 (Q=320-160 m <sup>3</sup> /h H=(26-34 ) m , P=37 Kë, ) U=400V 3~ 50hz	komplet	1



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

5	<b>F. Elektro-pompe zhytëse për ujë te pishem</b>	Pompe –QF 160-5. Motor MTSF-150 (Q=120-110 m <sup>3</sup> /h H=(34-46) m , P=22 Kë, ) U=400V 3~ 50hz	komplet	1
---	---------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------	---

Në specifikimet teknike të elektropompave nuk është përcaktuar: Me helika inoksi, gize apo plastike, aksi - inoksi, çelik ,te dhëna teknike te prurjes dhe lartësisë te jene ne qendër te kurbës përkatëse, Rendimenti te jete  $\geq$  \_\_\_ %, toleranca e lejimit te kalimit te mbetjeve te ngurta si rërë, etj ne milimetra



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Elektropompat te jene te shoqëruara me fllanxha ne linjën e dërgimit, Te shoqërohen me katalogët përkatës, udhëzuesit e përdorimit dhe shërbimit, Operatori ekonomik te japi asistencë teknike për montimin dhe vënien ne pune te tyre, Përpara se te behet kontrata do te rakordohet me degën teknike për diametrin e jashtëm te elektropompës qe te jete > se diametri i pus çpimit.

Në pikën 2.3 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin, për sa i përket përvojës së mëparshme, furnizime te mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 40% të fondit limit të objektit te prokurimit, të realizuar gjate tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues.

Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018, pasi nuk duhesh “Kërkuar që kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit , **por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit**

Në pikën 2.1.2 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë një ing. elektrik, i cili duhet të jetë pjesë e licencës profesionale të shoqërisë dhe në listë-pagesat përkatëse. Për ing. elektrik duhet te paraqitet edhe licenca e tij profesionale. Kriteri për ing. elektrik duhet te paraqitet edhe licenca e tij profesionale, është i pa nevojshëm pasi kjo kërkesë është e ezauruar (plotësuar), me kriterin e vendosur se “Operatorët ekonomik ofertues duhet të jetë firmë elektrike të pajisur me licence profesionale me kategorinë NS-14, klasifikimi A.

Por në fakt kategoria N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV “Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme”. Më e plotësuar për realizimin e këtij procesi duhet të ishte kategoria N.S.- 16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij “Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet”.

Në opinionin e grupit të auditimit në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

Dorëzimi i ofertave ne sistemin elektronik është bere me date 30.05.2019. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 12.06.2019, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

-Shoqëria “A.9.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,830,000 lekë.

-Shoqëria “E. G.” sh.p.k nuk ka ofertë.

-Shoqëria “I. E.” sh.a me ofertë në vlerën 3,090,000 lekë.

-Shoqëria “N.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,626,262 lekë.

-Shoqëria “S.” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,250,000 lekë.

-Shoqëria “V.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,322,100 lekë.

Me shkresën nr. 742, datë 18.06.2019 ka paraqitur ankese shoqëria ofertuese N. , për skaulifikim te padrejte nga kjo procedure tenderi. Me urdhrin nr. 171, datë 19.06.2019 Administratori i UKSH M.M. ka pezulluar procedurën e prokurimit deri në shqyrtim te



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

ankesës. Me urdhrin nr. 172, datë 19.06.2019 është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës, ku është ngarkuar me këtë detyrë K. G., A. T. dhe G. M. dhe E. P. Komisioni me shkresën nr. 742/1, datë 24.06.2019 ka rekomanduar Administratorit të UKSH refuzimin e ankesës së shoqërisë N. Me shkresën nr. 742/2, datë 25.06.2019 Administratori i UKSH M. M. ka kthyer përgjigje shoqërisë ankimmuese N., duke refuzuar ankesën.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 881 prot., datë 10.07.2019 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga A. C., L. P. dhe B. A.

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M. M., protokolluar me nr. 882 prot., datë 10.07.2019. Referuar këtij raporti, janë kualifikuar operatorët ekonomik si më poshtë:

- Shoqëria “V.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,322,100 lekë.
- Shoqëria “N.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,626,262 lekë.
- Shoqëria “A. 9.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,830,000 lekë.
- Shoqëria “I. E.” sh.a me ofertë në vlerën 3,090,000 lekë.

Duke shpallur fitues operatorin ekonomik “V.” shpk.

Me shkresën nr. 883 prot., datë 10.07.2019 të titullarit të autoritetit kontraktor M. M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 29 , datë 22.07.2019

Kontrata është nënshkruar me date 23.07.2019 nr. prot. 931 me objekt “Blerje instalim elektropompa” me vlerën 2,786,520 lekë me t.v.sh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 30 , datë 29.07.2019.

*-Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

Operatori ekonomik “V.” sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, operatorët ekonomik ofertues duhet të kenë një ing. elektrik, i cili duhet të jetë pjese e licencës profesionale të shoqërisë dhe në listë-pagesat përkatëse. Për ing. elektrik duhet te paraqitet edhe licenca e tij profesionale.

Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument (kontratë, licencë për ing. elektrik).

Për sa trajtuar mësipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik V.”sh.p.k nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga A. C., L. P. dhe B. A..

Opinionin e grupit të auditimit është dhënë referuar vendimmarrjes së KVO, sipas kërkesave për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por theksojmë se *kriteri “Operatorët ekonomik ofertues duhet te kenë një ing. elektrik, i cili duhet te jete pjese e licencës profesionale te shoqërisë dhe ne listë-pagesat përkatëse. Për ing. elektrik duhet të paraqitet edhe licenca e tij profesionale.” është i ekzagjeruar dhe i pa argumentuar, në kundërshtim me VKM nr, 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, pasi referuar*





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

VKM nr. 42, date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pajisja e shoqërisë “Vasa” sh.p.k me licencën e dhënë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për sa kërkohet në kërkesat për kualifikim, kjo është e ezauruar.

Skualifikimi i operatorëve ekonomik “S.” dhe “E. G.” nga KVO është kryer me të drejt. Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatorë të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmujmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij për noterinë, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë.

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me an te efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 205, datë 23.07.2019, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës i përbërë nga E.P., D. N. dhe C. U.

Me urdhër transfertë datë 08.02.2019 nëpërmjet Raiffeisen Bank, është likuiduar shoqëria “V.” sh.p.k në vlerën 1,176,960 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 411, datë 16.08.2019 në vlerën 1,176,960 lekë, procesverbal marrje në dorëzim malli datë 19.08.2019 i firmosur nga E.P., D. N. dhe C. U.. Në këtë procesverbal citohet “Komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të mallit me qëllim furnizim-vendosje, në prezencë edhe të përfaqësuesit të subjektit “V.”, pasi verifikoj mallin konstatoj se :

-Malli i sjellur sipas faturës nr.411, datë 16.08.2019 “Elektropompë zhytëse uji të pijshëm 37 kw”, është në përputhje me kërkesat tona.

-Instalimi i elektropompës zhytëse është bërë në mënyrë korrekte nga subjekti furnizues.

Elektropompa zhytëse është vënë në funksion dhe është brenda të gjithë parametrave teknik të gjendjes së punës.

Malli i sjellur sipas faturës nr. 411, datë 16.08.2019 “Elektropompë zhytëse uji të pijshëm 22 kw”, është në përputhje me kërkesat tona dhe brenda të gjithë parametrave teknik.

***Elektropompat dhe panelet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “V.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar,*** veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.

Për pasojë grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinionin e tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “V.” sh.p.k , ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

***Deri në paraqitjen nga Shoqëria “V.” sh.p.k të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “V.” sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar, vlera 2,786,520 lekë për***

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

*Shoqërinë “UK” Shkodër dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “V.” sh.p.k .*

Në dokumentacionin bankar është sistemuar dhe fatura nr. 403, datë 13.08.2019 për vlerën 1,609,560 lekë, për pompat zhytëse për ujërat e zeza, e cila nuk është likuiduar. Bashkëlidhur kësaj fature dhe: Procesverbal marrje në dorëzim malli datë 20.08.2019 i firmosur nga E. P., D. N. dhe C. U..

Në këtë procesverbal citohet “Komisioni i ngritur për marrjen në dorëzim të mallit me qëllim furnizim-vendosje, në prezencë edhe të përfaqësuesit të subjektit “V.”, pasi verifikoj mallin konstatoj se :

-Malli i sjellur sipas faturës nr. 403, datë 13.08.2019 “Elektropompë zhytëse uji të zeza 20 kw dhe 10kw”, është në përputhje me kërkesat tona dhe brenda të gjitha parametrave teknik. Për “Elektropompë zhytëse uji të zeza 20 kw, u bë instalimi në Dobrac në mënyrë korrekte. U kontrolli i elektropompës pa ngarkesë dhe rrezultoj, pa probleme, u vendos në ngarkesë të plotë dhe rrezultoj pa probleme.

**3.Blerje materiale elektrike, viti 2018**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Blerje materiale elektrike”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.233 Datë 18.10.2018</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b>  “Kerkese per Propozim”	Urdhër nr. 233 dt.18.10.2018  -F. T. me detyrë Shef i zyrës Juridike  -N. B. me detyrë ekonomiste  -A. M. me detyrë ekonomiste	Urdhër Nr. 234 dt. 18.10.2018  -ing. L. P. me detyrë Drejtor Teknik  -ing. E. P. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Elektrik  -A. T. me detyrë ekonomiste
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b>  3,178,710 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b>  _____3,095,858_____lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b>  82,852 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b>  <b>01.11.2018</b>	<b>9.Burimi Financimit</b>  Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b>  a)Pjesëmarrës në tender Numër <b>4</b> OE  b)S’kualifikuar <b>3</b> OE,  c) Kualifikuar <b>1</b> OE
<b>11.Ankimime</b>  AK-s’ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b>  - s’ka	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b>  -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

<b>14.Lidhja e kontratës</b>	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	
Nr. 46 prot.	3,715,029 lekë	
Datë 15.01.2019		

#### ***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesimi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:***

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për Propozim”:

Me urdhër të administratorit M. M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr.233 prot., datë 18.10.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 3,178,710 lekë, me procedurë “Kërkesë për Propozim”.

Me urdhër të administratorit nr. 234 prot. , datë 18.10.2018, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë L. P., E. P. dhe A. T..

Me procesverbal të datës 17.10.2018 grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës , i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 46, datë 06.02.2018 i përbërë nga V. P., B. B. dhe S. U. është përcaktuar vlera 3,178,710 lekë pa tvsh.

Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në bazë të testimit të tregut për çmim për njësi sipas ofertës të ofruar nga operatori privat “F. C.”, “L. P.”, “ITE Grup”.

Vlera është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall(pajisje).

Nga grupi i llogaritjes e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.***

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V. P., B. B. dhe S. U..

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 19.10.2018 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F. T., N. B. dhe A. M..



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Specifikimet teknike janë firmosur nga përgjegjësi sektorit elektrik ing. E. P..

Në pikën 2.3 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin, për sa i përket përvojës së mëparshme, furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 40% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues.

Veprim në kundërshtim me shkresën 3341/1 prot, datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), pasi nuk duhesh “Kërkuar që kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit , **por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.**

Dorëzimi i ofertave në sistemin elektronik është bërë më datë 01.11.2018. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 06.11.2018, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

-Shoqëria “A. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,095,858 lekë.

-Shoqëria “F. G. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,160,191 lekë.

-Shoqëria “I. G. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,130,000 lekë.

-Shoqëria “P. I. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,816,350 lekë.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 3005 prot., datë 22.11.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga L. P., E.P. dhe A. T..

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M. M., protokolluar me nr. 3006 prot., datë 20.11.2018. Referuar këtij raporti, është kualifikuar operatorët ekonomik “A.” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,095,858 lekë

Me shkresën nr. 3007 prot., datë 20.11.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor M. M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 47 , datë 36.11.2018.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga operatori fitues, u konstatua se është vërtetuar njësia me origjinalin nga noter D. J. Gj., me nr. Repertori 2320, datë 31.10.2018 dhe 2487, datë 23.11.2018, dokumentacion i cili nuk është përkthyer nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/j, si udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3.

Kontrata është nënshkruar më datë 15.01.2019 nr. prot. 46 me objekt “Blerje materiale elektrike” me vlerë 3,715,029 leke me tvsh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 3 , datë 21.01.2019

**-Zhvillimi i procedurës së tenderimit:**

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

Në pikën 2.3 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certificate ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë, e cila duhet të jetë në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit. Kjo çertifikatë duhet të plotësoj kërkesat e nenit 30 të VKM nr. 914 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në përmbushje të këtij kriteri nga operatori është paraqitur çertifikatë ISO 9001-2015 të lëshuar nga kompania Q. C. e përkthyer dhe e noterizuar nga noter D. N. Gj. me vulë lidhëse të njom pa vulë të thatë dokument absolutisht i pa vlefshëm për tu marrë në konsideratë, pasi është në



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre”*, dokumentacion i cili nuk është përkthyer nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/j si udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3.

Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë për pasojë nuk duhet të ishte kualifikuar.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikate ISO 50001:2011 për menaxhimin e energjisë, e cila duhet të jetë në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit. Kjo certifikatë duhet të plotësoj kërkesat e nenit 30 të VKM nr. 914 “Për rregullat e Prokurimit Publik”. Në përmbushje të këtij kriteri nga operatori është paraqitur certifikata nga Kompania E. I. me nr. Er-29 Energy, ISO 50001-2011, e përkthyer dhe e noterizuar nga noter D. N. Gj. me vulë lidhëse të njom, pa vulë të thatë dokument absolutisht i pa vlefshëm për tu marrë në konsideratë, pasi është në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre”*, dokumentacion i cili nuk është përkthyer nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/j, si dhe udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3.

Ky operator nuk e ka përmbushur këtë kërkesë për pasojë nuk duhet të ishte s’kualifikuar.

Për sa trajtuar mësipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik shoqëria “A.-C.”sh.p.k nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga L.p., A. T. dhe E.P..

S’kualifikimi i operatorëve ekonomik “F. G. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,160,191 lekë, “I. G. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,130,000 lekë, “P. I. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,816,350 lekë nga KVO është kryer me të drejt.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmujmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij për noterinë, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë.

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave, është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

parregullsive, por edhe ndikimi me an të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

**Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 15, datë 15.01.2019, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës i përbërë nga E. P., M. F. dhe L. B.

Me urdhër transfertë datë 04.02.2019 nëpërmjet Credins është likuiduar shoqëria “A.-C.” sh.p.k në vlerën 3,715,030 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 2, datë 30.01.2019 në vlerën 3,715,030 lekë, procesverbal i kolaudit dhe marrjes në dorëzim datë 30.01.2019 i firmosur nga E. P.,M. F. dhe L. B.. Në këtë procesverbal citohet “Nga verifikimet rezultojë se sasia e sjell është në përputhje me atë të deklaruar në faturë dhe me specifikimet teknike.

**4.Blerje pajisje dhe materiale kompjuterike viti 2017**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Blerje pajisje dhe materiale kompjuterike”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.245 Datë 23.10.2017</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kerkese per Propozim”	Urdhër Nr.245 dt.23.10.2017 -F. T. me detyrë Shef i zyrës Juridike -S. B. me detyrë Pë rgjegjë se Finance -D. S. me detyrë juriste	Urdhër Nr. 246 dt. 23.10.2017 -A. T. me detyrë Pë rgjegjë s IT -S. Sh. me detyrë specialiste IT -A. S. me detyrë ekonomiste
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 1.852.715 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> _____1.835.040_____lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 17,675 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 06.11.2017	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>5</u> OE b)S’kualifikuar <u>3</u> OE, c) Kualifikuar <u>2</u> OE
<b>11.Ankimime</b> AK-s’ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> - s’ka	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b>	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Nr. 1414 prot.	2.202.048 lekë	
Datë 04.12.2017		

#### ***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesimi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:***

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për Propozim”:

Me urdhër të administratorit M. M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr. 245 prot., datë 23.10.2017, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 1,852,715 lekë, me procedurë “Kërkesë për Propozim”.

Me urdhër të administratorit nr.246 prot. , datë 23.10.2017 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë A. T., S. Sh. dhe A. S..

Me procesverbal të datë s 17.10.2017 grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës , i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 92, datë 02.05.2017 i përbërë nga V. P., dhe B. B. është përcaktuar vlera 1,852,715 lekë pa tvsh.

Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në bazë të testimit të tregut për çmim për njësi, sipas ofertës të ofruar nga operatori privat “L. A.”, “P. S.”, “T.”.

Vlera është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall(pajisje).

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.***

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V. P. dhe B. B.

Si konkluzion,përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 26.10.2017 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F. T., S. B. dhe D. S..

Specifikimet teknike janë firmosur nga përgjegjësi i IT A. T.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Dorëzimi i ofertave në sistemin elektronik është bërë më datë 06.11.2017. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 10.11.2017, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

- Shoqëria “P. S.” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,835,040 lekë.
- Shoqëria “T. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,539,950 lekë.
- Shoqëria “T. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,842,715 lekë.
- Shoqëria “F. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,844,500 lekë.
- Shoqëria “F.M.” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,646,300 lekë.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 15 prot., datë 05.01.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga A. T., S. Sh. dhe A. S..

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M. M., protokolluar me nr. 1339 prot., datë 20.11.2017. Referuar kë të raportit, janë kualifikuar operatorët ekonomik “P. S.” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,835,040 lekë dhe “F.” me ofertë në vlerë në 1,844,500 lekë .

Me shkresën nr. 1340 prot., datë 20.11.2017 të titullarit të autoritetit kontraktor M. M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 47 , datë 30.11.2017.

Kontrata është nënshkruar me date 04.12.2017 nr. prot. 1414 me objekt “Blerje materiale dhe pajisje kompjuterike” me vlerën 2,202,048 leke me tvsh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 50 , datë 18.12.2017

*-Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

Operatori ekonomik “P. S.” sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, operatorët ekonomik duhet të sjellin deklaratë konformiteti nga CE për të gjitha mallrat objekt kontrate origjinale dhe të përkthyer dhe të noterizuar. Në përmbushje të kësaj kërkesë operatori ekonomik ka paraqitur certifikatat konformiteti nga kompania AQSCERT> ISO 22301-2012, ISO 5001-2011, EN-ISO 14001-2004, Bs PAS 99-2012, EN-ISO 9001-2008, përkthyer dhe noterizuar nga noter Xh.. P. O. me vulë lidhëse të njom, pa vulë të thatë dokument absolutisht i pa vlefshëm për tu marrë në konsideratë, pasi është në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre”, dokumentacion i cili nuk është përkthyer nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/j, si udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3.

Operatori ekonomik “P. S.” sh.p.k konstatohet se nga KVO, është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht Në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, operatorët ekonomik duhet te sjellin autorizim nga prodhuesi për shitje dhe



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

shpërndarje të mallrave objekt kontrate origjinal dhe të përkthyer dhe noterizuar. Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur, autorizim prodhuesi nga kompania I. S. date 03.11.2017, nga kompania H., nga Kompania A. më datë 30.1.2017, përkthyer dhe noterizuar nga noter Xh. P. O. me vulë lidhëse të njom, pa vulë të thatë dokument absolutisht i pa vlefshëm për tu marrë në konsideratë, pasi është në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Çdo njësi e vërtetuar që i jepet të tretit, lidhet me vulë të njomë me një njësi të dokumentit me nënshkrim të vërtetuar, nënshkruhet, vuloset me vulën e thatë pranë emrit të noterit dhe me vulën e njomë mbi pullat e taksës në vlerën përkatëse të tyre”, dokumentacion i cili nuk është përkthyer nga përkthyes i pa licensuar nga Ministria e Drejtësisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/j si udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3.

Për sa trajtuar mësipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “P. S.” sh.p.k nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga A. T., S. Sh. dhe A. S.

S’kualifikimi i operatoreve ekonomik “T.” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,539,950 lekë dhe “F. M.” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,646,300 lekë, janë kryer m të drejt nga KVO.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmujmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij për noterinë, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë.

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me an te efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 295, datë 04.12.2017, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës si përbër nga A. T., S. Sh. dhe B. B.

Me urdhër transfertë datë 01.02.2018 nëpërmjet është likuiduar shoqëria “P. S.” sh.p.k në vlerën 2,202,048 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr 314, datë 14.12.2017 ne vlerën 2,202,048 lekë, dhe procesverbali i marrjes ne dorëzim i datës 14.12.2017 i firmosur nga A. T., S. Sh. dhe B. B.

*Pajisjet elektrike nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “P. S.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe*

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.

Për pasojë grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinionin e tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruarra dhe për të cilat Shoqëria “P. S.” sh.p.k , ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

***Deri në paraqitjen nga Shoqëria “P. S.” sh.p.k të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruarra (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “P. S.” sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar, vlera 2,202,048 lekë për Shoqërinë “UK” Shkodër dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “P. S.” sh.p.k.***

**5. Blerje pajisje dhe materiale kompjuterike, viti 2019.**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Blerje materiale kompjuterike”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.144 Datë 27.05.2019</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kerkese per Propozim”	Urdhër Nr.144, date 27.05.2019  -F. T. me detyrë Shef i zyrës Juridike  -A. M. me detyrë ekonomiste  -A. T. me detyrë Përgjegjës sektorit IT	Urdhër Nr.145,date 27.05.2019  -ing. Gj. K. me detyrë Drejtor i Mardhënieve me Konsumatorin  -S. Sh. me detyrë specialiste IT  -B. B. me detyrë specialiste e sektorit te planifikimit
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 2,995,305 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <u>2,656,350</u> lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 338,955 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 04.12.2018	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>1</u> OE b)S’kualifikuar <u>0</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
<b>11.Ankimime</b> AK-s’ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> - s’ka	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b>  -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b>	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b>	





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Nr.983 prot.	3,187,620lekë	
Datë 29.07.2019		

#### ***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesimi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:***

**Prokurim elektronik me** procedurë “Kërkesë për Propozim”:

Me urdhër të administratorit M.M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr. 144 prot., datë 27.05.2019, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 2,995,305 lekë, me procedurë “Kërkesë për Propozim”.

Me urdhër të administratorit nr.145 prot. , datë 27.05.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë Gj.K., B.B. dhe S.Sh.

Me procesverbal të datës 27.05.2019 grupi i përlllogaritjes së vlerës së kontratës , i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 38, datë 15.02.2019 i përbërë nga V.P., B.B. dhe S.U. është përcaktuar vlera 2,995,305 lekë pa tvsh.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në bazë të testimit të tregut për çmim për njësi sipas ofertës të ofruar nga operatori privat “L.A.”, “B.O.”, “t.”

Vlera është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall(pajisje).

Nga grupi për lllogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.***

Veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nëni 59, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V.P., B.B. dhe S.U.

Si konkluzion,përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nëni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 29.05.2019 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F.T., A.M. dhe A.T.

Specifikimet teknike janë firmosur nga A.T.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Në pikën 2.3 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatorët duhet të paraqesin, për sa i përket përvojës së mëparshme, furnizime të mëparshme të ngjashme një vlerë prej 40% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues.

Veprim në kundërshtim me shkresën nr. 3341/1 prot, datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), pasi nuk duhesh “Kërkuar që kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit , *por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit*

Dorëzimi i ofertave në sistemin elektronik është bërë më datë 12.06.2019. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 17.06.2019, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

-Shoqëria “P.S ” sh.p.k me ofertë në vlerën 2.656.350 lekë.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 811 prot., datë 01.07.2019 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga Gj.K., B.B dhe S.Sh.

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M.M., protokolluar me nr. 812 prot., datë 01.07.2019. Referuar këtij raporti, është kualifikuar operatorët ekonomik “P.S.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,656,350 lekë.

Me shkresën nr. 813 prot., datë 01.07.2019 të titullarit të autoritetit kontraktor M.M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 27 , datë 08.07.2019

Kontrata është nënshkruar me date 29.07.2019 nr. prot.983 me objekt “Blerje materiale kompjuterike” me vlerën 3,187,620 leke me tvsh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 31 , datë 05.08.2019

-*Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

Operatori ekonomik “P.S.” sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se

2.3.2 .Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqese: Autorizim prodhuesi ose autorizim distributori për pajisjet Kompjuter, Fotokopje, Projektor, Central Telefonik, Latop, Switch, Inverter. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet e provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit.

2.3.3 Operatorët ekonomik duhet të sjellin deklarate konformiteti nga CE për të gjitha mallrat objekt kontrate origjinale dhe të përkthyer dhe të noterizuar.

**2.3.4** Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente që i referohet objektit të prokurimit (Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.)

Në përmbushje të këtyre kërkesave operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e sipër kërkuar me vërtetim përkthimi nr. 1594 Rep, datë 05.06.2019, 1684 Rep, datë 11.06.2019, të përkthyer nga vet notere Xh.O., përkthyes i pa licencuar nga Ministria e Drejtësisë, pra nuk është dokumentacion i besueshëm për tu marr në konsideratë, veprim në kundërshtim me



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/j, si udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3.

Për sa trajtuar më sipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik shoqëria “P.S.” sh.p.k nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga Gj.K., S.Sh dhe B.B.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmujmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij për noterinë, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë.

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me an te efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 211, datë 29.07.2019, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës i përbërë nga A.T., Gj.K. dhe S.Sh.

Operatori fitues “P.S.” sh.p.k ka paraqitur për likuidim faturën nr 197, datë 09.08.2019 në vlerën 3,187,620 lekë, procesverbali i marrjes në dorëzim datë 09.08.2019 të firmosur nga A.T., Gj.K. dhe S.Sh. Në këtë procesverbal është cituar se “mallrat e marra në dorëzim janë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të dhëna në tenderim, ofertën e operatorit ekonomik, kushtet e kontratës, si të tilla merren në dorëzim pa vërejtje, duke u konsideruar kontratë e përfunduar me sukses.

*Pajisjet kompjuterike nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruarra (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “P.S.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.*

Për pasojë grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinionin e tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruarra dhe për të cilat Shoqëria “A.-C.” sh.p.k , ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

*Deri në paraqitjen nga Shoqëria “P.S.” sh.p.k të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruarra (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “P.S.” sh.p.k ka fituar tenderin, në opinionin e grupit të auditimit nuk duhet të likujdohet vlera 3,187,620 lekë për llogari të Shoqërisë “P.S.” sh.p.k .*

#### **6.Blerje vegla pune dhe aksesori ,viti 2018**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Blerje vegla pune dhe aksesor”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.253 Datë 19.11.2018</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kerkese per Propozim”	Urdhër Nr.253, date 19.11.2018 -F.T. me detyrë Shef i zyrës Juridike -N.B. me detyrë ekonomiste -ing. M.F. me detyrë Përgjegjëse e sektorit teknik	Urdhër Nr.254,date 19.11.2018 -ing. L.P. me detyrë Drejtor Teknik -Ing. E.P. me detyrë Përgjegjës i sektorit elektrik -B.B. me detyrë specialiste e sektorit te planifikimit
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 3,089,671 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <u>2,312,550</u> lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 777,121 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> <b>04.12.2018</b>	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>5</u> OE b)S’kualifikuar <u>2</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
<b>11.Ankimime</b> AK-s’ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> - s’ka	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 19 prot. Datë 08.01.2019	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 2,775,060 lekë	

*Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:*

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për Propozim”:

Me urdhër të administratorit M.M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr. 253 prot., datë 19.11.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 3,089,671 lekë, me procedurë “Kërkesë për Propozim”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Me urdhër të administratorit nr. 254 prot. , datë 19.11.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë L.P., E.P. dhe B.B.

Me procesverbal të datës 16.11.2018 grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës , i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 46, datë 06.02.2018 i përbërë nga V.P., B.B. dhe S.U. është përcaktuar vlera 3,089,671 lekë pa tvsh.

Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në bazë të testimit të tregut për çmim për njësi sipas ofertës të ofruar nga operatori privat “B.”, “J.S.”, “M.K.”.

Vlera është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall(pajisje).

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, *nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.*

Veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V.P., B.B. dhe S.U.

Si konkluzion,përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 21.11.2018 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F.T., N.B. dhe M.F.

Specifikimet teknike janë firmosur nga M.M., M.F., A.C., L.D., B.A.

Në pikën 2.3 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatorët duhet të paraqesin, për sa i përket përvojës së mëparshme, furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 40% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit te operatorit, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues.

Veprim në kundërshtim me Shkresën nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), pasi nuk duhesh “Kërkuar që kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit , *por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit*

Dorëzimi i ofertave në sistemin elektronik është bërë më datë 04.12.2018. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 07.12.2018, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

- Shoqëria “D.B.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,641,000 lekë.
- Shoqëria “E.A.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,864,450 lekë.
- Shoqëria “L.” sh.p.k me ofertë në vlerën 1,395,500 lekë.
- Shoqëria “M.D.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,696,750 lekë.
- Shoqëria “T.T.C.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,312,550 lekë.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 3087 prot., datë 18.12.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga L.P., E.P. dhe B.B.

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M.M., protokolluar me nr. 3088 prot., datë 18.12.2018. Referuar këtij raporti, është kualifikuar operatorët ekonomik “T.T.C.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,312,550 lekë dhe operatori ekonomik “M.D” me oferte në vlerën 2,696,750 lekë.

Me shkresën nr. 3089 prot., datë 18.12.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor M.M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 51 , datë 24.12.2018

Kontrata është nënshkruar me datë 08.01.2019, nr. 19 prot., me objekt “Blerje vegla pune dhe aksesori” me vlerën 2,775,060 leke me tvsh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 2 , datë 14.01.2019

*-Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Në zhillimin e procedurës së prokurimit nuk u konstatuan shkelje ose parregullsi.

Dokumentacioni i sipërcituar, është vërtetuar nga noter A.S., me nr. Repertori 4031, datë 24.12.2018, dokumentacioni i cili nuk është përkthyer nga përkthyes i licensuar nga Ministria e Drejtësisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar nën 62, pika 1/j si udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3.

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 16 datë 18.01.2019, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës së përbërë nga A.C., F.Sh. dhe A.M.

Me urdhër transfertë datë 07.02.2019 nëpërmjet BKT është likuiduar shoqëria “T.T.C.” sh.p.k në vlerën 2,679,060 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 102, datë 11.01.2019 në vlerën 2,679,060 lekë, procesverbal i marrjes në dorëzim 21.01.2019 i firmosur nga A.C., F.Sh. dhe A.M. Në këtë procesverbal citohet “mallrat e sjell sipas faturës tatimore nr. 102, datë 11.01.2019 në vlerën 2,679,060 lekë, janë në përputhje me kërkesat tona teknike dhe kushtet e kontratës. Nuk janë sjell mallrat: Meger -1000A elektronik copë 1x 42,000 lekë =42,000 lekë . Meger - elektronik 2500A copë 1x 54,000 lekë =54,000 lekë .

Me arsyetimin se Meger -1000A elektronik dhe Meger - elektronik 2500A mallrat me specifikime të tilla nuk ekzistojnë në treg, për këtë komisioni ju drejtua sektorit elektrik. Sektori elektrik ka të njëjtin mendim, që Meger -1000A elektronik dhe Meger - elektronik 2500A , nuk ekzistojnë në treg me këto specifikime. Në këto kushte palët kontraktuese në marrëveshje ndërmjet tyre bien dakort që kontratat të quhet e përmbushur në vlerën totale 2,679,060 lekë . Për sektorin elektrik procesverbali është firmosur nga ing. E.P. dhe L.B. me profesion teknik.

#### ***7.Blerje materiale hidraulike”, viti 2018***

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR****a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“Blerje materiale hidraulike”**

<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.75 Datë 09.03.2018</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b>  “E Hapur”	Urdhër nr.75 Datë 09.03.2018  -F.T. me detyrë Shef i zyrës Juridike  -N.B. me detyrë ekonomiste  -ing. M.F., përgjegjës i sektorit teknik	Urdhër Nr. 76, date 09.03.2018  - ing. Sh.K. me detyrë Përgjegjëse e ujësjellësit  -A.M. me detyrë ekonomiste  -B.B. me detyrë ekonomiste
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b>  13,989,018 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b>  _____13,735.000_____lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b>  254,018 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b>  <b>16.04.2018</b>	<b>9.Burimi Financimit</b>  Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b>  a)Pjesëmarrës në tender Numër _5_ OE  b)S’kualifikuar _4_ OE,  c) Kualifikuar__1__ OE
<b>11.Ankimime</b>  <b>AK-;</b>  - me shkresen nr.2079, date 10.05.2018 ka paraqitur ankese shoqeria ofertuese M.P. 2L , duke u ankuar për skualifikim të padrejte.  - me shkresen nr.2082, date 10.05.2018 ka paraqitur ankese shoqeria ofertuese F.G. , duke u ankuar për skualifikim të padrejte.  -me shkresen nr.2485, date 01.08.2018 ka paraqitur ankese shoqeria ofertuese F.G. , duke u ankuar për kualifikim të padrejte te shoqerise M.P.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b>  -Me shkresen nr. 2079/2, date 15.05.2018 UKSH ka kthyer përgjigje ankeses së shoqërisë ankimuese M.P. 2L, duke pranuar ankesen.  -Me shkresen nr. 2082/2, date 15.05.2018 UKSH ka kthyer përgjigje ankeses së shoqërisë ankimuese F.G., duke pranuar ankesen.  - Komsioni Vlersimit te ofertave ka refuzuar kualifikimin e ketyre opeatoreve ekonomik  -Me shkresen nr. 2527, datë 08.08.2018 Administratori i UKSH M.M. ka kthyer përgjigje shoqerise ankimuese F.G., duke refuzuar ankesen.	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b>  - Shoqerite ofertuese F.G. dhe M.P. 2L kane paraqitur ankese prane KPP-se, e cila ke vendosur me vendimin nr. 476/2018, qe Komsioni i Vlersimit te Ofertave te bëj rivlesimin e ofertave ne sistem.  -Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 689/2018 ka vendosur pranimin e ankeses se shoqerise F.G., duke skualifikuar nga kjo procedure prokurimi shoqerine “M.P. 2L”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

2L.		
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 2994 prot. Datë 20.11.2018	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 16,482,000 lekë	

#### ***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prorit publik APP, u konstatua se:***

Prokurim elektronik me procedurë “E Hapur”:

Me urdhër të administratorit M.M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr.75, datë 09.03.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 13,989,018 lekë, me procedurë “E Hapur”.

Me urdhër të administratorit nr.76 , datë 09.03.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë Sh.K., A.M. dhe B.B.

Me procesverbal të datës 08.03.2018 grupi i përlllogaritjes së vlerës së kontratës , i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 46, datë 06.02.2018 i përbërë nga V.P. dhe B.B. është përcaktuar vlera 13,989,018 lekë.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 13,989,018 lekë, pas ofertës të ofruar nga operatorët privat “F.G.”, “A.”, “A. s. g.”, “M.P. 2 L” “A.M.U”

Vlera 13,989,018 lekë, është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall(pajisje).

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës,***nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.***

Veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V.P. dhe B.B.

Si konkluzion,përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 13.03.2018 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F.T., N.B. dhe M.F.

Specifikimet teknike janë firmosur nga Sh.K., B.A., Gj.K., L.D. dhe M.F.

Me shtojcën e datës 21.03.2018 është ndryshuar përcaktimi për kriterin kualifikues të xhiros mesatare të kërkuar sa vlera e fondit limit, duke e ndryshuar në 40% te vlerës së fondit limit zbatim të nenit 27 te VKM nr. 914, date 29.12.2014.

Dorëzimi i ofertave ne sistemin elektronik është bërë më datë 16.04.2018. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 03.05.2018, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

-Shoqëria “W. 2010” sh.p.k nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

-Shoqëria “V.” sh.p.k me ofertë në vlerën 11,469,095 lekë.

-Shoqëria “M.P. 2L” sh.a me ofertë në vlerën 11,995,595 lekë.

-Shoqëria “F.G.” sh.p.k me ofertë në vlerën 13,735,000 lekë.

-Shoqëria “A. s. g.” sh.p.k me ofertë në vlerën 13,910,000 lekë

Me shkresën nr.2079, date 10.05.2018 ka paraqitur ankese shoqëria ofertuese M.P. 2L, duke u ankuar për skualifikim të padrejte.

Me shkresën nr.2082, date 10.05.2018 ka paraqitur ankese shoqëria ofertuese F.G., duke u ankuar për skualifikim të padrejtë.

Me urdhrin nr. 111, datë 10.05.2018 Administratori i UKSH M.M. ka pezulluar procedurën e prokurimit deri në shqyrtim të ankesave të paraqitura. Me urdhrin nr. 112, datë 10.05.2018 është ngritur komisioni i shqyrtimit te ankesave te shoqërive “M.P. 2L” dhe “F.G.”, ku është ngarkuar me këtë detyrë G.M., S.B. dhe D.N.

Komisioni me shkresën nr. 2082/1, datë 15.05.2018 i ka rekomanduar Administratorit të UKSH pranimin e ankesës së shoqërisë F.G. Me shkresën nr. 2082/2, datë 15.05.2018 Administratori i UKSH M.M. ka kthyer përgjigje shoqërisë ankimuese F.G., duke pranuar ankesën.

Komisioni me shkresën nr. 2079/1, datë 15.05.2018 i ka rekomanduar Administratorit të UKSH pranimin e ankesës së shoqërisë M.P. 2L. Me shkresën nr. 2079/2, datë 15.05.2018 Administratori i UKSH M.M. ka kthyer përgjigje shoqërisë ankimuese M.P. 2L, duke pranuar ankesën.

Administratori i UKSH M.M. me urdhrin nr. 116, datë 15.05.2018, ka urdhëruar komisionin vlerësimit të ofertave të bëj rivlerësimin në sistem, duke kualifikuar shoqëritë M.P. 2L dhe F.G. Ky urdhër është refuzuar nga komisioni i vlerësimit të ofertave sipas proces-verbalit te datës 21.05.2018.

Shoqëritë ofertuese M.P. 2L dhe F.G. , objekt te shqyrtimit administrativ kanë paraqitur ankese pranë komisionit të prokurimit publik, duke kundërshtuar refuzimin e KVO-se për rivlerësimin e ofertave.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 476/2018 ka vendosur që te urdhëroj KVO-në të bëj rivlerësimin e ofertave sipas vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

KVO me anë të proces-verbalit te datës 25.07.2018 ka bërë rivlerësimin e ofertave sipas vendimit nr. 476/2018, duke kualifikuar shoqëritë:

-Shoqëria “M.P. 2L” sh.a me ofertë në vlerën 11,995,595 lekë.

-Shoqëria “F.G.” sh.p.k me ofertë në vlerën 13,735,000 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Pas riklasifikimit të ofertave, ka paraqitur anekse shoqëria F.G. me nr. 2485 prot., datë 01.08.2018, duke pretenduar se shoqëria M. P. 2L është kualifikuar padrejtësisht nga kjo procedurë prokurimi, pasi nuk plotëson një sërë kriteresh kualifikuese.

Për pezullimin e procedurave Administratori i UKSH M.M. ka nxjerre urdhrin e brendshëm nr. 173, datë 02.08.2018. Për shqyrtimin e ankesës, Administratori i UKSH M.M., ka nxjerre urdhrin e brendshëm nr. 174, datë 02.08.2018, ku ka ngarkuar me këtë detyrë L.P., G.M. dhe S.B.

Komisioni me shkresën nr. 2526, date 08.08.2018 ka rekomanduar Administratorit të UKSH refuzimin e ankesës së shoqërisë F.G. Me shkresën nr. 2527, datë 08.08.2018 Administratori i UKSH M.M., ka kthyer përgjigje shoqërisë ankimuese F.G., duke refuzuar ankesën.

Shoqëritë ankimuese F.G., ka paraqitur anekse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar refuzimin e ankesës së bërë nga Autoriteti Kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 689/2018 ka vendosur pranimin e ankesës së shoqërisë F.G., duke skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi shoqërinë “M.P. 2L”.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 2886 prot., datë 31.10.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga Sh.K., A.M. dhe B.B.

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M.M., protokolluar me nr. 2887 prot., datë 31.10.2018. Referuar këtij raporti, është kualifikuar operatori ekonomik “F.G.” sh.p.k me ofertë në vlerën 13,735,000 lekë.

Me shkresën nr. 2888 prot., datë 31.10.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor M.M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 44 , datë 05.11.2018

Kontrata është nënshkruar më datë 20.11.2018 nr. 2994 prot., me objekt “Blerje materiale hidraulike” me vlerë 16,482,000 leke me tvsh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 47 , datë 26.11.2019.

#### *-Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

Operatori ekonomik “F.G.” sh.p.k sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht Në pikën 2.3 “kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se:

Operatori Ekonomik duhet të jetë i certifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me certifikatë ISO 9001:2008(Ose ekuivalent), për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë dhe shëndetit me certifikatë OHSAS 18001:2007(Ose ekuivalent) dhe për sistemin e menaxhimit të ambientit me certifikatë ISO 14001:2004 (Ose ekuivalent)për importin e mallrave objekt prokurimi (Materiale hidraulike). Në rastin kur Operatori Ekonomik është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë certifikatë ISO 9001:2008 (Ose ekuivalent), certifikatë OHSAS 18001:2007(Ose ekuivalent) dhe certifikatën ISO 14001:2004 (Ose ekuivalent)si për prodhimin dhe tregtimin e mallrave objekt prokurimi (Materiale hidraulike). Dokumentacioni i sipërcituar, është vërtetuar nga noter A. B.S., me nr. Repertori 1091, datë 14.04.20189 (ISO 9001:2015, 18001:2007, 14001:2015 të lëshuara nga kompania QEC Certification), dokumentacion i cili nuk është përkthyer nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/j, si udhëzimi i Ministrisë së drejtësisë nr. 6291, datë





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3

Theksojmë se kjo procedure prokurimi i është nënshtruar procedurave ankimuese pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-se, dhe ky njoftim fituesi bazohet në vendimin nr. 689/2018 të Komisionit të Prokurimit Publik, vendim i cili ka kualifikuar vetëm operatorin ekonomik shoqëria “F.G.” sh.p.k .

Për sa trajtuar mësipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “F.G.”sh.p.k nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e prokurimit publik.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmojmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij për noterinë, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë.

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me an të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 258, datë 21.11.2018, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës i përbërë nga M.F., I.K. dhe A.T.

Me urdhër transfertë datë 31.12.2018 nëpërmjet credins është likuiduar shoqëria “F.G.” sh.p.k vlerën 2,185,500 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 12, datë 11.12.2018 ne vlerën 3,442,332 lekë, fatura nr. 13, datë 13.12.2018 ne vlerën 1,980,000 lekë, fatura nr. 14, datë 18.12.2018 ne vlerën 2,279,418 lekë, fatura nr. 21, datë 03.01.2019 ne vlerën 4,011,756 lekë. Me urdhër transfertë datë 16.01.2019 nëpërmjet Credins Bank është likuiduar shoqëria “F.G.” sh.p.k vlerën 2,486,250 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 11, datë 27.11.2018 ne vlerën 2,486,250 lekë,

Me urdhër transfertë datë .03.2019 nëpërmjet Credins Bank është likuiduar shoqëria “F.G.” sh.p.k vlerën 1,980,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 13, datë 13.12.2018 ne vlerën 1,980,000 lekë .

Me urdhër transfertë datë 07.02.2019 nëpërmjet Credins Bank është likuiduar shoqëria “F.G.” sh.p.k vlerën 3,442,332lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 12, datë 11.12.2018 ne vlerën 3,442,332 lekë.

Me urdhër transfertë datë .04.2019 nëpërmjet Credins Bank është likuiduar shoqëria “F.G.” sh.p.k vlerën 2,279,418 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 14, datë 18.12.2018 ne vlerën 2,279,418 lekë,

Me urdhër transfertë datë .06.2019 nëpërmjet Credins Bank është likuiduar shoqëria “F.G.” sh.p.k vlerën 4,011,756 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 21, datë 03.01.2019 ne vlerën 4,011,756 lekë.

Marrja në dorëzim është marr me procesverbal të datës 12,12,2018, 13,12,2018, 18,12,2018, 03.01.2019, të firmosur nga M.F., I.K. dhe A.T., ku citohet ‘Nga verifikimin rezultoj se sasia e sjell është në përputhje me atë të deklaruar në faturat dhe me specifikimet teknike.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

*Materialet hidraulike nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria shoqëria “F.G.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.*

Për pasojë grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinionin e tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “F.G.” sh.p.k , ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

*Deri në paraqitjen nga Shoqëria shoqëria “F.G.” sh.p.k k të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “F.G.”sh.p.k ka fituar tenderin dhe është likuiduar, vlera 16,385,256 lekë për Shoqërinë “UK” Shkodër dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria shoqëria “F. G.” sh.p. k.*

**8.Ndërtim stacion pompimi dhe rrjeti ujësjellësit Kullaj”,viti 2019**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Ndërtim stacion pompimi dhe rrjeti ujësjellësit Kullaj”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.82 Datë 29.03.2019</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E Hapur”	Urdhër Nr.82, date 29.03.2019 -F.T. me detyrë Shef i zyrës Juridike -G.M. me detyrë Drejtor Tregtar -ing. M.M. me detyrë Pë rgjegjë s sektori KUZ	Urdhër Nr.83,date 29.03.2019 -ing. L.P. me detyrë Drejtor i Teknik -ing. Sh.K., Pë rgjegjë se e sektorit te Ujë sjellë sit. -ing. B.A. me detyrë Pë rgjegjese e Mjedisit
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 49,996,429 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> _____39,176,125_____lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 10,820,304 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 20.05.2019	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>5</u> OE b)S’kualifikuar <u>3</u> OE, c) Kualifikuar <u>2</u> OE
<b>11.Ankimime</b>	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b>	<b>13.Përgjigje Ankesës nga</b>

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

AK-s'ka;	- s'ka	APP apo AKKP -s'ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr.873 prot. Datë 09.07.2019	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 47,011,350lekë	

***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesit në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:***

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për Propozim”:

Me urdhër të administratorit M.M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr. 82 prot., datë 29.03.2019, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 49,996,429 lekë, me procedurë “E Hapur”.

Me urdhër të administratorit nr. 83 prot. , datë 29.03.2019 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë nga L.P., Sh.K. dhe B.A.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 01.04.2019 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F.T., G.M. dhe M.M.

Projekti, preventivi, specifikimet teknike, relacioni teknik, grafiku i punimeve janë hartuar nga shoqëria e hartimit të projektit “C.G.”.

Dorëzimi i ofertave në sistemin elektronik është bërë më datë 20.05.2019. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 12.06.2019, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë.

Konkretisht:

-Bashkimi përkohshëm i operatoreve “A.K. & K. G.K. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 39,176,125 lekë.

-Shoqëria “D.C. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 33,551,449 lekë.

- Bashkimi përkohshëm i operatoreve “MF. I. g.” & “M.” & “A.A. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 41,471,308 lekë.

-Shoqëria “P. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 39,012,214 lekë.

- Bashkimi përkohshëm i operatoreve “S. V.” & “S. U. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 39,319,283 lekë.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 805 prot., datë 28.06.2019 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit të përbërë nga L. P., Sh. K. dhe B.A.

Vendimi për kualifikimin dhe shpalljen fitues të bashkimit të përkohshëm të operatorëve “Alb. K. & K. G.K. ” sh.p.k është bërë nga dy anëtarët e komisionit L.P. dhe B.A. dhe është refuzuar nga anëtarja tjetër Sh. K., refuzim i cili qëndron, por duhet të shtuar edhe fakti që ky bashkim i operatoreve duhej skualifikuar, pasi kontrata e bashkëpunimit me nr. 1555 Rep., 666 kol e lidhur ndërmjet operatorëve ekonomik “Alb. K. & K. G. Konstruksion ” nuk përfshinë zërat si më poshtë :



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

1	An	F.V pompe centrifugale sipërfaqësore h=60m, q=25 l/s	cope2	2	700000	1400000
2	An	F.V pompe zhytëse h=70m, q=15 l/s	cope2	2	500000	1000000
3	An	Panel komandimi	cope4	4	350000	1400000
4	3.An/58	F V transformator fuqie 630 KVA, 20/10/0.4KV	cope1	1	1350000	1350000
5	An	F.V Matës Uji (Sipas Specifikimeve komplet )	cope668	2500	1670000	

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M. M., protokolluar me nr. 809 prot., datë 01.07.2019. Referuar kë tij raporti, janë kualifikuar operatorët ekonomik si me poshtë:

-Bashkimi përkohshëm i operatoreve “Alb. K. & K. G. K. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 39,176,125 lekë.

- Bashkimi përkohshëm i operatoreve “S. V.” & “S. U. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 39,319,283 lekë.

Me shkresën nr. 810 prot., datë 01.07.2019 të titullarit të autoritetit kontraktor M.M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 27 , datë 08.07.2019.

Kontrata është nënshkruar më datë 09.07.2019 nr.873 prot., me objekt “Ndërtim stacioni dhe rrjeti i Ujë sjellë sit Kulaj” me vlerën 47,011,350 leke me tvsh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 28 , datë 15.07.2019

Për sa trajtuar mësipër kualifikimi, shpallja fitues e Bashkimi përkohshëm i operatoreve “Alb Konstruksion & Karl Gega Konstruksion ” nga dy antarë të KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi anëtarë t e komisionit të vlerësimit të ofertave Lazer Pemaj dhe Blerina Arrtunda.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmojmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij të ndërtimit, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë, pasi bashkimi i operatorëve të kualifikuar të “Smo VatakSI” & “Smo Union ” janë me ofertë me vlerë më të madhe se “Alb Konstruksion & Karl Gega Konstruksion”, konkretisht janë në vlerë n 39,319,283 lekë.

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 191, datë 09.07.2019, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës s i përbër nga Lazer Pemaj, Mysaret Myrtja dhe Elvis Preci.

Kjo kontratw wshtw nw proces zbatimi.

#### **9.Blerje materiale hidraulike, viti 2017**

a.Zhvillimi i Proedurës së Prokurimit me objekt :Blerje Materiale Hidraulike

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

<b>1.Urdhër Prokurimi Nr. 166 Datë 14.06.2017</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Proçedurës së Prokurimit</b>  “Proçedurë e hapur”	Urdhër nr. 166, date 14.06.2017  -F.T. me detyrë Shef i zyrës Juridike  -S. B. me detyrë Përgjegjëse Finance  -D. S. me detyrë juriste	Urdhër nr. 167, date 14.06.2017  - ing. Sh.K. me detyrë Përgjegjëse Ujësjetës  -ing. M.F. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Teknik  - G.M., me detyrë juriste
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b>  9.945.352 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b>  _____ 9.614.640 _____ lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b>  330.712 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b>  23.06.2017	<b>9.Burimi Financimit</b>  Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b>  a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>5</u> OE  b)S’kualifikuar <u>4</u> OE,  c) Kualifikuar <u>1</u> OE
<b>11.Ankimime</b>  AK-ka;  -Ankese nr. 732 prot, date 29.06.2017 paraqitur pranë UKSH nga shoqëria “A. S.G.” në lidhje me specifikimet teknike dhe kriteret kualifikuese.	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b>  Shkresa nr.732/2, date 30.06.2017	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b>  -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b>  Nr. <u>1266</u> Datë 06.11.2017	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b>  11.537.568 lekë	

*Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesimi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:*

Prokurim elektronik me proçedurë tenderi i hapur:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Me urdhër të administratorit M. M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr. 166, datë 14.06.2017, protokolluar me nr. 672 prot., datë 14.06.2017, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 9,945,352 lekë, me procedurë “Procedur e hapur”.

Me urdhër të administratorit nr. 167, datë 14.06.2017 protokolluar me nr. nr. 673 prot., datë 14.06.2017 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë Sh. K., M.F. dhe G.M.

Me procesverbal të datës 12.06.2017 grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës, i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 92, datë 02.05.2017 i përbërë nga V.P., B.B. dhe A.M. është përcaktuar vlera 9,945,352 lekë

Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 9,945,352 lekë, pas ofertës të ofruar nga operatori privat J. S., B.L. dhe M.K.

Vlera 9,945,352 lekë, është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall hidraulik pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall(pajisje).

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.***

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V.P., B.B. dhe A.M.

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 20.06.2017 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F.T., S.B. dhe D.S.

Specifikimet teknike janë firmosur nga përgjegjësjja e sektorit të ujësjellësit Sh.K.

Në specifikimet teknike “Kërkesat e Përgjithshme dhe Standartet Teknike Referuese” është përcaktuar se

Të gjitha materialet të jenë nga materiali i klasës së parë ISO 9001

Tubat e HDPE 100 per furnizimin me uje duhet te sigurojne rezistence perfekte ndaj korrozionit, rezistence te larte ndaj agjenteve kimike, peshe te lehte, mundesi te thjeshta riparimi e transporti, ngjitje te thjeshte dhe te shpejte, jetegjatesi mbi 30 vjet dhe rezistence ndaj ujit te ngrohte, temp.nen zero dhe luhatjeve te temperaturave te motit.

- Materiali Polietileni me densitet te larte (HDPE 100).



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

- Gjatësia e tubave duhet të jete 6-12 m për tubat me OD > 75 mm dhe 50 m për tubat me OD < 75 mm të shoqëruara me rakorderitë përkatëse bashkuese si dhe me tapat për mbylljen fundore .
- Spesori duhet të jetë në përputhje me kërkesat për presionin e punës së tubave ( minimum për PN 10 bar) dhe shkallën e Dimensionimit Standart (SDR = 11 për tuba PE 100 me PN 10 bar ).

Por në ftesën për ofertë nuk është kërkuar asnjë tub HDPE 100, dhe në asnjë rast 10 bar, por 16 bar.

Pra ka një mos rakordancë ndërmjet dokumentacionit të hedhur në sistem me specifikimet teknike të hartuar nga përgjegjësja e sektorit të ujësjellësit.

Për tubacionin PE 0/ 20 mm, 25 mm, 32 mm,40 mm,63 mm P 16 bar, nuk është përcaktuar se tubacionet ***duhet të jetë i sigurt për shëndetin njerëzve dhe i aprovuar nga Institucionet përkatëse ligjore si IIP,DVGW apo Institute të tjera ekuivalente të afta dhe të aprovuara për testimin e cilësisë së materialeve plastike.***

Për kriteret e veçanta për kualifikimit nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe të dokumentuar në procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

Me urdhër të administratorit nr. 176, datë 29.06.2017, protokolluar me nr.733 prot., datë 29.06.2017, është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, referuar ankesës së shoqërisë “Alpha Solutions Group” për hartimin e specifikimeve teknike, dhe është ngarkuar për verifikimin e kësaj anekese K.G., A.B. dhe B. B. me urdhër të administratorit nr. 177, datë 29.06.2017, protokolluar me nr. 734 prot., datë 29.06.2017.

Me shkresën nr. 732/1 prot, datë 30.06.2017 grupi i ngarkuar për verifikimin e ankesës i përbërë nga K.G., A.B. dhe B. B., i është drejtuar administratorit të shoqërisë duke bërë arsyetimin e modifikimit të specifikimeve teknike dhe konkretisht, pretendimi për certifikatën e prodhuesit ISO/OHSAS 18001:2007 dhe Iso 140001:2015 është i drejt, pretendimi për mostrat nuk është i drejt, pretendimi për saraçineskat 1 për 40 bar dhe 1/1/4 40 bar është i drejt.

Me shkresën nr. 732/2 prot., datë 30.06.2017 i firmosur nga administratori i shoqërisë i kthete përgjigje shoqërisë “A.S.G.”.

Me shkresën nr. 732/3 prot, datë 30.06.2017 nga administrator i shoqërisë është miratuar vendimi i komisionit për shqyrtimin e ankesës së operatorit “A.S.G.”.

Shtesa e dokumentet standart është bërë më datën 04.07.2017, e firmosur nga njësia e prokurimit e përbërë F.T., S.B. dhe D.S.

Me urdhër të administratorit nr. 208, datë 14.08.2017, protokolluar me nr. 919 prot, datë 14.08.2017, është bërë pezullimi i përkohshëm i procedurave të prokurimit për vitin 2017, mbështetur në zbatim të VKM nr. 482, datë 05.07.2017, si dhe shkresës së APP-së nr. 10557/1 prot., datë 27.07.2017.

Me urdhër të administratorit nr. 243, datë 17.10.2017, protokolluar me nr. 1181 prot., datë 17.10.2017, është bërë shfuqizimi i pezullimit të përkohshëm i procedurave të prokurimit për vitin 2017, mbështetur në zbatim të VKM nr. 482, datë 05.07.2017, si dhe shkresës së APP-së nr. 10557/1 prot., datë 27.07.2017.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit nr. 1185 prot., datë 20.10.2017, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

- Shoqëria “A.” sh.p.k me ofertë në vlerën 9,614,640 lekë.
- Shoqëria “J.” sh.a me ofertë në vlerën 9,847,500 lekë.
- Shoqëria “M.P.” sh.p.k me ofertë në vlerën 8,578,065 lekë.
- Shoqëria “F.G.” sh.p.k me ofertë në vlerën 9,736,628 lekë.
- Shoqëria “C.” sh.p.k me ofertë në vlerën 7,857,530 lekë.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 1231 prot., datë 30.10.2017 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga Sh.K., G. M. dhe M.F.

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M. M., protokolluar me nr. 1236 prot., datë 30.10.2017. Referuar këtij raporti, është kualifikuar operatori ekonomik “A.” sh.p.k me ofertë në vlerën 9,614,640 lekë. Janë skualifikuar operatorët ekonomik: “J.” sh.a me ofertë në vlerën 9,847,500 lekë, “C.” sh.p.k me ofertë në vlerën 7,857,530 lekë, “M. P.” sh.p.k me ofertë në vlerën 8,578,065 lekë, “F.G.” sh.p.k me ofertë në vlerën 9,736,628 lekë.

Me shkresën nr. 1237 prot., datë 30.10.2017 të titullarit të autoritetit kontraktor M.M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 44 , datë 06.11.2017.

Njoftimi i kontratës së nënshkruar të shkurtuar në formë elektronike për tenderin me objekt: Blerje Materiale Hidraulike është kryer datë 06.11.2017 për vlerën 11,537,568 lekë, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 45 , datë 13.11.2017

*- Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

- operatori ekonomik “A.” sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht Në pikën 2.3 “kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatorët ekonomik ofertues duhet të kene ne pronesi ose me qira 2 automjete per transportimin e mallrave tip kamion me tonazh jo me te vogel se 3 ton: *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë ne pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qirasë për të gjithë vlefshmërinë e kontratës. si dhe dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi) certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit.*

Nga ky operator në përmbushje të kësaj kërkesë është paraqitur;

- kontratë qiraje e ndërmjet operatori ekonomik “A.” sh.p.k dhe personit fizik jo tregtar G.B. nënshkruar datë 09.06.2016, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Qiradhënësi jep dhe qiramarrësi merr me qira automjetin mercedez benz , tip kamion me targ AA 597 HL, me afat dy vjeçar duke filluar nga data 09.06.2016 deri më 09.06.2018. Kjo kontratë qiraje nuk është nënshkruar dhe vulosur nga noteri, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/ll, si udhëzimin e Ministrisë së drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4.

Pra nga ky operator nuk është përmbushur kjo kërkesë për kualifikim e përcaktuar nga autoritetit kontraktor, për kualifikim, për këtë arsye duhej skualifikuar.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Operatori ekonomik “A.” sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht Në pikën 2.3 “kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatoret ekonomik ofertues duhet të jene ne pronesi ose me qira dyqan/magazine ku ushtron aktivitetin e tregimit të materiale hidraulike.

*Per ambjentin ne pronesi: Çertifikate pronesie, planimetri objekti.*

*Per ambjentin me qira : Kontrate qiraje qe mbulon afatin e kontrates, çertifikate pronesie dhe planimetri objekti te qiradhenesit, si dhe faturen tatimore ose mandat pagesen e qirase*

Nga ky operator në përmbushje të kësaj kërkesë është paraqitur kontratë qiraje e ndërmjet E.N. dhe operatori ekonomik “A.” sh.p.k nënshkruar datë 15.11.2016, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë palët e mësipërme deklaruan se kanë rënë dakort që nga pasuria e mësipërme sipërfaqe 200 m<sup>2</sup> ta marr me qira pala qiramarrëse dhe ta përdor për zhvillimin e aktivitetit të saj, të licencuar sipas ligjit: Certifikatë pronësie me nr. 838344, zona kadastrale, 3922, numri i pasurisë 113/65, volumni 10, faqe 136, lloji i pasurisë ar+truall, sipërfaqe totale 500 m<sup>2</sup>, truall 250, ndërtesë 64 m<sup>2</sup>. Pronari E. A..N F.Zh., lëshuar datë 28.03.2014, shoqëruar me hartën treguese lëshuar datë 23.04.2014.

Kjo kontratë qiraje nuk është nënshkruar dhe vulosur nga noteri, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/II, si udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4.

Si dhe ky operator nuk ka paraqitur *faturen tatimore ose mandat pagesen e qirase ndaj qiradhenësit,*

Pra nga ky operator nuk është përmbushur kjo kërkesë për kualifikim e përcaktuar nga autoritetit kontraktor, për kualifikim, për këtë arsye duhej skualifikuar.

Operatori ekonomik “A.” sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht Në pikën 2.3 “kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se:

-Operatoret ekonomik ofertues duhet të jene te paisur me çertifikaten ISO/OHSAS 18001:2007, per materiale hidraulike qe mbulon afatin e kesaj kontrate ( nese çertifikata eshte ne gjuhe te huaj duhet te jete e perkthyer dhe e noterizuar).

-Operatoret ekonomik ofertues duhet të jene te paisur me çertifikaten ISO 14001:2015, per materiale hidraulike qe mbulon afatin e kesaj kontrate (nese çertifikata eshte ne gjuhe te huaj duhet te jete e perkthyer dhe e noterizuar).

-Operatoret ekonomik ofertues duhet të jene te paisur me çertifikaten ISO 9001:2015, per materiale hidraulike qe mbulon afatin e kesaj kontrate (nese çertifikata eshte ne gjuhe te huaj duhet te jete e perkthyer dhe e noterizuar).

-Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikaten e prodhuesit ISO 9001:2015 dhe /ose ekuivalentet e tyre (çertifikata duhet të jete e perkthyer dhe e noterizuar).

-Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese Deklaraten (çertifikaten) e Konformitetit dhe ato të testimeve të këtyre mallrave ose ekuivalentet e tyre që tregojnë të dhëna mbi cilësinë dhe origjinën e tyre, të lëshuara nga autoritetet e akredituara për këtë qëllim (çertifikata duhet të jete e perkthyer dhe e noterizuar).

Nga ky operator në përmbushje të kësaj kërkesë është paraqitur:

Dokumentacioni i sipërcituar, është vërtetuar nga noter A.B.S., me nr. Repertori 3150, 3151,3152, datë 02.11.2017, dokumentacioni i cili nuk është përkthyer nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/j si udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 3.

Pra nga ky operator nuk është përmbushur kjo kërkesë për kualifikim e përcaktuar nga autoritetit kontraktor, për kualifikim, për këtë arsye duhej shkualifikuar. Kontrata është lidhur me nr. 1266 prot., datë 06.11.2017 ndërmjet Shoqërisë e UK Shkodër të përfaqësuar nga Mark Nikolla në cilësinë e administratorit dhe operatorit/e shoqërisë Shoqëria “A.C.” sh.p.k përfaqësuar nga E.Gj. në vlerën 11,537,568 lekë, kontrata duhet të fillojë zbatimin me 06.11.2017 me afat 06.05.2018.

Për sa trajtuar mësipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik “A.C.” sh.p.k nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë Sh.K., G. M. dhe M.F.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmujmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij për noterinë, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë.

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me an te efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 269, datë 15.11.2017, protokolluar me nr. 1311 prot, datë 15.11.2017, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës i përbërë nga Sh. K., N.K. dhe P.P.

Me urdhër transfertë datë 12.12.2018 nëpërmjet BKT është likuiduar shoqëria “A.C” sh.p.k vlerën 1,134,720 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 73, datë 17.11.2017 ne vlerën 319,800 lekë, fatura nr. 74, datë 21.11.2017 ne vlerën 814,920 lekë. Me urdhër transfertë datë 02.02.2018 nëpërmjet Credins Bank është likuiduar shoqëria “A.C.” sh.p.k vlerën 8,671,368 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 82, datë 14.12.2017 ne vlerën 5,990,748 lekë, procesverbal i marrjes në dorëzim nr.3, datë 14.12.2017 i firmosur nga Sh.K., N.K. dhe P.P. Në këtë procesverbal citohet “Pas kontrollit të mallrave të dorëzuara nga kontraktuesi, rezulton se mallrat janë në përputhje të plot me të gjitha kushtet dhe specifikimet e kontratës dhe pjesëve integrale të saj. Mallrat merren në dorëzim pa vërejtje sipas faturës nr. 30741734/82”, fatura nr. 83, datë 18.12.2017 ne vlerën 2,680,6201 lekë, procesverbal i marrjes në dorëzim nr.4, datë 18.12.2017 i firmosur nga Sh.K., N.K. dhe P.P. Në këtë procesverbal citohet “Pas kontrollit të mallrave të dorëzuara nga kontraktuesi, rezulton se mallrat janë në përputhje të plot me të gjitha kushtet dhe specifikimet e kontratës dhe pjesëve integrale të saj. Mallrat merren në dorëzim pa vërejtje sipas faturës nr. 30741734/83”.

Me urdhër transfertë datë 04.02.2018 nëpërmjet Credins Bank është likuiduar shoqëria “A.C.” sh.p.k vlerën 1,731,480 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 1, datë 02.02.2018 ne vlerën 1,731,480 lekë, procesverbal i marrjes në dorëzim pa nr, datë 02.02.2018 i firmosur nga Sh. K., N. K. dhe P.P. Në këtë procesverbal citohet “Pas kontrollit të mallrave të dorëzuara nga kontraktuesi, rezulton se mallrat janë në përputhje të plot me të gjitha kushtet



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

dhe specifikimet e kontratës dhe pjesëve intregale të saj. Mallrat merren në dorëzim pa vërejtje sipas faturës nr. 59313651.

**10.Riparim transformatori 2500 KVA ,viti 2018**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Riparim Transformatori”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.176 Datë 07.08.2018</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “Kerkesë për Propozim”	Urdhër Nr.176 dt.07.08.2018  -F.T. me detyrë Shef i zyrës Juridike  -N. B. me detyrë ekonomiste  -ing. E. P. me detyrë ekonomiste	Urdhër Nr.176/1 dt. 07.08.2018  -ing. A. C. me detyrë Përgjegjës i sektorit mekanik  -A. M. me detyrë ekonomiste  -B. B. me detyrë specialiste e planifikim buxhetit
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b> 3,340,000 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b> <u>3,000,000</u> lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 340,000 lekë
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> <b>27.08.2018</b>	<b>9.Burimi Financimit</b> Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>1</u> OE b)S’kualifikuar <u>0</u> OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
<b>11.Ankimime</b> AK-s’ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b> - s’ka	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b> -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> Nr. 2714 prot.  Datë 20.09.2018	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 3,600,000 lekë	

**Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:**

Prokurim elektronik me procedurë “Kërkesë për Propozim”:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Me urdhër të administratorit M. M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr.176 prot., datë 07.08.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 3,340,000 lekë, me procedurë “Kërkesë për Propozim”.

Me urdhër të administratorit nr.176/1 prot. , datë 07.08.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë A. C., A. M. dhe B.B.

Me procesverbal të datës 25.06.2018 grupi i përllogaritjes së vlerës së kontratës , i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 46, datë 06.02.2018 i përbërë nga V.P. dhe B.B. është përcaktuar vlera 3,340,000 lekë pa tvsh.

Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në bazë të testimi të tregut për çmim për njësi sipas ofertës të ofruar nga operatori privat “I. E.”, “R. e”.

Vlera është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall(pajisje).

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, *nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.*

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V. P. dhe B. B.

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 08.08.2018 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F. T., N. B. dhe E. P.

Specifikimet teknike janë firmosur nga përgjegjësi sektorit elektrik ing. E. P.

Në pikën 2.3 të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se, Operatorët duhet të paraqesin, për sa i përket përvojës së mëparshme, furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 40% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, vërtetuar me dokumentacionin vertetues.

Veprim në kundërshtim me Shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit) nr. 3341/1 prot., date 20.03.2018, pasi nuk duhesh “Kërkuar që kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit , **por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Dorëzimi i ofertave në sistemin elektronik është bërë më datë 27.08.2018. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 31.08.2018, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

-Shoqëria “R. e ” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,000,000 lekë.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 2681 prot., datë 11.09.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga A. C, A. M. dhe B. B.

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M.M., protokolluar me nr. 2681 prot., datë 11.09.2018.Referura këtij raporti, është kualifikuar operatorët ekonomik “R. e” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,000,000 lekë

Me shkresën nr.2682 prot., datë 11.09.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor M.M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 37 , datë 17.09.2018

Kontrata është nënshkruar me datë 20.09.2019 nr. 2714 prot., me objekt “R. t” me vlerën 3,600,000 leke me tvsh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 39 , datë 01.10.2018

*-Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Në këtë procedurë prokurimi ka marr pjesë vetëm operatori ekonomik “R. e ” sh.p.k me ofertë në vlerën 3,000,000 lekë, dhe nuk u konstatua shkelje në vlerësimin nga KVO.

#### **Zbatimi i kontratës**

Me urdhër të administratorit nr. 207, datë 20.09.2018, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës i përbërë nga E. P., L.B. dhe C. U.

Me urdhër transfertë datë 17.10.2018 nëpërmjet Credins është likuiduar shoqëria “R. E” sh.p.k vlerën 3,600,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 48, datë 26.09.2018 në vlerën 3,600,000 lekë, procesverbal i marrjes në dorëzim 26.09.2018 i firmosur nga E.P., L. B. dhe C.U. Në këtë procesverbal citohet “.....transformatori u dorëzua në objekt i shoqëruar me aktkolaudim, u vu në punë dhe është brenda të gjitha parametrave. Të gjitha shërbimet e parashikuara në kontratë (DST) janë kryer plotësisht.

#### **11.Rivlersim aktivesh ,viti 2018**

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :“ Rivlersim aktivesh”</b>		
<b>1.Urdhër Prokurimi Nr.248 Datë 01.11.2018</b>	<b>3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit</b>	<b>4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b>
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b>  “Kerkese per Propozim”	Urdhër Nr.248 dt.01.11.2018  -F. T. me detyrë Shef i zyrës Juridike  -A. T. me detyrë ekonomiste  -ing. M. M. me detyrë Përgjegjë s i KUZ	Urdhër Nr.249 dt. 01.11.2018  -ing. L. P. me detyrë Drejtor Teknik  -Ing. M. F. me detyrë Përgjegjë se e sektorit teknik  -ing. B. A. me detyrë përgjegjë se e sektorit të Mjedisit
<b>5.Fondi Limit (pa tvsh)</b>  3,025,750 lekë	<b>6.Oferta fituese (pa tvsh)</b>  _____ 2,799,500 _____lekë	<b>7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b>  226,250 lekë

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**

<b>8. Data e hapjes së tenderit</b>  27.08.2018	<b>9.Burimi Financimit</b>  Të ardhurat e shoqërisë	<b>10.Operatorët Ekonomike</b>  a)Pjesëmarrës në tender Numër <u>1</u> OE  b)S’kualifikuar <u>0</u> OE,  c) Kualifikuar <u>1</u> OE
<b>11.Ankimime</b>  AK-s’ka;	<b>12. Përgjigje Ankesës nga AK</b>  - s’ka	<b>13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP</b>  -s’ka
<b>b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave</b>		
<b>14.Lidhja e kontratës</b>  Nr. 3082 prot.  Datë 14.12.2018	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b>  3,359,400 lekë	

***Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:***

Prokurim elektronik me procedurë “Kerkese per Propozim”:

Me urdhër të administratorit M. M. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor nr.248 prot., datë 01.11.2018, është urdhëruar të kryhet prokurimi me fond limit 3,025,750 lekë, me procedurë “Kërkesë per Propozim”.

Me urdhër të administratorit nr.249 prot. , datë 01.11.2018 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave përbërë L.P., M. F. dhe B. A.

Me procesverbal të datë s 31.10.2018 grupi i përlllogaritjes së vlerës së kontratës , i ngritur me urdhrin e administratorit nr. 46, datë 06.02.2018 i përbërë nga V. P. dhe B. B. është përcaktuar vlera 3,025,750 lekë pa tvsh.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në bazë të testimi te tregut për çmim për një si sipas ofertës të ofruar nga operatori privat “K. E. S”, “U. S.”.

Vlera është llogaritur si çmim mesatar për çdo mall pastaj është bërë shumëzimi për sasinë e nevojshme për çdo mall(pajisje).

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, ***nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.***

Veprim në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nei 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë:çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi V. P. dhe B. B.

Si konkluzion,përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Dokumentet e tenderimit janë miratuar me procesverbalin e datës 02.11.2018 të firmosura nga njësia e prokurimit e përbërë nga F. T., A. T. dhe M. M.

Specifikimet teknike janë firmosur nga G. M. dhe L.P.

Dorëzimi i ofertave ne sistemin elektronik është bërë me datë 22.11.2018. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar procesverbalin e vlerësimit datë 22.11.2018, për dorëzimin e dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë. Konkretisht:

-Shoqëria “U. S. ” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,799,500 lekë.

Anëtarët e KVO kanë hartuar raportin përmbledhës protokolluar me nr. 3034 prot., datë 04.12.2018 për titullarin, për këtë procedurë prokurimi dhe është firmosur nga komisioni i vlerësimit i përbërë nga L. P., M. F dhe B. A.

Raporti përmbledhës është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor M. M., protokolluar me nr. 3035 prot., datë 04.12.2018. Referuar kë tij raporti, është kualifikuar operatorët ekonomik “U.S.” sh.p.k me ofertë në vlerën 2,799,500 lekë.

Me shkresën nr. 3036 prot., datë 04.12.2018 të titullarit të autoritetit kontraktor M. M., formulari i njoftimit të fituesit të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 49 , datë 11.12.2018

Kontrata është nënshkruar më datë 14.12.2018 nr. prot., 3082 me objekt “Rivlerësim aktivesh” me vlerën 3,359,400 leke me tvsh, formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar të shkurtuar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 51 , datë 24.12.2018.

*-Zhvillimi i procedurës së tenderimit:*

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik, të dokumentacionit që shoqëron ofertën e paraqitur nga;

Operatori ekonomik “U. S. ” sh.p.k konstatohet se nga KVO është kualifikuar në mënyrë të pa drejt. Konkretisht Në pikën 2.3 “kapaciteti teknik” të kriterëve të kualifikimit, është përcaktuar se Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në organikën e vet të paktën 10 punonjës të siguruar për muajin shtator 2018, të vërtetuar nga administrata tatimore dhe dorëzimin e listëpagesave përkatëse. Pjese e stafit duhet të jenë të paktën nga një punonjës për profesionet si me poshtë: Ing. Mekanik, Ing. Elektrik, Ing. Hidroteknik, Ing. Ndertimi, Ing. Gjeodet, Ing. Mjedis/Trajtim Uji.

Në përbushje të kësaj kërkesë operatori ekonomik ka paraqitur.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Kontratën individuale të punës të lidhur ndërmjet U. S. ” sh.p.k dhe ing. A. A. me profesion ing. elektrik datë 15.01.2015 me afat deri 10.01.2020, me pagë 40,000 lekë në muaj. Kontratë e pa noterizuar në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, për pasoj kontratë e pa vlefshme, njëkohësisht pagesa në listëpagesë është 24,000 lekë.

Kontratën individuale të punës të lidhur ndërmjet U. S. ” sh.p.k dhe ing. N. Th. me profesion ing. hidro datë 31.07.2018 me afat deri , me pagë 24,000 lekë në muaj. Kontratë e noterizuar nga notere B.K., me vulë të njom pa vulë të thatë .

Kontratën individuale të punës të lidhur ndërmjet U. S. ” sh.p.k dhe ing. E. K. me profesion ing. ndërtimi datë 05.01.2018 me afat deri 31.12.2022, me pagë 60,000 lekë në muaj. Kontratë e pa noterizuar në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, për pasoj kontratë e pa vlefshme, njëkohësisht pagesa në listëpagesë është 24,000 leke.

Kontratën individuale të punës të lidhur ndërmjet U. S. ” sh.p.k dhe ing. B. D. me profesion ing. gjeoded datë 27.01.2015 me afat deri 27.01.2020, me pagë 30,000 lekë në muaj. Kontratë e pa noterizuar në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, për pasoj kontratë e pa vlefshme, njëkohësisht pagesa në listpagese është 24,000 leke.

Kontratën individuale të punës të lidhur ndërmjet U. S. ” sh.p.k dhe ing. Sh. C me profesion ing. kimist-teknolog datë 25.04.2015 me afat deri 10.01.2020, me pagë 40,000 lekë në muaj. Kontratë e pa noterizuar në kundërshtim veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/ll, si udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4, për pasoj kontratë e pa vlefshme, njëkohësisht pagesa në listpagese është 24,000 leke.

Kontratën individuale të lidhur ndërmjet U. S. ” sh.p.k dhe A. N. me vlerësim tokë truall, bujqësore, pyjore, livadhe dhe tokë e pa frytshme, datë 08.08.2017 me afat 10.08.2017 deri 10.08.2022, me shpërblim 50 % e vlerës së përfituar nga vlerësimi duke zbritur shpenzimet e zyrës për total shërbimi . Kontratë e pa noterizuar në kundërshtim veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/ll, si udhëzimin e Ministrisë së drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4, për pasoj kontratë e pa vlefshme.

Kontratën individuale të lidhur ndërmjet U.S. ” sh.p.k dhe G. N. me vlerësim ndërtese dhe tokë truall, , datë 08.08.2017 me afat 10.08.2017 deri 10.08.2022, me shpërblim 20 % e vlerës së përfituar nga vlerësimi duke zbritur shpenzimet e zyrës për total shërbimi . Kontratë e pa noterizuar në kundërshtim me veprim në kundërshtim me ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 62, pika 1/ll, si udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar, pika 4, për pasoj kontratë e pa vlefshme.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmujmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe atij për noterine, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë, pasi në këtë procedurë prokurimi ka marr pjesë vetë m operatori ekonomik Shoqëria “U. S. ” sh.p.k .



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korigjuar këtë praktik në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me an te efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

#### Zbatimi i kontratës

Me urdhër të administratorit nr. 278, datë 31.12.2018, është ngritur komisioni i zbatimit të kontratës së përbërë nga G.M., M. F., S. B.

Me urdhër transfertë datë 09.04.2019 nëpërmjet BKT është likuiduar Shoqëria “U. S ” sh.p.k vlerën 3,359,400 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 31, datë 01.03.2019 në vlerën 3,359,400 lekë.

**12.**Në procedurat e prokurimit si më poshtë nuk u konstatuan shkelje ligjore ose parregullsi,

- Shërbimi i ruajtjes së objekteve me roje private, viti 2019.
- Shërbimi i ruajtjes së objekteve me roje private, viti 2018.
- Printim faturash, viti 2018.
- Avolzhim i elektromotorëve, viti 2018.
- Blerje kimikate dhe reagente, viti 2019.
- Blerje karburant, viti 2018.
- Shërbimi i ruajtjes së objekteve me roje private, viti 2017

Për këto proceduar prokurimi është mbajtur aktkonstatimi nr. 20, 21,22, 23,nr. 24 datë 01.11.2019, nga audituesit respektiv sipas çdo aktkonstatimi.

#### Koment i grupit të auditimit

Në përgjigje të observacionit nr. 1655/1 prot, datë 13.12.2019 (protokoll Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime” sh.a Shkodër), protokolluar në KLSH me nr. 601/4 prot, date 16.12.2019, sqarojmë se nuk kemi paraqitur plotësisht prova dhe fakte të reja, të argumentuara ligjërisht dhe të shoqëruara me dokumentacion vërtetues, për pasojë janë marrë pjesërisht në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Konkretisht:

Pretendimi për llogaritjen e vlerës së kontratës ju sqarojmë se nuk qëndrojnë, argumentet në mënyrë të detajuar, pse ky observacion nuk qëndron, nr. 7,8,9,10,11, 12,13,15,16,17 datë 01.11.2019 sidhe në proektraportin e auditimit.

-Për më tepër në opinionin e grupit të auditimit përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, është një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, nga ana e Juaj duhet zbatuar me rigorozitet legjislacioni i posaçëm për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjeluar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik.

Me keq ardhje konstatojmë se jo vetëm jeni jasht kontekstit për të cilën grupi auditimit është shprehur, pasi është shprehur se “ .... Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës,**nuk është dhënë asnjë argumentim** përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë shoqëria.....”, nga grupi i auditimit nuk është llogaritur diferencë vlere nga kjo procedur është dhënë dhe opinionin se “Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatorë të përmendur si më sipër, në opinionin e grupit të auditimit, çmojmë se veprimet e mësipërme nuk janë kryer për qëllime përfitimi ose abuzimi me detyrën, por janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacioni specifik të procedurave të prokurimit, dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm të shoqërisë”.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

-Pretendimi për mos marrjen në konsideratë nga ana e jua të shkresës së Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 e cila rekomandon se “Për kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit , duhe për të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit dhe jo për tre vitet e fundit kalendarik, është çështje interpretimi: Në opinionin e grupit të auditimit APP është një organ qendror në fushën e prokurimeve publike. Gama e prerogativave me të cilat ligji e vesh këtë organ është mjaft i gjerë. Këtij organi me ligj i është besuar veprimtaria rregulluese (Në kuadër të propozimeve që ka të drejt ti paraqes këshillit të Ministrave mbi rregullat e prokurimit publik, veprimtarisë promovuese dhe nxitëse drejt përmirësimit të praktikave të prokurimit publik, veprimtari monitoruese ndaj veprimtarisë së autoriteteve kontraktore, veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në favor të këtyre të fundit, si dhe ajo sanksionuese. Në këtë kuadër rekomandimi i saj është një akt rregullator i cili nuk bie ndesh me dispozitat ligjore, por është në funksion të tyre dhe që duhet marr në konsideratë nga të gjitha entet prokurorese.

-Pretendimi për testraporti e fabrikës ëshë në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.

#### **8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.**

**Titulli i gjetjes:** Mangësi në vlerësimin dhe marrjen e masave të nevojshme të menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj risqeve që kërcënojnë shoqërinë.

**Situata:** Regjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi menaxhimi. Gjithashtu, Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është krijuar, dhe për pasojë nuk funksionon. Gjatë vitit 2018 kanë rezultuar rreth 370 avari rrjeti, çarje tubacionesh, të cilat kanë ndodhur kryesisht për shkak të rrjetit të amortizuar. Dëmtimet e shpeshta të rrjetit pamvarësisht nga rikuperimi i shpejtë, mungesa e përcaktimit dhe regjistrimit të servituteve të kalimit të rrjetit në prona private, lidhje të paligjësme të shumta, mungesa e stafit përkatës në sektorin teknik, mungesa e materialeve apo investimeve, cilësia e ulët e kontrollit të brendshëm, tregojnë se rikuperimi i proceseve apo sistemeve është i ngadaltë. Kjo do të thotë se ndikimi i kategorisë së riskut operacional është i lartë. Nga auditimi konstatohet se menaxhmenti jo vetëm nuk identifikon riskun përkatës, por edhe nuk e regjistron atë në regjistrin e riskut me qëllim ndjekjen dhe monitorimin si edhe marrjen e masave për reduktimin e tij. Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë, nuk ka ndërmarrë aktivitete të mjaftueshme për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënien dhe menaxhimin e riskut. Struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Ka sektorë që nuk janë organizuar në përputhje me natyrën e punës dhe efektivitetin e saj. Mjafton të përmendim Sektorin Teknik, i cili duhet të përfshijë funksionin e azhurnimit të rrjetit të ujësjellës–kanalizimeve, gjithashtu regjistrimin e servituteve të kalimit të rrjetit në prona private. Në rregulloren e brendëshme të shoqërisë rregullat apo proceset të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësisë, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës dhe procedurat. Proceset kryesore si p.sh. prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe furnizimi i ujit të pijshëm, faturimi, mbledhja e të ardhurave etj., nuk përfshijnë veprimtari të mjaftueshme të kontrollit, për të parashikuar masa të nevojshme për përcaktimin e prioriteteve dhe arritjen e objektivave. Kështu p.sh. normat e arkëtimit vazhdojnë të jenë të ulta në zonën rurale. Vetëm



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

gjatë muajit Gusht 2019 norma e arkëtimit në fshat rezulton 48 %, nga ku arkëtimi aktual është 2, 468, 026.49 lekë dhe faturimi 5, 136, 787.27 lekë. Gjithashtu, norma e arkëtimit në qytet rezulton 75 % ku arkëtimi aktual rezulton 19, 295, 887.93 lekë dhe faturimi 25, 880, 282.40 lekë. Sa sipër, për gjashtëmujorin e vitit 2019, sipas zonës së juridiksionit, popullsia në zonën rurale shkon rreth 93 403 banorë dhe ajo në zonën urbane 115 215 banorë. Gjithashtu, deri në Gusht të vitit 2019 numri aktual i lidhjeve të regjistruara nga UK Shkodër ndahet në 85% ose 26 628 klientë në zonën urbane, dhe 15% ose 4579 klientë në zonën rurale.

**Kriteri:** Në kundërshtim me pikën 1, neni 10, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2011, të ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, ku përcaktohet që:

*Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinator i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike.*

Në kundërshtim me pikat 2 dhe pika 3, neni 11, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, ku përcaktohet që:

*Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:*

*Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejojnë.*

*Garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejojnë, bazuar në rregullat e vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar.*

Në kundërshtim me pikën 23, nenin 4 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2011, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, ku përcaktohet që:

*Nëpunës autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tyre.*

Në kundërshtim me pikën 1, neni 27 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2011, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, ku përcaktohet që:

*Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e ëmëtejshëm dhe marrjen e masave.*

**Ndikimi/efekti:** Nuk krijon mundësi për të zbatuar një numër aktiviteteve kontrolli të brendshme dhe të mjaftueshme, për të siguruar se sistemet funksionojnë siç duhet.

**Shkaku:** Nuk njihen dhe zbatohen dispozitat përkatëse ligjore që rregullojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin.

**Rëndësia:** E lartë

Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime Shkodër” Sh.a. duhet të rrisë performancën e saj në drejtim të përdorimit dhe me efikasitet, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit sipas planeve të biznesit, që menaxhmenti i kësaj shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse. Ajo duhet të marrë masa për hartimin dhe menaxhimin e regjistrit të riskut, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT. Personat përgjegjës janë administratori i shoqërisë dhe menaxhmenti i lartë.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**Rekomandimi:** Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime Shkodër” Sh.a. duhet të rrisë performancën e saj në drejtim të përdorimit eficient të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit sipas planeve të biznesit, që menaxhmenti i kësaj shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse. Ajo duhet të marrë masa për hartimin dhe menaxhimin e regjistrit të rrisit, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT. Personat përgjegjës janë administratori i shoqërisë dhe menaxhmenti i lartë.

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e hartimit të listës së proceseve kryesore dhe gjurmëve të auditimit dhe arkivimi i tyre.

**Situata:** Shoqëria UK Shkodër SH.A zotëron 3 sisteme kanalizimesh me ngritje mekanike, 21 sisteme ujësjiellësi me ngritje mekanike dhe 2 sisteme ujësjiellësi me rrjedheje të lirë. Qyteti i Shkodrës furnizohet nga 11 puse të vendosura në fushën e Dobraçit e cila shtrihet në veri të qytetit. Këto puse nëpërmjet pompave e dërgojnë ujin në dy rezervuarë të ndërmjetëm 1000 m<sup>3</sup> dhe 150 m<sup>3</sup>, nga ku uji merret nëpërmjet dy stacioneve të pompimit.

Në kuadër të zbatimit të politikave komerciale shoqëria ka instaluar platformën elektronike Al-billing, e cila kryen administrimin si për të dhënat e klientit ashtu edhe për proceset komerciale. Nga auditimi konstatohet se procesi i faturimit përbëhet nga nën-menutë si Regjistrimi i Konsumit, Regjistrim Konsumi Liste, Regjistrim Konsumi Liste Indeks, Regjistrim Tarifah të Tjera, Anullo Konsum, Anullo Aforfe, Lista e Konsumit, Hap Muaj Faturimi, regjistro Tarifë Zbritje dhe Anullo Taksa. Gjithashu, procesi i leximit përbëhet nga Ngarkimi i Leximeve, Proceso Faturim Mujor, Kalimi i Leximeve për Lexuesit. Kështu p.sh. Praktika e leximit fillon me hapjen e faturimit nga Përgjegjësi i ITsë , pastaj kryhet ngarkimi i aparateve ( portativ të tipit data logic ose smart phone) në listën e matësve për lexim në datat 10 dhe 11 të çdo muaji, më tej dorëzimi i aparateve tek specialisti i IT ne datën 25 të muajit për shkarkimin e të dhënave në sistem. Nëse në procesin e leximit është integruar një aktivitet kontrolli, kontrolli i konsumit nën 0 m<sup>3</sup> dhe mbi 50 m<sup>3</sup> , nuk ndodh kështu me proceset e tjera. Nga auditimi konstatohet se ato janë ndërtuar për të ndihmuar kryesisht punën e stafit. Proceset nuk përmbajnë një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave, në mënyrë që të parashikojnë mënyrën e realizimit si edhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Në kushtet kur pothuaj gjysma e klientëve nuk janë të pajisur me matje, proceset e arkëtimit, të faturimit, të ankesave nuk përbëjnë procese të plota për të ndërtuar gjurmët e auditimit nga fillimi deri në fund të procesit. Dokumentacioni që shoqëron këto procese nuk rezulton i miratuar, gjithashu lista e proceseve dhe gjurmët e auditimit nuk rezultojnë të arkivuara.

Shoqëria nuk ka një laborator kimik për monitorimin e brendshëm të cilësisë të ujit të pijshëm, Drejtoria e Shëndetit Publik Rajonal Shkodër kryen kontrollet rutinë të ujit të papërpunuar dhe të ujit të pijshëm të rrjetit. Ajo ka përcaktuar 26 pika kontrolli të ujit të pijshëm të shpërndara në të gjithë rrjetin. Kampionet e ujit merren çdo ditë dhe bëhen me dije nëpërmjet Qendrës Dispeçer të UK Shkodër SH.A. Por, shoqëria ka përgjegjësinë e proceseve të dezinfektimit dhe klorinimit, dhe konstatohet se nuk ka një rregullore specifike për të përfshirë aktivitete kontrolli.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Një nga problemet e trashëguara në UK Shkodër janë humbjet e ujit në rrjet. Sipas bilancit të ujit për vitin 2018 volumi i ujit të prodhuar i vlerësuar nga shoqëria rezulton 12 264 599 m<sup>3</sup>, nga ku 4 161 212 m<sup>3</sup> përbën konsumin e ujit të faturuar ose 33 % dhe pjesa tjetër janë humbjet teknike dhe jo teknike. Sa sipër, sipas bilancit 7 536 741 m<sup>3</sup> ujë ose 61 % janë humbje nga lidhje të paligjëshme, të cilat vlerësohen nga shoqëria se vijnë nga zonat periferike të qytetit dhe lidhjet në rrjetin shpërndarës, që kalojnë nëpër territore private.

**Kriteri:** Në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, neni 16, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2011, të ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, ku përcaktohet që:

*Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.*

Në kundërshtim me pikën 19, nenin 4 të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2011, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“, ku përcaktohet që:

*“Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.*

Në kundërshtim me pikën 2.3, të Urdhërit të Ministrisë së Financave Nr.16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike“, ku përcaktohet që:

*Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerëimin dhe përmisimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke përfshirë hapat kryesore të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë, si më poshtë:*

*-Hartimi i listës dhe manualeve të proceseve të punës;*

*-Përgatitja e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.*

Në kundërshtim me pikën 3.2 të Manualit Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr.8980, datë 15.07.2010, ku përcaktohet që:

*Metoda e përgjithshme e rekomanduar për krijimin, vlerësimin dhe raportimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit përfshin 9 hapa kryesore:*

*1.Organizimin e procesit; 2.Hartimi i deklaratës së vizionit dhe misionit si edhe objektivave themelore të punës; 3.Vlerësimi i pesë komponentëve të kontrollit të brendshëm; 4.Lista ose harta e proceseve të punës; 5.Gjurmët e auditimit; 6.Procesi i menaxhimit të riskut; 7.Analiza e kontrolleve ekzistuese; 8.Masat korigjuese; 9.raporti përmbledhës i kontrollit të brendshëm.*

**Ndikimi/efekti:** Nuk krijon mundësi për të përcaktuar procedura, që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve. Gjithashtu, nuk krijon mundësinë për të ndjekur procesin nga fillimi deri në fund si edhe rindërtimin e transaksioneve me qëllim verifikimi.

**Shkaku:** Nuk zbatohen dispozitat ligjore që rregullojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Nga Administrator i Shoqërisë të merren masa për hartimin e listave të proceseve kryesore me qëllim që të parashikojë realizimin e proceseve kryesore, përfshirjen



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

e sektorëve të ndryshëm, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT dhe identifikimin e riskut.

*Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:*

-Vendimin Nr. 24712, datë 28.09.2000 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt: ‘Shërbimin e furnizimit dhe shitjes me ujë të pijshëm konsumatorëve, mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura si dhe mirëmbajtja e tyre’

-Rregullore e brendëshme e shoqërisë e miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ Nr.34 prot, datë 13.09.2017.

-Testimi për proceset kryesore dhe procedurat përkatëse.

-Pyetsorët për realizimin e komponentëve të MFK.

U konstatua se:

Referuar Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ujësjellës Kanalizime Shkodër sh.a. vepron si shoqëri aksionare me 100% të kapitalit shtetëror. Shoqëria është themeluar me Vendimin Nr. 24712, datë 28.09.2000 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt: ‘Shërbimin e furnizimit dhe shitjes me ujë të pijshëm konsumatorëve, mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura si dhe mirëmbajtja e tyre’. Shoqëria UK Shkodër SH.A. zotëron 3 sisteme kanalizimesh me ngritje mekanike, 21 sisteme ujësjelësi me ngritje mekanike dhe 2 sisteme ujësjelësi me rrjedheje të lirë. Qyteti i Shkodrës furnizohet nga 11 puse të vendosura në fushën e Dobraçit e cila shtrihet në veri të qytetit. Këto puse nëpërmjet pompave e dërgojnë ujin në dy rezervuarë të ndërmjetëm 1000 m<sup>3</sup> (me impiant automatik të klorinimit) dhe 150 m<sup>3</sup>, nga ku uji merret nëpërmjet dy stacioneve të pompimit. Nga atje, ‘stacioni vjetër’ dhe dy nga tre pompat e stacionit të ri, uji dërgohet direkt në rrjetin shpërndarës nëpërmjet dy tubacioneve kryesore 400 mm dhe 500 mm. Nga stacioni i ri, një pompë e dërgon ujin nëpërmjet tubacionit 400 mm në tre rezervuarët në kodrën e Tepes, nga ku një pjesë e rrjetit furnizohet me rënie të lirë.

Shoqëria në veprimtarinë e saj mbështetet në Kodin Ujit, miratuar me VKM Nr.1304, datë 11.12.2009. Në kuadrin e reformës së re administrative, referuar VKM Nr.63, datë 27.01.2016, shoqëria shtrin aktivitetin e saj në 11 njësi administrative të cilat janë Shkodra Urbane ( Shkodër, Shirokë, Zogaj, Baçallëk), Rrethina, Shalë, Shosh, Pult, Postribë, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç dhe Velipojë. Nga vlerësimi për 6 mujorin e parë të vitit 2019, numri i lidhjeve të regjistruara nga UK Shkodër ndahet në 85 % e popullsisë në qytet ose 26 628 klientë, si edhe 15 % e popullsisë në fshat ose 4 579 klientë.

Lidhur me Sistemin i Menaximit Financiar dhe Kontrollit të shoqërisë , mjedisi i kontrollit është një nga komponentët më të rëndësishëm të këtij sistemi. Struktura e shoqërisë reflektohet në rregulloren brendëshme të shoqërisë të miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ Nr.34 prot, datë 13.09.2017. Sipas organigramës struktura e UK Shkodër përbëhet nga dy departamente kryesore, departamenti tregtar dhe departamenti teknik. Departamentet e mësipërme përfshijnë përkatësisht, i pari: Drejtorinë Administrative Ligjore (Sek. Juridik, Sek.Burimeve Njerëzore, Sek.TaksForce), Sektorin e Financës, Sektorin e Shitjes, Sektorin e Planifikim/raportimit, dhe i dyti përfshin: Drejtorinë e Marrëdhënive me Konsumatorin (Sektori i Kujdesit ndaj Konsumatorit, Sektori IT&GIS), Sektorin e Ujësjellësit, Sektorin KUN (kanalizim ujrave të ndotura), Sektorin KUB (kanalizim ujrave të bardha), Sektori Elektrik/Mekanik, Sektori Teknik.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Politikat dhe procedurat komerciale të shoqërisë konsistojnë në regjistrimin e klientëve, faturimin, mbledhjen e të ardhurave, ankesat e klientëve dhe aktmarrëveshjet. Procedurat komerciale kanë të bëjnë me ecurinë e aktiviteteve dhe si rregull bazohen në politikat komerciale dhe formulohen me shkrim. Shoqëria ka instaluar platformën elektronike Al-billing, e cila kryen administrimin si për të dhënat e klientit ashtu edhe për proceset e mësipërme. Kjo platformë është organizuar me 8 menu kryesore si Abonenti, Faturimi, Leximi, Arkëtimi, Ankesat e Klientit, Akt-Marrëveshjet dhe Raportet. Nga auditimi konstatohet se procesi i faturimit përbëhet nga nën-menutë si Regjistrimi i Konsumit, Regjistrim Konsumi Liste, Regjistrim Konsumi Liste Indeks, Regjistrim Tarifah të Tjera, Anullo Konsum, Anullo Aforfe, Lista e Konsumit, Hap Muaj Faturimi, regjistro Tarifë Zbritje dhe Anullo Taksa. Gjithashu, procesi i leximit përbëhet nga Ngarkimi i Leximeve, Proceso Faturim Mujor, Kalimi i Leximeve për Lexuesit. Sikurse shihet këto dy procese bashkërisht ndjekin një proces pune nga fillimi deri në fund dhe krijojnë procedura të drejta për ndjekje. Kështu p.sh. Praktika e leximit fillon me hapjen e faturimit nga Përgjegjësi i ITsë , pastaj kryhet ngarkimi i aparateve ( portativ të tipit data logic ose smart phone) në listën e matësave për lexim në datat 10 dhe 11 të çdo muaji, më tej dorëzimi i aparateve tek specialisti i IT ne datën 25 të muajit për shkarkimin e të dhënave në sistem. Lidhur me proceset e tjera, sa më sipër ato janë ndërtuar për të ndihmuar kryesisht punën e stafit dhe për të rritur shërbimin ndaj klientit.

Gjatë auditimit, u konstatua, gjithashtu, se në rregulloren e brendëshme të shoqërisë rregulla apo proceset të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësi, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës dhe procedurat.

Autorizimet Nr.1161, prot.dt.12.10.2017 dhe Nr.2144 prot.dt.21.05.2018 etj.,të Administratorit të shoqërisë, tregojnë se ajo ka realizuar disa programe trajnimi dhe kualifikimi që synojnë t’i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur.

Por, nuk rezulton të ketë një procedure dhe format të miratuar për vlerësimin e performancës për punonjësit, që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt.

Me strukturën e re 2019 procesi i ndjekjes së debitorit ka kaluar nga Sektori Task Forcë në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Konsumatorin. Megjithëse, ndiqet një praktikë për debitorët nga listat e debitorëve dhe deri tek ndërprerjet apo marrëveshjet me debitorët, nuk duket që të jetë shoqëruar me një rregullore të veçantë.

Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit synon që menaxhmenti të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Përgjegjshmëria menaxheriale është një ndër parimet kryesore të parashikuara në pikën 9, neni 4 të Ligjit Nr.10296 datë 08,07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. Kjo kërkon, që në kryerjen e veprimtarive, menaxhmenti të respektojë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë dhe transparencës në administrim, si edhe të përgjigjet për rezultatet, që burojnë prej kësaj veprimtarie përpara organit që e ka emëruar.

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpallje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë ndërmarrjen. Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, duhet të kishte ndërmarr aktivitete shtesë për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut, pasi konstatohet se:



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

-Gjurmët e auditimit nuk janë hartuar, miratuar dhe arshivuar nga çdo sektor apo drejtori.

-Struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Ka sektorë që nuk janë organizuar në përputhje me natyrën e punës edhe efektivitetin e saj. Megjithë përditësimet e bëra nga Administratori së fundmi, struktura organizative ka nevojë për përmirësim. Mjafton të përmendim Sektorin Teknik, i cili duhet të përfshijë funksionin e azhurnimit të rrjetit të ujësllës –kanalizimeve, gjithashtu regjistrimin e servituteve të kalimit të rrjetit në prona private. Kjo duhet të sjellë për pasojë edhe përfshirjen e topografit në këtë pjesë të strukturës dhe jo tek Sektori i IT & GIS. Gjithashtu, mund të themi edhe për monitorimin e brendshëm të ujit të pijshëm. Shoqëria nuk ka një laborator kimik për monitorimin e brendshëm të cilësisë të ujit të pijshëm. Drejtoria e Shëndetit Publik Rajonal Shkodër kryen kontrollet rutinë të ujit të papërpunuar dhe të ujit të pijshëm të rrjetit. Ajo ka përcaktuar 26 pika kontrolli të ujit të pijshëm të shpërndara në të gjithë rrjetin, dhe se vetëm për qytetin e Shkodrës ekzistojnë 22 pika të tilla. Kampionet e ujit merren çdo ditë dhe bëhen me dije nëpërmjet Qendrës Dispeçer të UK Shkodër SH.A., e cila ka përgjegjësinë e proceseve të dezinfektimit dhe klorinimit.

- Listat e proceseve kryesore nuk janë hartuar, në mënyrë që të parashikojnë realizimin e procesit, përfshirjen e sektorëve të ndryshëm, dokumentacionin përkatës, si edhe identifikimin e riskut. Një nga problemet e trashëguara në UK Shkodër janë humbet e ujit në rrjet. Sipas bilancit të ujit për vitin 2018 volumi i ujit të prodhuar i vlerësuar nga shoqëria rezultoi 12 264 599 m<sup>3</sup>, nga ku 4 161 212 m<sup>3</sup> përbën konsumin e ujit të faturuar ose 33 % dhe pjesa tjetër janë humbjet teknike dhe jo teknike. Sa sipër, sipas bilancit 7 536 741 m<sup>3</sup> ujë ose 61 % janë humbje nga lidhje të paligjëshme, të cilat vlerësohen nga shoqëria se vijnë nga zonat periferike të qytetit dhe lidhjet në rrjetin shpërndarës, që kalojnë nëpër territore private.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është krijuar, dhe për pasojë nuk funksionon.

- Rregjistri i riskut nuk është hartuar nga çdo njësi menaxhimi.

Filozofia dhe stili i menaxhimit është një nga kërkesat bazë të mjedisit ku mbështetet i gjithë kontrolli i brendshëm. Kërkesa themelore këtu është mënyra se si identifikohet dhe reagohet ndaj risqeve. Këto kërkesa varen shumë nga shkalla në të cilën fokusohet mbikqyrja e menaxhmentit ndaj proceseve kryesore. Listimi i këtyre proceseve i detyron menaxherët e çdo sektori, që të identifikojnë risqet përkatës.

Menaxhimi i riskut është procesi që identifikon, vlerëson, dhe monitoron riskun me qëllim vendimmarrjen më të mirë, dhënien e garancisë të arsyeshme se objektivat do të arrihen, planifikim më të mirë të burimeve, adresim të prioriteteve etj.

Gjatë auditimit konstatohet se ekziston një ndikim i lartë i riskut operacional, për pasojë të ndodhin ngjarje të mundshme që të ndikojnë në zbatimin e funksioneve kryesore të drejtorive apo të sektorëve përkatës. Ato janë dëmtimet e pajisjeve apo dëmtime në rrjet (përfshi lidhjet e paligjëshme), mungesa e stafit përkatës, mungesa e materialeve apo investimeve etj. Askush përveç menaxhmentit nuk mund ti parashikojë më mirë ato. Faktorët, që ndikojnë këtu janë ndryshimet e rregullta strukturore, ndryshime në menaxhim, mungesa e stafit të nevojshëm, cilësia e sistemit të kontrollit të brendshëm, etj. Nga auditimi konstatohet se menaxhmenti jo vetëm nuk identifikon risqet përkatës, por edhe nuk i regjistron ato, me qëllim ndjekjen dhe monitorimin në regjistrin e riskut, me qëllimin final arritjen e objektivave.

Një nga rrugët e reagimit të shoqërisë ndaj risqeve kryesisht sot kryhet me anën e trajtimit të riskut, domethënë, nëpërmjet futjes së aktiviteteve të kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregulla, procedura, veprimtari apo procese, që synojnë reduktimin e risqeve. Këto aktivitete duhet të ingranohen tek proceset dhe sistemet në





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

momentin që ato krijohen. Kërkesat themelore këtu janë se ato duhet të jenë të përshtatshme (kontrolli i duhur, në vendin e duhur dhe në përpjestim me riskun e përfshirë), efektive, të kuptueshme dhe të dokumentuara qartë. Një shembull i mirë këtu është funksionimi i platformës AL-B, që përfshin proceset e faturimit dhe leximit. Nga auditimi rezulton se shoqëria ka krijuar aktivitet kontrolli parandalues lidhur me procesin e leximit të matësave dhe të faturimit, duke parashikuar riskun e leximit të gabuar për kufijte nën zero m<sup>3</sup> dhe mbi 50 m<sup>3</sup>. Por nuk ndodh kështu, për proceset e tjera si p.sh. prodhimi, transmetimi, shpërndarja, mbledhja e të ardhurave. Vetëm gjatë muajit Gusht 2019 norma e arkëtimit në qytet rezulton 75 % (arkëtimi aktual UK+tarifa 19, 295, 887.93 lekë dhe faturimi UK+Tarifa 25, 880, 282.40 lekë) dhe në fshat 48 % (arkëtimi aktual UK+tarifa 2, 468, 026.49 lekë dhe faturimi UK+tarifa 5, 136, 787.27 lekë).

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka qenë organizuar si një njësi më vehte gjatë viteve 2017, 2018 dhe Janar-Shtator 2019. Plani Strategjik i auditimit të brendshëm për vitin 2018-2020 është miratuar me vendimin nr.26, datë 05.10.2017 të Këshillit të Administrimit. NJAB gjatë vitit 2017-2018 ka kryer respektivisht 7 angazhime auditimi, duke dalë me 72 rekomandime në vitin 2017 dhe 45 rekomandime në vitin 2018. Rekomandimet kryesore janë: Njohja me Ligjin Nr.10296 datë 08,07.2010 Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar; Rishikimi i rregullores së brendshme; Planet vjetore në përputhje me objektivat e shoqërisë; Identifikimi i risqeve që vlerësohen si pengesa në arritjen e objektiveve; Përgatitja e procedurave të shkruara për proceset kryesore. Struktura e AB përbëhet nga 3 audit, ku njëri është në proces certifikimi, dhe tjetri punonjës i ri.

Sa sipër nga auditimi konstatohet se :

-UK Shkodër SH.A. nuk ka kryer vetëvlerësimin, nuk ka përpiluar pyetësonin e vetëvlerësimit dhe deklaratën e cilësisë së kontrolleve si bazë për vlerësimin e secilit komponent në përputhje me pikën 1, nenit 18 të Ligjit Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar

-Shoqëria nuk ka hartuar gjurmët e auditimit në përputhje me kërkesat në pikat 2 dhe 3 të nenit 16 të Ligjit Nr.10296 datë 08,07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

-Shoqëria nuk ka hartuar regjistrin e risqeve në përputhje me kërkesat e nenit 10, 12 të Ligjit Nr.10296 datë 08,07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Shoqëria nuk ka hartuar listat e proceseve kryesore si p.sh prodhimi, transmetimi, shpërndarja, mbledhja e të ardhurave, procesi i rekrutimit, procesi i arkivimit, e kështu me rradhë.

-Shoqëria nuk ka krijuar Grupin e Menaxhimit Strategjik në përputhje me kërkesën e nenit 27 të Ligjit Nr.10296 datë 08,07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Sa sipër, arrihet në konkluzionin që:

*Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk kuptohet sa duhet nga njësia publike dhe është implementuar në shkallë të ulët. Ky fakt provohet nga niveli i ulët i përputhshmërisë me kërkesat e Ligjit Nr.10296 datë 08,07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.*

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me:

-Ligjit nr.10296, datë 08.07.2011, të ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin“,  
-Urdhërin e Ministrisë së Financave Nr.16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit tërëskut në njësitë publike





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi me M. M. me detyrë Administrator i Shoqërisë, G. M. me detyrë drejtor tregtar dhe F. T. me detyrë drejtor i administrimit ligjor.

#### **9. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.**

Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se ambiente me qira të dhëna nga UKSH sh.a rezultojnë të jetë vetëm një ambient me sipërfaqe 40m<sup>2</sup> i cili i është dhënë T. Albania. U konstatua se kontratë qiraja e lidhur me datë 15.11.2011 përpara noterës M. Ç., me nr. 524 Prot., datë 24.11.2011, lidhur mes palëve Ujësjetellës Kanalizime qytet Shkodër përfaqësuar nga Drejtoresha në detyrë S. V. me nr NIPT-i J66902052A dhe shoqërisë anonime A. M. C. sh.a përfaqësuar nga Periklis Kanellos, Drejtor i Divizionit të Shitjeve pranë kësaj shoqërie mbajtës i pasaportës nr. AB4836876. Ujësjetellës Kanalizime Shkodër ka lidhur këtë kontratë për 40 m<sup>2</sup> të një ambienti në pronësi të UKSH-së me një periudhë 5-vjeçare me të drejtë rinovimi jo më pak se 5 vjet. Në nenin 3 të kontratës së nënshkruar përcaktohet qiraja mujore e cila do të paguhet nga qiramarrësi në vlerën prej 1200 euro bruto duke përfshirë edhe tatimin e mbajtur në burim të ardhurave. Kjo kontratë është amednuar me nr. 1604 prot., datë 10.11.2016 mes palëve UKSH dhe Telekom Albania për kohëzgjatje të afatit të kontratës për një afat kohorë deri më datë 31.10.2021, duke filluar nga data 01.11.2016 shuma mujore e qirasë neto do të jetë 1,260 euro. Nga dokumentacioni i paraqitur nga zyra e financës për pagesat e qirasë mujore u verifikua se kompania T. Albania ka kryer pagesat e qirasë mujore në mënyrë të rregullt pa vonesa. Si përfundim, kontrata e nënshkruar midis palëve është zbatuar në mënyrë të rregullt

#### **10. Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr. 8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.**

**Titulli i gjetjes:** Mungesa e organizimit të ekspertizës sipas normave tekniko-profesionale, për të përcaktuar vlerën e ruajtjes së dokumentacionit, afatet e ruajtjes, si edhe mungesa e pasqyrës emërtuese të çeljes së dosjeve.

**Situata:** Shoqëria UK Shkodër SH.A. nuk ka krijuar Komisionin e Ekspertizës, dhe për rrjedhojë ky komision nuk funksionon. Në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, të VKM Nr.4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njehësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, shoqëria nuk ka krijuar pasqyrën emërtuese të çeljes së dosjeve. Nuk është përpiluar lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave me rëndësi historike dhe kombëtare. Nuk bëhet përpunimi tekniko shkencor i dokumenteve të prapambetura. Nuk rezultojnë të jetë bërë ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve me qëllim përcaktimin e vlerës dhe kohës së ruajtjes së dokumenteve.

**Kriteri:** Në kundërshtim me pikën 1 dhe 2, neni 5 të VKM Nr.4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njehësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet që:

*Komisioni i Ekspertizës (KE) ngrihet pranë çdo fondkrijuesi, sipas ligjit “Për Arkivat” dhe Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

*Kryetar i KE është titullari i institucionit ose zëvendësi i tij. Sekretari i KE është punonjësi i ngarkuar me sekretari-arkivin, specialisti i arkivit ose përgjegjësi i sektorit të arkivit, sipas madhësisë së institucionit.....*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Në kundërshtim me pikën 1 dhe 2, neni 6 të VKM Nr.4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njehësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet që:

*Komisioni i Ekspertizës, me propozim të sekretarit, miraton në mbledhjen e parë listën konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare dhe dokumenteve me afat ruajtje të përkohshme, sipas modelit dhe në përputhje me listën tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*

*Lista konkrete miratohet edhe nga titullari i institucionit, në rastet kur kryetar i Komisionit të Ekspertizës është zëvendëstitullari.*

Në kundërshtim me pikën 1 dhe 2, neni 7 të VKM Nr.4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet që:

*Përpara datës 15 dhjetor të çdo viti, sekretaria, sekretari-arkivi apo punonjësi i ngarkuar me urdhër të titullarit me punët me dokumentet, përpilon pasqyrën emërtuese të çeljes së dosjeve për vitin pasardhës. Pasqyra hartohet veç për dokumentet me ruajtje të përhershme dhe veç për ato me ruajtje të përkohshme, me çështje të renditura sipas drejtorive apo sektorëve në përputhje me renditjen që kanë në strukturën organizative të institucionit, sipas modelit të përcaktuar në Normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

*Përpara ditës së parë të punës së vitit pasardhës, eprori i drejtpërdrejtë i sekretarisë, sekretari-arkivit apo punonjësit të ngarkuar me urdhër të titullarit me punët me dokumentet, miraton pasqyrën emërtuese të çeljes së dosjeve.*

Në kundërshtim me pikën 1, neni 7 të Ligjit Nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, ku përcaktohet që:

*Përcaktimi i vlerës dhe i afateve të ruajtjes së dokumenteve të arkivave në veprim të institucioneve shtetërore bëhet nga komisionet e ekspertizës, që funksionon pranë këtyre institucioneve.*

**Ndikimi/efekti:** Nuk krijon mundësi për të përcaktuar procedura të qarta dhe të njësuar në të gjithë rrjetin arkivor kombëtar për të mundësuar realizimin e përpunimit tekniko-shkencor, ruajtjen e dokumentacionit në arkiva brenda afateve të përcaktuara.

**Shkaku:** Nuk njihen dhe nuk zbatohen dispozitat ligjore që rregullojnë normat tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor, si edhe udhëzimet për klasifikimin, sistemimin, përshkrimin, ruajtjen dhe restaurimin e dokumenteve.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Arkivi i shoqërisë duhet të jetë në funksion të plotë të shërbimit arkivor dhe në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë normat tekniko-profesionale e metodologjike, si edhe udhëzimet për klasifikimin, sistemimin, përshkrimin, ruajtjen dhe restaurimin e dokumenteve,

Shoqëria duhet të krijojë Komisionin e Ekspertizës për të përcaktuar procedura të qarta dhe të njësuar me të gjithë rrjetin arkivor kombëtar për të mundësuar realizimin e përpunimit tekniko-shkencor, si edhe ruajtjen e dokumentacionit në arkiv brenda afateve të përcaktuara. Përgjegjshmëria e menaxhmentit bie direkt mbi Administratorin dhe Drejtorin e Burimeve Njerëzore të Shoqërisë UK Shkodër SH. A.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**11. “Riorganizimi në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.**

**Titulli i gjetjes:** Ujësjellës-Kanalizime Shkodër ka bërë rivlerësimin e të gjitha aktiveve të shoqërisë dhe nga procesi i rivlerësimit kapitali i shoqërisë ka rezultuar në vlerën 2,698,774 mijë lekë. Deri më datën 04.11.2019, datë në të cilën përfundoj auditimi nuk është miratuar ndryshimi i kapitalit në Asamblenë së Përgjithshme, nuk është bërë ndryshimi në satut dhe në QKB.

**Situata:** Me vendim të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 28, date 01.06.2016, është miratuar statuti i Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 471.000.000 lekë, aksione me vlerë nominale 1000 lekë secili, i përbërë nga aksioneri i vetëm Bashkia Shkodër. Organet e Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Administrimit.

Procesi i marrjes në dorëzim ka përfunduar në vitin 2017 dhe kapitali i bashkimit është pasqyruar në QKR, sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH nr. 6, datë 21.07.2017 dhe nr. 8, date 12.12.2017.

Është hartuar raporti “Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë”, nga ekspertët kontabël N.K. dhe M. F. me nr. 802 prot, datë 14.07.2017.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 6, datë 21.07.2017 të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër V. A., është miratuar shtesa në kapital, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 840.475.000 lekë nga 471.000.000 lekë që ishte.

Është hartuar raporti “Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë”, nga ekspertët kontabël N. K. dhe M. F. me nr. 1457, datë 12.12.2017

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 8, datë 18.12.2017 të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër V. A., është miratuar shtesat në kapital, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 863.468.000 lekë, nga 840.475.000 lekë që ishte.

Ujësjellës-Kanalizime Shkodër ka bërë rivlerësimin e të gjitha aktiveve të shoqërisë nëpërmjet palës së tretë, shoqërisë “U. S.”, të përzgjedhur nëpërmjet procedurës së prokurimit me kontratën me nr. 3082 datë 14.12.2018, dhe shërbimet janë marrë në dorëzim me proces-verbalin e datës 01.03.2019, nga procesi i rivlerësimit kapitali i shoqërisë është në vlerën 2,698,774 mijë lekë. Deri më datën 04.11.2019, datë në të cilën përfundoj auditimi nuk është miratuar ndryshimi i kapitalit në Asamblenë së Përgjithshme dhe nuk është bërë ndryshimi në QKB.

**Kriteri:** VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

**Ndikimi/efekti:** Mos pasqyrimi i sakt i vlerës së kapitalit të shoqërisë në statut dhe në QKB.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**Shkaku:** Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.

**Rëndësia: I mesëm**

#### **Rekomandimi:**

Nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrimit të merren masa për rritjen e kapitalit të Shoqërisë “UK” Sh.a Shkodër, pasi statuti aktual i shoqërisë dhe QKB përcakton një kapital të regjistruar në vlerën 863.468 mijë lekë dhe jo kapitlin e rivlerësuar në 2,698,774 mijë lekë.

**3. Titulli i gjetjes:** Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” Sh.A, Shkodër ka aplikuar për ndryshimin e tarifave ujit pranë Entit Rregullator me aplikim me nr. 739 prot, datë 30.06.2017, por deri më datë 04.11.2019, datë në cilën përfundoj auditimi Enti Rregullator i Ujit nuk e ka miratuar këtë ndryshim.

**Situata:** Shoqëria ka aplikuar për ndryshimin e tarifave ujit pranë Entit Rregullator me aplikim me nr. 739 prot, datë 30.06.2017.

Enti Rregullator i Ujit me vendimin nr. 25, date 30.03.2018, ka vendosur të mos miratoj kërkesën e bërë nga UKSH, pasi nuk është paraqitur opinioni i Këshillit Bashkiak Shkodër (Asambleja e Përgjithshme), për tarifat e reja të propozuara.

**Kriteri:** Statuti i Shoqërisë.

**Ndikimi/efekti:** Mos ushtrimi plotësisht i veprimtarisë së shoqërisë konform legjislacionit specifik në fuqi (lejet, autorizimet, liçensat etj) për : Shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij; Mirëmbajtja e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve; Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajnimit të ujërave të ndotura; Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

**Rëndësia: I Lartë**

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për miratimin në Asamblenë e Përgjithëshme të ndryshimit të tarifave të ujit, dhe dërgimin tek Enti Rregullator në kohën më të shpejt të mundshme për të mundësuar kryerjen e aktivitetit të shoqërisë me performancë të përmirësuar të treguesve ekonomiko-financiar..

*Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:*

- Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas Ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është:

-Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;

-Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;

-Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;

-Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

-Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre;

-Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

-Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, liçensat sipas legjislacionit në fuqi;

-Shoqëria funksionon sipas përcaktimeve të Statutit të Miratuar nga Këshilli Bashkiak Shkodër me vendimin nr. 28, date 01.06.2016 brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Në zbatim të dispozitave ligjore, U.K.SH.sh.a. merr masa për:

- Krijimin e kushteve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së punonjësve të Shoqërisë.
- Zbatimin e rregullave Higjeno – Shëndetësore në punë.
- Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbarëvajtjen në punë.
- Zbatimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri.

Shoqëria “Ujësjiellës- Kanalizime Shkoder ” Sha , është riorganizuar në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, ku shoqëria UK Shkoder mbulon me shërbimin e furnizimit të ujit dhe largimin e ujërave të ndotura, te gjithë territorin e Bashkisë Shkoder, ku përfshihen njësitë administrative Shale, Postribë, Guri i Zi, Berdicë, Ana Malit, Dajç dhe Velipojë, të cilat kanë qenë nënë administrimin e ish-Ujësjiellësit Fshat Shkodër, duke përfshirë edhe territorin e qytetit të administruar nga Ujësjiellës-Kanalizime Qytet.

Me vendim të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 28, date 01.06.2016, është miratuar statuti i Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 471.000.000 lekë, aksione me vlerë nominale 1000 lekë secili, i përbërë nga aksioneri i vetëm Bashkia Shkodër. Organet e Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Administrimit.

Procesi i marrjes në dorëzim ka përfunduar në vitin 2017 dhe kapitali i bashkimit është pasqyruar në QKR, sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH nr. 6, datë 21.07.2017 dhe nr. 8, date 12.12.2017.

Është hartuar raporti “Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë”, nga ekspertët kontabël N. K. dhe M. F. me nr. 802 prot, datë 14.07.2017.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 6, datë 21.07.2017 të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër V. A., është miratuar shtesa në kapital, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 840.475.000 lekë nga 471.000.000 lekë që ishte.

Është hartuar raporti “Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë”, nga ekspertët kontabël N.K. dhe M. F. me nr. 1457, datë 12.12.2017

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 8, datë 18.12.2017 të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër V. A., është miratuar shtesat në kapital, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 863.468.000 lekë, nga 840.475.000 lekë që ishte.

Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër ka bërë rivlerësimin e të gjitha aktiveve te shoqërisë nëpërmjet palës së tretë, shoqërisë “U. S.”, të përzgjedhur nëpërmjet procedurës së prokurimit me kontratën me nr. 3082 datë 14.12.2018, dhe shërbimet janë marrë në dorëzim me proces-verbalin e datës 01.03.2019, nga procesi i rivlerësimit kapitali i shoqërisë është në vlerën 2,698,774 mijë lekë. Deri më datën 04.11.2019, datë në të cilën përfundoj auditimi nuk është miratuar ndryshimi i kapitalit në Asamblesë së Përgjithshme dhe nuk është bërë ndryshimi në QKB.

Ujësjiellës-Kanalizime Shkodër sh.a funksionon në bazë të licencës nr. 26 sipas vendimit nr. 55, datë 29.12.2017 të Entit Rregullator, me objekt “Për grumbullimin, shpërndarjen, përpunimin e ujit për konsum publik dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” e vlefshme deri me datë 28.12.2021. Ku përfshihen të gjithë zonën e shërbimit te Bashkisë Shkodër, sipas kategorive:

- Kategoria A, “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

- Kategoria C “Për largimin e ujërave të ndotura”
- Kategoria D “Për trajtimin e ujërave të ndotura”

Drejtues ligjor i shoqërisë është M. M.

Drejtues teknike të shoqërisë janë L. P. dhe B. A.

Shoqëria ka aplikuar për ndryshimin e tarifave pranë Entit Rregullator të Ujit me aplikim me nr. 739 prot, datë 30.06.2017.

Enti Rregullator i Ujit me vendimin nr. 25, date 30.03.2018, ka vendosur të mos miratoj kërkesën e bërë nga UKSH, për arsye se ka mangësi në dokumentacion, pasi nuk është paraqitur opinioni i Këshillit Bashkiak Shkodër, për e e reja të propozuara.

## V. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

### B. MASA ORGANIZATIVE

*Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:*

**1. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Ujësjiellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër, nuk ka zbatuar dhe realizuar në mënyrë të plotë rekomandimet e KLSH-së të dhëna nga auditimet e mëparshme. Konkretisht janë rekomanduar 36 masa organizative nga KLSH, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, nga masat e zbatuara 3 masa janë në proces dhe 30 janë pranuar, por zbatimi është dhe në vijimësi.

Janë rekomanduar 5 masa për shpërblim dëmi me vlerë totale 6,934,888 lekë, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, nga masat e zbatuara 2 masa në vlerën 5,727,052 lekë janë zbatuar plotësisht, ndërsa 3 masa në vlerën 1,207,836 janë zbatuar, por realizimi është në proces.

Për eliminimin e efekteve negative financiare janë rekomanduar 6 masa në vlerën 38,846,003 lekë, të cilat janë pranuar dhe zbatuar, nga masat e zbatuara 2 masa në vlerën 33,705,545 lekë janë zbatuar plotësisht, ndërsa 4 masa në vlerën 5,140,458 janë pranuar, por kërkohet vijueshmëria e zbatimit edhe në të ardhmen.

Janë rekomanduar 19 masa disiplinore të cilat janë zbatuar 18, ndërsa 1 masë nuk është zbatuar. Mos zbatimi i një mase disiplinore është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 në faqet 15-15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Shoqëria “Ujësjiellës- Kanalizime” Sh.a Shkodër, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

*Nga auditimi i riorganizimit të shoqërisë në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, u konstatua që:*

**1. Gjetje nga auditimi:** Me vendim të Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 28, date 01.06.2016, është miratuar statuti i Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 471.000.000 lekë, aksione me vlerë nominale 1000 lekë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

secili, i përbërë nga aksioneri i vetëm Bashkia Shkodër. Organet e Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Administrimit.

Procesi i marrjes në dorëzim ka përfunduar në vitin 2017 dhe kapitali i bashkimit është pasqyruar në QKB, sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të UKSH nr. 6, datë 21.07.2017 dhe nr. 8, datë 12.12.2017.

Është hartuar raporti “Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë”, nga ekspertët kontabël N.K. dhe M. F. me nr. 802 prot, datë 14.07.2017.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 6, datë 21.07.2017 të përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër V. A., është miratuar shtesa në kapital, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 840.475.000 lekë nga 471.000.000 lekë që ishte.

Është hartuar raporti “Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë”, nga ekspertët kontabël N.K. dhe M. F. me nr. 1457, datë 12.12.2017.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 8, datë 18.12.2017 të përfaqësuar nga kryetarja e Bashkisë Shkodër V. A., është miratuar shtesat në kapital, ku është përcaktuar se kapitali i shoqërisë është në vlerën 863.468.000 lekë, nga 840.475.000 lekë që ishte.

Ujësjellës-Kanalizime Shkodër ka bërë rivlerësimin e të gjitha aktiveve të shoqërisë nëpërmjet palës së tretë, shoqërisë “U. S.”, të përzgjedhur nëpërmjet procedurës së prokurimit me kontratën me nr. 3082 datë 14.12.2018, dhe shërbimet janë marrë në dorëzim me proces-verbalin e datës 01.03.2019, nga procesi i rivlerësimit kapitali i shoqërisë është në vlerën 2,698,774 mijë lekë. Deri më datën 04.11.2019, datë në të cilën përfundoj auditimi nuk është miratuar ndryshimi (rritja) e kapitalit në Asamblesë së Përgjithshme dhe nuk është bërë ndryshimi në QKB (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11 në faqet 101-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Administrimit të merren masa për rritjen e kapitalit të Shoqërisë “UK” Sh.a Shkodër, pasi statuti aktual i shoqërisë dhe QKB përcakton një kapital të regjistruar në vlerën 863.468 mijë lekë dhe jo kapitalin e rivlerësuar në 2,698,774 mijë lekë.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Ujësjellës Kanalizime” Sh.A, Shkodër ka aplikuar për ndryshimin e tarifave ujit pranë Entit Rregullator me aplikim me nr. 739 prot, datë 30.06.2017, por deri më datë 04.11.2019, datë në cilën përfundoj auditimi Enti Rregullator i Ujit nuk e ka miratuar këtë ndryshim.

Enti Rregullator i Ujit me vendimin nr. 25, date 30.03.2018, ka vendosur të mos miratoj kërkesën e bërë nga UKSH, për arsye se ka mangësi në dokumentacion, pasi nuk është paraqitur opinioni i Këshillit Bashkiak Shkodër (Asambleja e Përgjithshme), për tarifat e reja të propozuara. Veprim në kundërshtim me statutin e shoqërisë çka ngarkon me përgjegjësi Këshillin e Administrimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 11 në faqet 102-104, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për miratimin në Asamblesë e Përgjithshme ndryshimin e tarifave të ujit, dhe dërgimin tek Enti Rregullator në kohën më të shpejt të mundshme, për të mundësuar kryerjen e aktivitetit të shoqërisë me performancë të përmirësuar të treguesve ekonomiko-financiar.

*Brenda datës 29.02.2020*

*Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua që:*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Për periudhën 01.07-31.12.2017 janë zhvilluar 5 procedura prokurimi me vlerë 34,518 mijë lekë. Janë audituar 5 proceduar prokurimi me vlerë 30,238 mijë lekë ose 88 % e vlerës së tyre.

Për vitin 2018 janë zhvilluar 9 procedura prokurimi me vlerë 49,500 mijë lekë. Janë audituar 9 proceduar prokurimi me vlerë 49,500 mijë lekë ose 100 % e vlerës së tyre.

Për periudhën 01.01-31.08.2019 janë zhvilluar 8 procedura prokurimi në vlerën 92,056 mijë lekë. Janë audituar 4 proceduar ne vlerën 76,279 mije lekë, ose 83 % e vlerës së tyre. Auditimi i procedurave të prokurimit është kryer me zgjedhje.

Nga auditimi u konstatuan shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore si më poshtë vijon:

#### 1. Gjetje nga auditimi:

Në 10 procedura prokurimi për vlerën 48,371 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë shoqëria, si dhe manualet teknike në fuqi, por nuk është dhënë asnjë argument përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

-Për 9 procedura prokurimi për vlerën 45,031 mijë lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, për kriteret e veçanta për kualifikimit, nuk është dhënë asnjë argument për përcaktimin e tyre dhe nuk është dokumentuar me procesverbal ky përcaktim, veprim në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

-Në 10 procedura prokurimi për vlerën 95,277 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë,veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 15 raste për vlerën 6,425 mijë lekë, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Në opinionin e grupit të auditimit, arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 38-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Për mbrojtur interesat publike, duke siguruar se fondet publike shpenzohen në mënyrën e duhur, të besueshme dhe me efikasitet, me konkurrencë dhe transparencë në prokurimet publike, si dhe për të siguruar, që të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike të trajtohen në mënyrë të drejtë, nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë:

- Përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si një operacion mjaftë i vështirë dhe në të njëjtën kohë mjaftë i rëndësishëm, për shkak se zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, do të varet përkatësisht nga përcaktimi i



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Pikërisht për këtë arsye, duhet zbatuar me rigorozitet Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, për këtë procedurë specifike, kjo edhe për të mënjanuar shmangien nga rregullat e prokurimit nëpërmjet ndarjes apo pjesëtimit të vlerës së kontratave të prokurimit publik.

-Autoriteti kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të till që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kriterëve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

-Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të pa parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

*Nga auditimi i zbatimit të ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua që:*

**1. Gjetje nga auditimi:** Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.A, Shkodër, nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë në kundërshtim me pikën 3 të nenit 12 të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” dhe pikën 3 të nenit 12 të Statutit të UK Shkodër SHA, kontratë e cila duhej të lidhej që në momentin e emërimit të tyre, ku jetë parashikuar, ndër të tjera, kriteret të qarta performance që pritej t'i arrinin në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë, duhet të miratoheshin edhe nga ministria e linjës dhe duhet të ishin të matshme në përputhje me biznes planet e shoqërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 16-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga kryetari i Bashkisë Shkodër në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të lidhen kontrata me anëtarëve e Këshillit të Administrimit, në të cilat të parashikohen kriteret të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë.

**Rekomandimi 1.2:** Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet jenë të matshme në përputhje me biznes planet e Shoqërisë.

*Brenda datës 29.02.2020*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, nuk është bërë rinovimi vjetor i kontratës së Administratorit të Shoqërisë, bazuar në vlerësimet vjetore pozitive të performancës të punës së tij, veprim në kundërshtim me VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, si dhe të Statutit të UK Shkodër SHA. Administratori Shoqërisë emërohet për një periudhë kohe prej tre vitesh, dhe qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë kontratash të rinovueshme vjetore mes tij dhe Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performancës së punës së tij (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 16-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Në zbatim të vendimit nr. 5, datë 30.05.2019 të Asamblesë së Përgjithshme, të lidhet kontratë me Administratorin, në të cilën të parashikohen kriteret të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës së Administratorit, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë.

#### *Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Këshilli i Administrimit me Vendimet nr. 15, 16, 17 datë 20.03.2019, ka vendosur dhënien e masës disiplinore jashtë kompetencës në tre raste. Theksojmë se në parashikimet e rregullores së brendshme të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.A, Shkodër të nxjerrë nga Këshilli i Administrimit, evidentohen parashikime juridike të cilat janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe shkaktojnë problematika lidhur me përcaktimin e organit kompetent për përcaktimin e masave administrative. Më konkretisht, evidentohet se neni 7 i rregullores i njuh kompetencën për marrjen e masave disiplinore eprorit direkt të punonjësit, ndërsa neni 14 ia njuh këtë kompetencë “Administratorit/Drejtorit”. Këto parashikime nuk evidentojnë qartësisht organin kompetent për marrjen e masave administrative ndaj punonjësve duke ia ka njohur këtë kompetencë: administratorit/ drejtorit dhe eprorit direkt. Pra potencialisht, për të njëjtin punonjës, mund të pretendojnë kompetencën për marrjen e masës disiplinore të dy nëpunësit e sipërcituar, duke çuar potencialisht edhe në dy vendime të ndryshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 16-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë të bëhet amendim i rregullores së brendshme lidhur me dhënien e masave disiplinore për punonjësit.

*Brenda datës 31.03.2020*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi mosrespektim i parashikimeve të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe parashikimeve të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, lidhur me publikimin në faqen e internetit të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.A, Shkodër të dokumentacionit të detyrueshëm për t’u publikuar, sipas parashikimeve të këtyre akteve, ndër të tjera lidhur me procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të cilat duhet të ishin të publikuara në faqen zyrtare të internetit të UK Shkodër jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes për të cilën janë mbajtur (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 në faqet 16-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Asambleja së Përgjithshme dhe Administratori i Shoqërisë të merren masa për publikimin në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë të dhënat/dokumentet e detyrueshme për tu publikuar.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

*Nga auditimi mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, u konstatua që:*

**1. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të





## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Shkodër, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehësuar kriteret e nevojshme për punësim (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 28-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara staturore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

**Rekomandimi 1.2:** Nga organet drejtuese të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundra ligjshme që mund të shkaktohen.

**Rekomandimi 1.3:** Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Mospërputhje e parashikimeve të kontratave të personelit me përcaktimet e Rregullores së Brendshme lidhur me llojet e masave disiplinore. Në të gjitha kontratat e personelit (tre mujore, tre vjeçare dhe pa afat) të lidhura gjatë periudhës objekt auditimi, evidentohen masa disiplinore të ndryshme nga ato të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 në faqet 28-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa që parashikimet e kontratave të personelit të bëhen në pajtim me parashikimet e rregullores së përgjithshme.

*Në vijimësi*

*Nga auditimi i mbajtjes së evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit, u konstatua që:*

**1. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të shoqërisë, në pasiv në pozicionin e të ardhurave të shtyra, konkretisht në lidhje me grandet në bilancin e vitit 2018 në vlerën 4.323.216.953, në vitin 2017 në vlerën 4,542,971,684 lekë (ndryshimi i pakësuar në vlerën 219,754,731 lekë, nga të cilat granti nga projekti gjerman (-) 233,664,009 lekë dhe grande nga shteti (+) 13,909,275, ndërsa në bilancin e vitit 2017 në vlerën 4,542,971,684 lekë krahasim me vitin 2016 në vlerën 3,281,703,880 lekë ndryshimi shtuar (+)1,261,267,804, ndryshim i gjithë nga granti projekt Gjerman.

Ndërkohë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në zërin të ardhura nga rimarrja e grantit, për vitin 2018 është pasqyruar në vlerën 233,264, 009 lekë dhe për vitin 2017 në vlerën 289,215,517 lekë.

Siç shihet granti nga projekti gjerman për vitin 2017 duke marre parasysh pakësimin nga rimarrja si e ardhur është rritur me tepër (1,261,267,804+289,215,517)=1,550,483,323 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Theksojmë se ky projekt është zbatuar në vitet 2009-2015 dhe ka përfshirë 5 kontrata: Konkretisht: Blerje makineri dhe pajisje, ndarja e sistemit të KUZ me KUB “Stacioni UZ Pazar, “Kolektor kryesor nga Euro Drini deri stacionin e KUZ Pazar”, kontrata investime në ujësjellës “Linjë e re stacion Dobrac deri tek puseta Dobrac”, “Linjë e transmetimit Rus-Xhabie”, “Linja terciare”, kontrata impianti i ri i Shirokës dhe kontrata e vendosjes rreth 15 mijë matësve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 33-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Në pasqyrat financiare të viti 2019:

-Të bëhet një analizë më e detajuar mbi grandet përsa i përket natyrës, shtesave që mund të kenë ndodhur gjatë periudhës dhe pakësimeve në formën e rimarrjes në të ardhurat.

-Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të paraqitet informacioni më i detajuar në lidhje me grantet dhe ndihma të tjera: (a) natyrën dhe shumën e granteve të njohura në pasqyrat financiare; (b) kushtet e pa përmbushura dhe detyrimet e kushtëzuara të lidhura me grantet që nuk kanë qenë të njohura në të ardhurat; (c) një përshkrim të formave të tjera të ndihmës qeveritare ose joqeveritare nga të cilat njësia ekonomike ka përfituar drejtpërdrejt duke lënë gjurmë edhe në shënimet shpjeguese.

-Në pasqyrën e fluksit të parasë në vitin 2017, të saktësohet shuma e rimarrjes të ardhurave nga grandet në efektin minus vlera 289,215,517 lekë, si dhe pasqyra e fluksit të parasë në pjesë në fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur) në aktivitetin e investimit-grande, në efektin që japin në cash flow dhe në vlerën përkatëse.

**2. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare të vitit 2017 përsa i përket AAGJ, nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar këto aktive përsa i përket shtesave dhe pakësimeve, në vlerat e tyre, situata nga burime të ndryshme raportimesh si me poshtë:

Nga aktivi i bilancit, AAM në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 kanë rritje në vlerën 1,334,262,876 lekë, ndërsa AAJM një pakësim në vlerën 3,077,715 lekë, total me efekt të aktiveve afatgjata rritje në vlerën 1,331,185,161 lekë.

Në shënimet shpjeguese që shoqërojnë bilancin e vitit 2017, në pikën 8 të kësaj pasqyre vlera e AAGJ para amortizimit të vitit është në vlerën 6,695,516,889 lekë, pra nuk rakordon me vlerën mbetur e mbartur nga viti 2016, në shumën 3,170,699,719 lekë, plus ndryshimet sipas kësaj pasqyre shtesa aktive të blera gjatë vitit në vlerën 1,941,109,866 lekë.

Totali  $(3,170,699,719 + 1,941,109,866) = 5,111,809,585$  lekë.

Pra ka një mos rakordim  $= 1,583,707,304$  lekë.

Pasqyra e aktiveve afatgjata materiale me vlerat e çelura nga viti 2016, si dhe shtesat pakësimet, si dhe amortizimet përkatëse mungon.

Në pasqyrat financiare vitit 2018, përsa i përket AAGJ, nuk janë pasqyruar ndryshimet që kanë pësuar këto aktive, përsa i përket shtesave dhe pakësimeve, në vlerat e tyre, situata nga burime të ndryshme raportimesh si më poshtë:

Nga aktivi i bilancit, AAM në vitin 2018 krahasuar me 2017, janë pakësuar në vlerën 154,718,693 lekë, ndërsa AAJM janë pakësuar në vlerën 80,283,710 lekë, në total ndryshimi i aktiveve afatgjata pakësuar në vlerën 235,000,403 lekë.

Nga pasqyra e shënimeve shpjeguese që shoqërojnë bilancin e vitit 2018, në pikën 8 të kësaj pasqyre vlera e AAGJ është 4,955,676,845 lekë, nuk rakordon me vlerën mbetur e mbartur nga viti 2017 në shumën 4,946,015,237 lekë, plus ndryshimet sipas kësaj pasqyre shtesa aktive blera gjatë vitit në vlerën 9,311,390 lekë.

Totali  $(4,946,015,237 + 9,311,390) = 4,955,326,627$  lekë. Pra ka një mos rakordim në vlerën 350,218 lekë.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Pasqyra e aktiveve afatgjata me vlerat e AAGJ shtesa e AAGJ ne rritje është prej 9,661,606 lekë nga shtesat 34.825.69 dhe pakësimet 25.164.088 (34.825.69 -25,164,088=9.661.606 lekë.

Referuar sa më sipër, ka një mos rakordim në shtesa të AAGJ midis dy burimeve të fundit përsa i përket blerjes së AAGJ (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 33-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Në pasqyrat financiare të viti 2019:

-Të plotësohet pasqyra e aktiveve afatgjata materiale e rakorduar me çeljen nga viti i mbartur dhe të pasqyrohen shtesa dhe pakësimet gjatë periudhës.

-Të saktësohet amortizimi përkatës i tyre, si në bilanc ashtu edhe në PASH.

- Në shënimet shpjeguese, të saktësohen burimet e tjera informative, pasqyra e fluksit parasë etj.

*Duke respektuar afatet ligjore te hartimit dhe miratimit të pasqyrave financiare*

**3. Gjetje nga auditimi:** Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” SH.A Shkodër. Megjithatë nga organet drejtuese të saj nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

Konkretisht gjendja debitore për vitin 2017 është në vlerën 1,066,367,794 lekë, ndërsa për vitin 2018 është në vlerën 1,143,319,951 lekë. Peshën kryesore të llogarive të arkëtueshme, në masën 92% për vitin 2017 dhe 95% për vitin 2018, e zënë klientët për shitje uji.

Nga verifikimi i llogarisë 411000 në kontabilitet për vitin 2017, kjo gjendje paraqitet në vlerën 1,019,057,660 lekë dhe për vitin 2018, në vlerën 1,095,989,046 lekë.

Ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 708,591,468 lekë për vitin 2017 dhe 789,255,534 lekë për vitin 2018.

Duke iu referuar të ardhurave dhe shpenzimeve gjendja debitore zë 59 % të të ardhurave për vitin 2017 dhe 53% për vitin 2018, ndërsa gjendja kreditore zë 89% të shpenzimeve për vitin 2017 dhe 77% për vitin 2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 33-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Administrativ, të analizojë gjendjen debitore dhe kreditore të Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër më datë 31.12.2019, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre.

*Brenda datës 29.02.2020*

**4. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nuk është kryer inventari fizik i aseteve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe atij ekonomik. Gjatë investimeve të ndryshme në linja e kanalizime të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kryer veprimet përkatëse në kontabilitet referuar Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 33-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa për të kryer inventarin fizik të aseteve të shoqërisë, të evidentohen linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit, si dhe të kryhen procedurat përkatëse.

*Brenda datës 30.06.2020*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Shoqërinë “Ujësjiellës Kanalizime” Sh.a Shkodër, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, nuk janë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, çfuqizuar me



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (Më hollësisht trajtuar në pikën 6 në faqet 33-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.A Shkodër të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet, në zbatim të Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

*Brenda datës 31.12.2020*

***Nga auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, u konstatua që:***

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në Shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” Sh.a, Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është implementuar në shkallë të ulët. Ky fakt provohet nga niveli i ulët i përputhshmërisë me kërkesat e Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, i ndryshuar, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010. Në kundërshtim me pikat 19 dhe 23 neni 4, pikën 1 neni 10, pikat 2 dhe 3 neni 11, pikat 2 dhe 3 neni 16, pikën 1 neni 27, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2011, të ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” shoqëria nuk ka hartuar gjurmët e auditimit, nuk ka hartuar regjistrin e risqeve, nuk ka krijuar Grupin e Menaxhimit Strategjik. Menaxhmenti nuk merr pjesë aktive në procesin e identifikimit, vlerësimit, dhe monitorimit të risqeve, me qëllim vendimmarrjen më të mirë, dhënien e garancisë të arsyeshme se objektivat do të arrihen, planifikim më të mirë të burimeve, si edhe adresim të prioriteteve. Gjithashtu, mungesa e gjurmëve të auditimit nuk krijon mundësinë për informimin e proceseve, duke mbajtur një dokumentacionin përkatës të miratuar, duke njohur procedurat e raportimit, veprimet ekonomike të caktuara përmes kontabilitetit, mbështetjen e proceseve nëpërmjet sistemeve të IT (teknologjisë dhe informacionit) si edhe sistemimin e mbajtjes së dosjeve. Në kundërshtim me pikën 2.3 të Urdhrit të Ministrisë së Financave Nr.16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, si edhe me pikën 3.2 të Manualit Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 8980, datë 15.07.2010 nuk janë hartuar listat e proceseve kryesore, të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të shoqërisë. Nëpunësi Autorizues nuk siguron se do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke përfshirë hapat kryesore të vlerësuara të rëndësishme për një sistem të shëndoshë, sikurse janë lista me proceset kryesore dhe gjurmët e auditimit (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 në faqet 91-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 1.1:** Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” Sh.a duhet të rrisë performancën e saj në drejtim të përdorimit efektivitet, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit sipas planeve të biznesit, që menaxhmenti i kësaj shoqërie të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve, por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse. Ajo duhet të marrë masa për hartimin dhe menaxhimin e regjistrin të riskut, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

*Menjëherë dhe në vijimësi*





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**2. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria UK Shkodër SH.A në kuadër të zbatimit të politikave komerciale shoqëria ka instaluar platformën elektronike Al-billing, e cila kryen administrimin si për të dhënat e klientit ashtu edhe për proceset komerciale.. Nëse në procesin e leximit është integruar një aktivitet kontrolli, kontrolli i konsumit nën  $0 \text{ m}^3$  dhe mbi  $50 \text{ m}^3$ , nuk ndodh kështu me proceset e tjera. Nga auditimi konstatohet se ato janë ndërtuar për të ndihmuar kryesisht punën e stafit. Proceset nuk përmbajnë një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave, në mënyrë që të parashikojnë mënyrën e realizimit, si edhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Në kushtet kur pothuaj gjysma e klientëve nuk janë të pajisur me matje, proceset e arkëtimit, të faturimit, të ankesave nuk përbëjnë procese të plota për të ndërtuar gjurmët e auditimit nga fillimi deri në fund të procesit. Dokumentacioni që shoqëron këto procese nuk rezulton i miratuar, gjithashtu lista e proceseve dhe gjurmët e auditimit nuk rezultojnë të arkivuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 në faqet 91-99, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Administrator i Shoqërisë të merren masa për hartimin e listave të proceseve kryesore me qëllim që të parashikojë realizimin e proceseve kryesore, përfshirjen e sektorëve të ndryshëm, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT dhe identifikimin e riskut.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

*Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr. 8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, u konstatua që:*

**1. Gjetje nga auditimi:** Në shoqërinë “Ujësjetllës Kanalizime Shkodër” Sh.a. shërbimi arkivor funksionon në një shkallë të ulët. Në kundërshtim me pikën 1, neni 7 të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” shoqëria nuk ka krijuar Komisionin e Ekspertizës, dhe për rrjedhojë ky komision nuk funksionon. Në kundërshtim me nenet 5, 6 7, 8, 9, të VKM Nr.4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullores së njëjësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”, shoqëria nuk ka krijuar pasqyrën emërtuese të çeljes së dosjeve. Nuk është përpiluar lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me rëndësi historike dhe kombëtare. Nuk bëhet përpunimi tekniko shkencor i dokumenteve të prapambetura. Nuk rezulton të jetë bërë ekspertiza e vlerës së ruajtjes së dokumenteve me qëllim përcaktimin e vlerës dhe kohës së ruajtjes së dokumenteve. Sa sipër, nuk krijon mundësi për të përcaktuar procedura të qarta dhe të njësuara në të gjithë rrjetin arkivor kombëtar për të mundësuar realizimin e përpunimit tekniko-shkencor, ruajtjen e dokumentacionit në arkiva dhe brenda afateve të përcaktuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 10 në faqet 99-101, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Arkivi i shoqërisë duhet të jetë në funksion të plotë të shërbimit arkivor dhe në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë normat tekniko-profesionale e metodologjike, si edhe udhëzimet për klasifikimin, sistemimin, përshkrimin, ruajtjen dhe restaurimin e dokumenteve.

Shoqëria duhet të krijojë Komisionin e Ekspertizës për të përcaktuar procedura të qarta dhe të njësuara me të gjithë rrjetin arkivor kombëtar për të mundësuar realizimin e përpunimit tekniko-shkencor, si edhe ruajtjen e dokumentacionit në arkiv brenda afateve të përcaktuara.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

*Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik, u konstatua që:*





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**1. Gjetje nga auditimi:** Raportimi nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër në lidhje me realizimin e programeve dhe treguesit e performancës, për vitet 2017, 2018 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, ka mospërputhje të të dhënave të raportuara në administrim dhe në AKUK, lidhur me të numrin e lidhjeve me rrjetin e ujësjetllës kanalizimeve si dhe mospërputhje të të dhënave të sasisë së prodhuar të ujit.

Shoqëria nuk ka zbatuar detyrimin e raportimit pranë Prefektit të Qarkut dhe Administratori i Shoqërisë, nuk ka zbatuar detyrimin ligjor të raportimit një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë pranë Këshillit të Administrimit dhe paraqitjen ç’do vit përpara Asamblesë së Përgjithshme të raportit të veprimtarisë së shoqërisë. Veprime në kundërshtim me nenin 12 pika 3 ë), nenin 18 pika 7 ç) dhe dh) dhe nenin 20 pika 2 të, VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet 19-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 1.1:** Drejtoria Tregtare e “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër të marrë masa që raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomik-financiar, të jenë të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko- ekonomik të shoqërisë.

*Në vijimësi*

**Rekomandimi 1.2:** Administratori i shoqërisë të marrë masa për të raportuar ç’do muaj për ecurinë e shoqërisë pranë Këshillit të Administrimit dhe ç’do vit përpara Asamblesë së Përgjithshme, si dhe të raportojë pranë Prefektit të Qarkut Shkodër.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër nuk ka bërë bilancin e ujit (analizën e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxheriale), nuk ka bërë një plan të detajuar për numrin e konsumatorëve që nuk janë të pajisur me matës, nuk ka bërë plotësisht evidentimin, klasifikimin dhe ndjekjen në mënyrë të vazhdueshme të debitorëve. Shoqëria merr më pak para nga konsumatorët sesa uji, që këta të fundit kanë konsumuar, pasi mesatarisht për tre vitet (2017, 2018 dhe gjashtë mujori i parë i 2019), 41.23 % e konsumatorëve nuk janë të pajisur me matës dhe faturohen afrofe, duke bërë që shitja e ujit të mos llogaritet në bazë të konsumit real vlerësuar nëpërmjet aparateve matëse, në kundërshtim me Ligjin nr. 8975 datë 21.11.2002 ”Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”, i ndryshuar, si dhe nenin 40 pika 1 dhe Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet 19-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandimi 1.1:** Nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër për vitin 2019, të bëhet bilanci i ujit, analiza e humbjeve teknike dhe ekonomike (menaxheriale). Në programin ekonomik të vitit pasardhës, humbjet të parashikohen të detajuara në humbje teknike dhe ekonomike (menaxheriale).

*Brenda datës 29.02.2020*

**3. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër, nuk ka hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomik-financiare, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët për vitet 2017 dhe 2018, kanë çuar në tejkallim të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar. Kjo ka bërë që tejkallimet në zërat e shpenzimeve për këto dy vite të jenë të pa miratuar, në kundërshtim me nenin 13, pika 4, nenin 18, pika 7 dhe nenin 20, pika 2 c) të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet 19-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

**Rekomandimi 1.1:** Këshilli Administrimit të miratoj në kohë programin ekonomik-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër, që në fazën e planifikimit ka parashikuar humbjen e shoqërisë, pasi parashikon në programet e saj ekonomike shpenzime të pajustificuara nga planifikimi për të ardhurat (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet 20-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Drejtoria Tregtare e shoqërisë, në cilësinë e hartueses dhe zbatueses së programeve ekonomik-financiare të marrë masa që hartojë dhe zbatojë programe nëpërmjet të cilave të planifikojë, drejtojë dhe kontrollojë burimet financiare, në mënyrë që të ofrojë me efikasitet dhe efektshmëri shërbimet publike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Rekomandimi 1.1:** Organet Drejtuese të “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër, (Administratori, Këshilli i Administrimit, Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për analizimin, shqyrtimin dhe reduktimin e humbjeve të shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Drejtoria Teknike për të gjitha praktikatat e shqyrtimit të kërkesave për pika lidhje ka vepruar në kundërshtim me Urdhrin Administratorit të Shoqërisë nr. 221, datë 11.10.2018, pasi e ka kushtëzuar miratimin e pikës së lidhjes me arkëtimin nga ana e subjektit kërkues të likuidimit të detyrimeve të prapambetura të debitorëve/pronarëve të objekteve që shkelen nga gjurma e ndërtimit të objektit të ri. Kushtëzimet e vetme në VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës kanalizime sh.a” për të përfituar të drejtën e pikës së lidhjes, janë kërkesa me dokumentacionin teknik bashkëngjitur nga ana e aplikuesit, pagesa e tarifës së pikës së lidhjes, si dhe fakti që realizimi i pikës së lidhjes të jetë teknikisht dhe financiarisht i mundshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet 19-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Administratori i Shoqërisë në kompetencat ligjore, statusore dhe rregullatore të bëjë parashikime specifike (çfuqizojë dhe/ose ndreqje gabimi material) në lidhje me mos cënimin e së drejtës së subjekteve për të pasur pika lidhje, duke i kushtëzuar ata me pagimin e detyrimeve të prapambetura të debitorëve/pronarëve të objekteve që shkelen nga gjurma e ndërtimit të objektit të ri. Për detyrimet e pa likuiduara të debitorëve ndaj UK që shkelen nga gjurma e ndërtimit të objektit të ri (pikë lidhjes) të ndiqen procedurat specifike juridike për vjeljen e debive.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga Shoqëria “Ujësjetllës Kanalizime” Sh.a Shkodër pikat e lidhjes në objekte janë realizuar në kundërshtim me modelin e rregullores të miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës kanalizime Sh.a.”, pasi kërkesat për pika lidhje nuk janë të shoqëruara me dokumentin e lejes së ndërtimit, aktin e pronësisë së objektit dhe projektin hidroteknik të sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë të realizuar nga persona ose subjekte të licencuara. Nga ana e Drejtorisë Teknike janë miratuar pika lidhje me sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për subjekte që nuk plotësojnë kushtet dhe dokumentacionin për ta konsideruar realizimin e pikës së lidhjes teknikisht dhe financiarisht të mundshme, si dhe nuk është përgatitur dokumentacioni teknik i pikës së lidhjes dhe realizimit të saj. Gjithashtu nuk është



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

e dokumentuar nëse për secilën pikë lidhje është vendosur ujëmatësi konformë pikës 2.7 të VKM nr. 1304, datë 11.12.2009.

Asnjë prej pikave të lidhjes të objekteve shumë katështe të miratuara në vitin 2018 dhe 8-mujorin 2019 nuk rezulton të jetë e pasqyruar në sistemin GIS, ndërkohë që në këtë sistem rezultojnë ende aktive pikat e lidhjes së ujëmatësit dhe kontratat e objekteve që nuk ekzistojnë më pasi janë prishur dhe pikërisht në këto prona “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër ka miratuar pika lidhje për objekte të reja, pa mbyllur paraprakisht pikat dhe kontratat me objektet që prishen nga zhvillimi i ri (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet 19-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Drejtoria Teknike e “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër të marrë masa për miratimin e pikave të lidhjes me sistemin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve vetëm për kërkesat që plotësojnë kushtet e lejes së ndërtimit, aktet e pronësisë, planimetrinë e vendosjes së objektit dhe projektin hidraulik të sistemit të brendshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve realizuar nga persona e subjekte të licencuara. Të përgatisë dokumentacionin teknik të pikës së lidhjes dhe realizimit të saj, të dokumentojë vendosjen e ujëmatësit për secilën pikë lidhje si dhe të raportojë të dhënat në sektorin IT dhe GIS.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Rekomandimi 1.1:** Sektori IT dhe GIS i “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër të marrë masa në vazhdimësi për hedhjen në sistem GIS të pikave të lidhjes, ujëmatësve dhe kontratave në zonën e administrimit nga “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër duke përfshirë edhe njësitë administrative, si edhe të marrë masa për të pasqyruar në sistem statusin e tyre aktiv ose jo aktiv.

*Brenda datës 30.06.2020*

**7. Gjetje nga auditimi:** Këshilli i Administrimit të “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër ka përcaktuar tarifën për realizimin e pikave të lidhjes në rrjetin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve përmes vendimit nr. 15, datë 30.09.2016. Në këtë vendim tarifën për pikat e lidhjes së banesave dhe pikat e lidhjes të godinave shumëkatëshe variojnë për secilën nga një kufi minimal në një maksimal (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 në faqet 19-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi 1.1:** Këshilli i Administrimit të “Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Shkodër të rivlerësojë Vendimin nr. 15, datë 30.09.2016, me synim jo vetëm inkurajimin e kapaciteteve investuese të biznesit, por edhe rritjen e performacës së shoqërisë.

*Brenda datës 29.02.2020*

*Nga auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, Bank dhe blerjeve me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dita brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj, u konsatua që:*

#### **1. Gjetje nga auditimi:**

Përfitim padrejtësisht pagese nga A. D., me detyrë kryetar i Këshillit Administrativ. Konkretisht me urdhër transfertën datë 27.12.2017, nëpërmjet bankës Credins, është likuiduar A. D., me detyrë kryetar i Këshillit Administrativ për vlerën 4250 lekë, Me objekt kalim bonusi për vitin 2017. Ky bonos është dhënë me vendim të Këshillit të Administrimit nr. 30, datë 22.12.2017, si dhe në zbatim të këtij vendimi, urdhri i brendshëm i Administratorit nr. 316, datë 27.12.2017, ku është përcaktuar të akordohet për çdo punonjës 5000 lekë bonusi për vitin 2017. Shpërblimi (bonusi) është përfituar padrejtësisht, pasi kryetari i Këshillit Administrativ nuk është punonjës i UK Shkodër, dhe në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 5 dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 në faqet 29-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Rekomandimi 1.1:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa që në të ardhëmen mos të ndodhin më përfitime të pa drejta financiare nga menaxhmenti i shoqërisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

##### **1. Gjetje nga auditimi:**

Përfitim padrejtësisht pagese nga Shoqëria “A. A.” sh.p.k në vlerën 480,000 lekë. Konkretisht me urdhër transfertë datë 29.05.2019 është likuiduar Shoqëria “A. A.” sh.p.k në vlerën 480,000 lekë. Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël Shoqërisë “A. A.” sh.p.k me përfaqësuese ligjore N. K., është lidhur aktmarrëveshja e shërbimit me nr. 52/2 prot, datë 16.01.2019, me objekt: Auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri në përfundimin e shërbimit të ofruar me vlerë 800,000 lekë pa tvsh. Në këtë aktmarrëveshje është përcaktuar “.....Në përfundim të kontrollit, verifikimit dhe vlerësimit të gjithë elementëve të përgjithshme të përmendur në këtë marrëveshje, por edhe të elementëve specifik të përmendur të cilët mundësojnë kryerjen e një auditimi sa më rigoroz, AL do të përpiloj raportin e auditimit të pavarur në të cilin do të shprehet opinion në se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, sipas kuadrit të zbatueshëm të raportimit financiar”.

Ky shërbim nuk provohet të jetë kryer, nga deklarimi verbal i stafit të UK, kjo kontratë është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga Shoqëria “A. A.” sh.p.k me përfaqësuese ligjore N. K.

Për kryerjen e këtij shërbimi me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 4 , datë 03.05.2019 protokolluar në Shoqërinë “UK” Shkodër Sh.A me nr. 7426, datë 03.05.2019, është bërë emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar që të auditojnë pasqyrat financiare për vitin 2018, B. B. dhe T. N..

Ndërmjet Shoqërisë “UK” Shkodër Sh.A, dhe ekspertëve kontabël, B. B. dhe T. N. është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 749 prot., datë 19.06.2019, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018 me afat 266,7 orë që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me vlerë 800,000 lekë pa tvsh. Likuiduar me urdhër transfertën datë 04.07.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 384,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 15.06.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 96,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 58, datë 26.07.2019, urdhër transfertën datë 08.08.2019 nëpërmjet BKT në vlerën 480,000 lekë, dokument justifikues fatura nr. 30, datë 26.07.2019.

Me vendim të kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 9, datë 30.07.2019, është bërë miratimi i pasqyrave financiare për vitin 2018.

Vlera 480,000 lekë përbën dëm ekonomik për Shoqërinë “UK Shkodër” Sh.a Shkodër dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “A. A.” sh.p.k (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 në faqet 29-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

##### **Rekomandimi:**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 480,000 lekë nga Shoqëria “A. A.” sh.p.k. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejtë nga mos zbatimi i aktmarrëveshjes së shërbimit me nr. 52/2 prot, datë 16.01.2019, me objekt auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2018.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

*Brenda datës 30.04.2020*

#### C.2. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI TË MUNDSHËM EKONOMIK

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “I. E.” shpk, me objekt “Blerje elektropompa, në vlerën 4.104.000 lekë, viti 2017, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “I. E.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 38-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “I. E.” Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 4.104.000 lekë** nga Shoqëria “I. E.” Sh.p.k.

*Brenda datës 31.03.2020*

#### 2. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “V.” shpk, me objekt “Blerje instalim elektropompa dhe panel elektrik”, në vlerën 2,786,520 lekë, viti 2019, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “V.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 38-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “V.” Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 2,786,520 lekë** nga Shoqëria “V.” Sh.p.k.

*Brenda datës 31.03.2020*

#### **3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “PC S.” shpk, me objekt “Blerje pajisje dhe materiale kompjuterike”, në vlerën 2,202,048 lekë, viti 2017, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “PC S.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 38-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “PC S.” Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 2,202,048 lekë** nga Shoqëria “PC S.” Sh.p.k.

*Brenda datës 31.03.2020*

#### **4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “F. G.” shpk, me objekt “**Blerje materiale hidraulike**”, në vlerën 16,385,256 lekë, viti 2018, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “F. G.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 38-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “F. G.” Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR

ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i *vlerës 16,385,256 lekë* nga Shoqëria “F. G.” Sh.p.k.

*Brenda datës 31.03.2020*

#### **5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria “PC S.” shpk, me objekt “Blerje pajisje dhe materiale kompjuterike”, në vlerën 3,187,620 lekë, viti 2019, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së pajisjeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “PC S.” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 në faqet 38-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Rekomandimi:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “PC Store” Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i *vlerës 3,187,620 lekë* nga Shoqëria “PC S.” Sh.p.k.

*Brenda datës 31.03.2020*

#### **Shkurtime**

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>APP</b>	Agjencia e Prokurimit Publik
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>KVO</b>	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>NJP</b>	Njësia e Prokurimit
<b>AK</b>	Autoriteti Kontraktor
<b>DT</b>	Dokumentet e Tenderit
<b>LPP</b>	Ligji prokurimit publik
<b>RRPP</b>	Rregullat e prokurimit publik

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I USHTRUAR NË SHOQËRINË  
“UJËSJELLËS KANALIZIME” SH.A SHKODËR**